ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 7 GUSHT 2021. NUMËR 142 VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

Dr. Luan Topçiu është një nga personalitetet e kritikës dhe studimit të letërsisë shqipe. Autor i disa librave ku i fundit është "Historia e letërsisë shqipe nga zanafilla deri më sot" botuar pak kohë më parë në rumanisht.

LUAN TOPÇIU:

NUK MUND TË FLASËSH PËR HISTORINË E NJË POPULLI PA MARRË PARASYSH LETËRSINË DHE KULTURËN E TIJ

Bisedoi Andreas Dushi

Çmimet e Panairit të Librit "Ulqini, 2021"

Çmimi "*Liburnia*", Besnik Mustafajt

Çmimi "*Dega e Ullirit*", Diana Çulit

Çmimi "*Servantes*", Bujar Hudhrit



Piktura nga Pashk Përvathi

GJERGJ FISHTA, MOSKUPTIME DHE KEQKUPTIME

Nga Frano Kulli (fq. 5)

Përdorimi i ledhatuar e me mjeshtrí i shqipes, në korpusin e veprës letrare e publicistike të Gjergj Fishtës, komunikimi me lexuesin e vet, ndalet përdhunshëm pa kaluar 5 vite nga ndarja e tij këso jete, në dhjetorin e 1940-ës. Gjithë ajo pasuri gjuhësore e përdorur aty, por edhe me plot prurje të reja prej tij, të panjohura e të palëvruara deri atëherë, u ngurtësua; ju vù një rrasë e rëndë varri, aq e rëndë sa

SHËNIME PËR LIBRAT

Libri i autorëve Antonio Bellusci dhe Ornela Radovicka (fq.12)

NJË RRUGËTIM NË NGULIMET ARBËRESHE

Nga dr. Jolanda Lila

"Kapedan Mihali" i Kazanxaqis

VDEKJA DHE LIRIA

Nga Damian Alia (fq.13)

HAMLETI DHE LEXIMET E MUNDSHME TË KËSAJ FIGURE NË KOHË

Prof. Dr. Klara Kodra (fq.19)

EPIKTETI

ARTI I TË JETUARIT

(fq.22)

Antologjia e poetëve të rinj shqiptarë/ Ανθολογία νεών αλβανών ποιητών

NJË DRITARE E RE EUROPIANE PËR POEZINË SHQIPE

Nga dr. Jorina Kyeziu (Shkreta) (fq. 7)

MENDIMI KRIJUES

AUGUSTE RODIN DHE "MENDIMTARI"

Nga Joe McGasco (fq.20)

PËRGJIGJET E W.FAULKNER-IT PËR "ABSALOM, ABSALOM!"



(fq.16)

BIBLIOTEKË

Marius Dobrescu (fq. 10)
Marshi i reaksionit

Vasil Vasili (fq. 11)
Kronika ime si dytës përshkrues

Flurans Ilia (fq. 14)
Lëvozhga e fjalës

Qazim Shehu (fq. 15)
Pusi

LARTËSITË SUBLIME TË DIJES DHE KULTURËS

Nga Feride Papleka (fq.18)

PYETËSORI "LIBRAT E JETËS SIME"

(fq. 23)

VIRION GRAÇI: LIBRAT QË DO TË DOJA T'I KISHA SHKRUAR? "KRONIKË NË GUR", "DON KISHOTI" DHE "HAMLETI"

LUAN TOPÇIU: NUK MUND TË FLASËSH PËR HISTORINË E NJË POPULLI PA MARRË PARASYSH LETËRSINË DHE KULTURËN E TIJ

Bisedoi Andreas Dushi

A.D: Më 1919, historiani i njohur rumun Nicolae Iorga, kur do të shkruante "Brève histoire de l'Albanie et du peuple albanais", do të shprehte nevojën e botimit të një historie të letërsisë shqipe. Këtë nevojë e plotësoni ju, në vitin 2021 kur botuat studimin" Istoria Literaturii Albaneze, de la origini până în prezent" (Historia e letërsisë shqipe nga zanafilla deri më sot). Punë e mundimshme, por edhe e bukur, apo jo? Gjithashtu, nismë vërtetë e guximshme, ndaj edhe më bën kureshtar shtysa... Çfarë ju shtyu ta ndërmerrni një të tillë nisëm?

L.T: Historiani i njohur europian dhe miku i madh i shqiptarëve, Nicolae Iorga, në veprën e tij "Brève histoire de l'Albanie et du peuple albanais", në përçapjen e tij për të ilustruar idenë e tij se shqiptarët, së bashku me baskët, janë nga popujt më të vjetër të Europës dhe se Shqipëria meriton të ketë shtetin e vet, ka sjellë dëshmi për trashëgiminë letrare të letërsisë shqiptare, por ka ndjerë mungesën e një informacioni të sistemuar. Nicolae Iorga donte të dëshmonte, përmes veprës së tij, se shqiptarët kanë një histori të lashtë, por edhe një histori të jetës shpirtërore që lidhet me kontinentin europian, sepse letërsia është enciklopedia e vërtetë e një populli, është jeta shpirtërore e tij, është historia e qenies kulturore. Me fjalë të tjera, nuk mund të flasësh për historinë e një populli pa marrë parasysh letërsinë dhe kulturën e tij. Mbas njëqind vjetësh kam kënaqësinë të sjell para lexuesit rumun, për të gjithë studiuesit e albanalogjisë, për të gjithë ata që duan të dinë më shumë për Shqipërinë dhe kulturën shqiptare, një histori të detajuar të letërsisë shqipe.

Shtysat e mia të para për të shkruar historinë e letërsisë shqiptare kanë filluar qysh nga viti 2005-2006, kur kam dhënë disa ligjërata për letërsinë shqipe në Universitetin e Tiranës, faculteti i Gjuhëve të Huaja, dega gjermanisht. Më pas, në vitin 2012 kam dhënë disa leksione të letërsisë shqipe, në rumanisht, si profesor i ftuar pranë Universitetit të Bukureshtit, në një master të quajtur "Studime kulturore ballkanike". Fillimisht kam menduar të shkruaj një skicë të historisë së letërsisë për lexuesin rumun dhe leksionet ishin boceti i parë, që më pas, për interesa madhore, të një projekti shumë më të rëndësishëm, për krijimin e themeleve të albanologjisë në Rumani, u transformua në një vepër masive. Në kuadrin e Qendrës Kulturore Shqiptare në Bukuresht, kemi botuar gjithashtu një libër të përbashkët me historianin dhe shkrimtarin me origjinë shqiptare nga nëna, Dr. Liviu Lungu, "Historia e Shqipërisë në data" (2020). Gjithashtu, janë tre libra të albanologut Robert Elsie për Shqipërinë të përkthyera nga historiani i feve, Dr. Radu Savulescu, që presin dritën e botimit. Po kështu, janë në proces botimi dy fjalorë akademikë shqip-rumanisht dhe rumanisht-shqip, ku jam bashkëautor së bashku me bashkëshorten Dr. Renata Melonashi-Topçiu etj., pa harruar revistën kulturore dhe shkencore "Albanica", e cila është kthyer në një hapësirë ku takohen të gjithë studiuesit që merren me albanologji. Si të thuash, *Historia e letërsisë shqipe* është pjesë e projektit ambicioz për ndërtimin e themeleve të albanologjisë në një vend mik siç është Rumania.

Siç vetëkuptohet, të hartosh një histori letërsie pesë shekullore, është një "aventurë e shkrimit", për vetë gjerësinë e informacionit, përmasat masive të veprës, vështirësitë e ndërtimit, kriteret e përzgjedhura, grupimin e materialit, për vetë zhvillimet e pazakonta të letërsisë shqipe, dramatizmin e saj, burimet heterogjene, mungesën e një historie të letërsisë shqipe aktuale dhe të depolitizuar, por edhe për shkak të politizimit të skajshëm të burimeve të informacionit, hirarkive të politizuara etj. Letërsia shqipe është shkruar në disa shtete të ndryshme, ku niveli i lirisë ka qenë i ndryshëm, është shkruar në dialekte të ndryshme, nën diktaturë, në çenzurë, në burgjet e tmerrshme komuniste, është shkruar në vise të ndryshme: Itali, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, SHBA, Rumani, Turqi, Bullgari, Egjipt etj., pra tabloja e saj është komplekse.

A.D: Kriteret e hartimit të një historiografie letrare janë të diskutueshme. Në studimin tuaj, mbi ç'kritere përzgjedhëse e studimore jeni bazuar?

L.T: Historia e letërsisë është një disiplinë me një fizionomi të posaçme, që ka mjetet e veta metodologjike, objektiva dhe qëllime të posaçme. Çdo hartim i historisë së letërsisë sjell me vete dhe diskutime, sepse, për nga vetë natyra e saj, zgjon debate, madje të ashpra. Historia letrare, fizionomia teorike e konceptit dhe statusi i disiplinës si e tillë nuk kanë pushuar së diskutuari, duke ndarë, nga njëra anë, historinë letrare nga kritika, por, nga ana tjetër, në një fazë tjetër të evolucionit të konceptit, duke ruajtur lidhjen e pazgjidhshme midis dy disiplinave. Ka shumë syresh, qysh nga mesi i shekullit të kaluar që madje mohojnë dhe nevojën e ekzistencës së historive të letërsisë.

Studimi ka 15 kapituj kryesorë. Në këtë narracion historik përshkruhen rreth 5 shekuj letërsi. Lënda është përzgjedhur në bazë të kriterit të rrëfimit historik, i cili synon të japë disa koordinata aksiologjike, tematike, stilistike etj., të cilat, sigurisht, ilustrohen më mirë tek disa shkrimtarë sesa tek të tjerët. Çdo ndërtim/krijim mendor, në çdo lëmi, do të ishte ideale në se do të ndërtohej duke respektuar një kriter të vetëm, për të ruajtur koherencën e ndërtimit, qoftë atë kronologjik, apo atë të shkollave e drejtimeve letrare etj., por realisht e praktikisht është e pamundur. Duke pasur parasysh situatën historike dhe kulturore të shqiptarëve si dhe vetë zhvillimin e letërsisë, do të dilte një histori e cungët, e paplotë dhe e mangët. Të gjitha historitë letrare ëndërrojnë të jenë të pastra nga mëtimi dhe janë të papastra për nga natyra. Për të qenë konseguent me parimet e ndërtimit të saj, do të ishte ideale të respektoheshin kritere të papërzjerë, koherentë. Po lënda është johomogjene. Ndaj rrokja tërësore e saj, nuk mund të përmblidhet duke u bazuar vetëm tek disa kritere të pastra teorike.

Në hartimin e kësaj vepre janë përdorur disa zgjidhje klasike: ndarja e evolucionit të letërsisë në shekuj, epoka (për periudhat më të hershme) ose breza shkrimtarësh, duke synuar edhe zhvillimin e letërsisë sipas zhanreve dhe llojeve letrare, temave dhe motiveve, por edhe ndërndikimet me letërsitë e tjera. Një strategji tjetër e ndjekur është përcaktimi i rrymave dhe grupeve kryesore kulturore, i cili funksionon plotësisht kur është fjala për letërsinë mesjetare, për humanizmin, romantizmin, letërsinë e bejtexhinjve, realizmin në shekujt vijues, për realizmin socialist, modernizmin dhe postmodernizmin në shekullin XX e XXI. Por, kur vjen fjala për letërsinë shqipe nuk mund të mos marrim në konsideratë çfarë shkruante profesor Eqrem Çabej në lidhje me kriteret e përzgjedhura në studimin e letërsisë shqipe, siç ishte ai i *qarqeve kulturore dhe letrare,* si qarku *italo-shqiptar, qarku i letërsisë së veriut, apo qarku i letërsisë së jugut* etj. Janë disa elementë, që të kashtosur, përcaktojnë rravën e formimit të shkrimtarisë. Duhet të thuhet që në fillim të herës se ky kriter nuk i kundërvihet aspak letërsisë kombëtare, përkundrazi plotëson më mirë tablonë.

Përpos këtyre kritereve, të mirënjohura në hartimin e historive të letërsisë, duke qenë se lexuesi është i huaj, libri përmban edhe një vështrim imagologjik mbi Shqipërinë dhe shqiptarët, mënyra se si e kanë perceptuar Shqipërinë albanologë dhe antropologë të huaj. Duke qenë se receptori i saj është lëçitësi i huaj, libri bazohet në tre kolona kryesore: konteksti historik, konteksti estetik dhe fragmente nga veprat, sipas rastit, nga poezia apo proza e disa prej autorëve. Kjo strukturë imponohet për ta bërë letërsinë të prekshme, më të lehtë për ta lexuar, më konkrete dhe më të asimilueshme. Pra, historia e letërsisë është një

punë shumëvjeçare studimesh, botimesh, përkthimesh, të përmbledhura në një korpus madhor, e sendërtuar sipas disa kritereve bazë, të ndihmuara nga disa të tjera ndihmëse, për të hedhur dritë mbi gjithë peisazhin e letërsisë shqipe etj.

Së fundmi, duke qenë i pamundur hartimi i historisë së letërsisë me të gjithë autorët e letërsisë shqipe të të gjitha kohërave, vjen në ndihmë një inventar i plotë i autorëve. Me fjalë të tjera, libri përmban edhe një kronologji të shpjeguar të letërsisë shqiptare, qysh nga zanafilla e saj dhe deri në vitin 2020, krahas analizës dhe shtjellimit të ecurisë të letërsisë shqipe në vite si dhe një bibliografi e zgjeruar, për të qenë sa më gjithëpërfshirëse.

A.D: Hartimi i një *historie të letërsisë shqipe* mbetet temë e nxehtë në Shqipëri. Në universitete, mungesa e një të tille, të pranuar gjerësisht, ndihet e diskutohet. Mos ndoshta do të ishte më mirë sikur, përkarshi gjuhës rumune, "Historia e letërsisë shqipe nga zanafilla deri më sot" të botohej edhe në shqip?

L.T: Debati mbi rishkrimin e *Historisë së Letërsisë Shqipe* nganjëherë bëhet tepër agresiv dhe ka shumë zëra që sugjerojnë sesi duhet të jetë kjo histori, çfarë kritere duhet të ndiqen si dhe gabimet eventuale. Kjo dukuri është e pranishme kahmos, jo vetëm në Shqipëri. Por, fatkeqësisht, në Shqipëri, ka vetëm debate, se si duhet të jetë historia e letërsisë, por nuk ka histori të letërsisë.

Sigurisht, një agresion i tillë nuk ka asnjë lidhje me ndonjë çështje të hartimit të një historie të letërsisë në ndonjë kulturë. Në shumicën e rasteve, roli i historianëve të letërsisë, kritikëve dhe studiuesve letrarë zëvendësohet nga gazetarë që përdorin letërsinë ose shkrimtarët për të transmetuar lajme "të bujshme". Disa nga gazetarët e sotëm, duke mos qenë specialistë në fushën e historisë dhe teorisë letrare, bëjnë gjykime sipërfaqësore dhe krejtësisht të gabuara. Ato mbartin të metat karakteristike të shtypit si nguti, mungesa e kulturës, mungesa e respektit, të qenit të sipërfaqshëm, shija banale, ndonjëherë keqinformimi dhe gënjeshtra, por edhe impulsi për të bërë gjykime të nxituara në fushën e letërsisë dhe arteve. Duke qenë dhe vend i vogël, në mënyrë të pashmangshme, ekzistojnë dhe simptoma të një provincializmi kulturor, ndarja në grupime e tarafe, klane krahinore, imponime të dhunshme etj.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet sot që rishikimi i Historisë së Letërsisë Shqipe duhet të bëhet jo vetëm për arsye ideologjike, thjesht duke ndryshuar perspektivën ideologjike, por për një numër arsyesh shkencore. Ideologjizimi është, në fakt, mohim, mungesë e vështrimit të nuancuar, është, në fund të fundit, mosnjohja e thelbit të letërsisë! Kështu, tekstet e trashëguara vuajnë nga dogmatizimi i tepruar, nga një deformim i rrjedhës historike të produktit letrar, i cili dëshmon mungesën e kompetencës.

Siç mund të shihet, problemet janë serioze, shumë specifike dhe komplekse aq sa të zgjidhen shpejt. Mungesa e produkteve konkrete, përshtjellimi në lidhje me kriteret që duhet të zbatohen në një ndërtim të tillë kulturor, amatorizmi, guximi për të hyrë në fusha specifike shkencore pa trajnimin dhe informacionin e nevojshëm, janë po aq të dëmshëm dhe shtrembërues sa kriteri politik, që ishte kriteri

i vetëm në historiografinë komuniste. Përmbysja e regjimit komunist ringjalli kritikat ndaj historiografisë shqiptare dhe, në veçanti, përpjekjet për të propozuar kritere dhe metoda të reja. Është e pafalshme që ende nuk ekziston një histori e letërsisë shqipe e shkruar në Shqipëri, ku të përfshihen në të: Gjergj Fishta, Faik Konica, Martin Camaj, Kasem Trebeshina, Frederik Rreshpja, Et'hem Haxhiademi, Arshi Pipa, Visar Zhiti, Bilal Xhaferri e shumë të tjerë.

Duhet të përfshihen autorë të cilët, për arsye politike, u lanë jashtë historive të letërsisë, në tekstet pas viteve 1950 dhe polemikat e shkaktuara tashmë nga kriteri sociologjik, historiko-kulturor i bashkërendimit të historive të letërsisë shqipe. Ajo që më duket më trishtueshme sot, është një "ristaurim" i përdhunshëm i hirearkisë së periudhës komuniste dhe mohimi, në mënyrë të nënkuptuar, i aradhës së shkrimtarëve të mohuar, harruar, që duhet të zënë vendet e nderit në letërsinë shqipe.

Çfarë po ndodh në historinë letrare shqiptare sot, cilat janë shanset për të zhvilluar këtë disiplinë në të ardhmen? Është e pamundur të shmangësh letërsinë e krijuar në burgjet shqiptare, letërsinë e "sertareve", letërsinë e ndaluar dhe të pabotuar. Nuk besoj se ka në gjithë botën një letërsi aq dramatike, aq shumë gjak dhe vuajtje për lirinë dhe bukurinë e fjalës, për gjuhën shqipe. Aq shumë shkrimtarë të pushkatuar, të burgosur, të poshtëruar, të mohuar.

A.D: Vihet re se studimi, njëkohshëm me ndjekjen e një rendi kronologjik, ndërtohet edhe mbi vështrime krahasimtare brenda letërsisë shqipe, por edhe në raport me letërsitë e tjera? Ç'dallime e ç'të përbashkëta dalin, në plan të gjerë, nga kjo qasje?

L.T: "Historia e letërsisë shqipe nga zanafilla deri më sot" është shkruar, në mënyrë të pashmangshme, dhe në rrafshin krahasimtar brënda letërsisë shqipe, por edhe në raport me letërsitë e tjera, veçanërisht me ato ballkanike, por dhe europiane. Përpos analizave, ideve kritike, interpretimeve, jepet një hierarki e propozuar e vlerave dhe një vizion i përgjithshëm i letërsisë shqiptare si letërsi europiane.

Shkrimtarët shqiptarë, në mënyrë të pashmangshme janë ndikuar nga autorë, nga drejtime letrare, nga fryma që ka ekzistuar në letërsi të tjera (por dhe brenda letërsisë shqipe) me të cilat kanë pasur kontakte, qoftë gjuhësore, qoftë për shkak të formimit në këto vende. Letërsia e Rilindjes Kombëtare ishte një letërsi me trajta romantike, e stimuluar nga konteksti politik e social i vendit, po aq edhe nga fryma nacionaliste e letërsive të Ballkanit, ku kishin shpërthyer levizjet për pavarësi. Për këtë arsye qe një letërsi që interferoi me letërsitë brenda dhe jashtë rajonit, duke manifestuar disa tipare të përbashkëta.

Natyrisht, duke qenë se historia e letërsisë shqiptare i drejtohet lexuesit rumun, janë nxjerrë në pah elementet e përbashkëta me autorë të letërsisë rumune, përkime në evolucionin stilistik të disa autorëve shqiptarë që jetuan dhe shkruan në Rumani. Shumë syresh, ndonëse kanë shkruar në gjuhën shqipe, janë shumë pranë "matricës kulturore rumune". Sigurisht kam nxjerrë në pah rolin e botimeve në Rumani dhe rëndësinë e komunitetit shqiptar të Rumanisë, veçanërisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe më pas.

A.D: Periudha në të cilën shtrihet studimi juaj fillon qysh nga ilirët e vijon deri në ditët e sotshme. Cilat janë referencat kryesore historike e shkencore që ju kanë ndihmuar gjatë punës tuaj?

L.T: Burimet e studimit janë në rradhë të parë studimet shqiptare, pastaj ato rumune dhe të huaja. Pa mëdyshje, janë të gjitha tekstet e historisë së letërsisë shqipe, studimet mbi periudha të ndryshme, studimet tematike e monografike nga autorët tanë. Burimet e studimit i kam përdorur edhe në mënyrë aktive. Por, sigurisht, kur është fjala për interpretimin e veprës, anën kritike të këtij materiali, risinë dhe vendin që zë një shkrimtar në këtë histori letërsie, janë, më së shumti, vetjake. Duhet të them se qëllimi im nuk ka qenë të shkruaja një vepër të përkryer, bazuar mbi kritere puritane skolastike dhe shterpë, por një tekst të gjallë, dinamik, sepse unë nuk përfaqësoj një autor abstrakt, të përjetshëm, nuk ekziston një njësi matëse universale në gjykimin e letërsisë, por gjykimet e mia janë bërë në bazë të lëçitjeve të mia, të kompetencës sime, shijes letrare etj.

A.D: Në letërsinë dhe gjuhën shqipe, një kontribut të rëndësishëm kanë dhënë edhe shqiptarët e Rumanisë, veçanërisht gjatë shekullit XIX. Çfarë vendi zënë ata në "Historia e letërsisë shqipe nga zanafilla deri më sot"?

L.T: Ky botim fiton një rëndësi të veçantë edhe për faktin se, në një masë të konsiderueshme, letërsia shqipe ka lidhje me Rumaninë, me komunitetin shqiptar të Rumanisë, por edhe me vetë letërsinë rumune. Dihet se letërsia shqipe nuk u shkrua vetëm në Shqipëri, por edhe në hapësira të tjera kulturore, ndërkohë që një pjesë e veprave të rëndësishme të kësaj letërsie kanë parë dritën e botimit në Rumani dhe vende të tjera të Europës dhe më gjerë. Në Rumani janë botuar që nga abetare dhe tekste mësimorë, letërsi e mirëfilltë, drama, përkthime letrare, gazeta e revista të panumurta.

A.D: Prania e tyre në studim është një lloj nxitjeje edhe për lexuesit e studiuesit rumunë?

L.T: Është, sigurisht, një arsye më shumë, që kjo histori letërsi të zgjojë kureshtjen e lexuesit rumun dhe interesin shkencor të studiuesve rumunë. Letërsia shqiptare është një letërsi e një populli të lashtë europian, me plot konvergime e paralele, simbole e shenja historike e kulturore të përbashkëta me popujt e tjerë europianë.

A.D: Përtej kësaj, në tërësi, si është pritur nga bota akademike ky studim?

L.T: Ky libër studimor sapo ka dalë, por pritshmëria është e madhe. Menjëherë u dha një njoftim në televizionin kombëtar rumun TVR1. Në rradhë të parë, sepse është botimi i parë i këtij lloji. Personalisht kam ndjerë nevojën e shkrimit të këtij libri, sepse atmosfera kulturore e këtushme e ka kërkuar, sepse kam qenë i nxitur dhe i vlerësuar nga kolegë shkrimtarë dhe studiues të letërsisë dhe dashamirës të kulturës shqiptare në veçanti, sepse kam pasur përkrahjen

dhe motivimin e miqve të mi për të kurorëzuar këtë projekt që kërkon shumë mund, ngulmim dhe shumë durim.

A.D: Ju shkruani në dy gjuhë, shqip dhe rumanisht e gjithashtu, përktheni nga njëra në tjetrën, ku secila mund të jetë edhe njëra, edhe tjetra. Në ç'mënyrë bashkëjetojnë këto dy gjuhë brenda jush?

L.T: Të qenit dygjuhësh në kohët tona nuk është një dukuri e izoluar për shkrimtarët shqiptarë. Shkrimi në një gjuhë tjetër është një veprim që lidhet me mërgimin, me shkëputjen nga matrica. Ky lloj mërgimi, sot, është një short kulturor i modernitetit. Të them të drejtën, në një kohë kur dhe jetën fizike e kam ndarë midis dy vendeve, e thënë metaforikisht, nuk jetoj në asnjë qytet apo fshat, por jetoj në këto dy gjuhë. Kam një numër librash në shqip dhe një numër librash në rumanisht. I ndodhur në këtë hipostazë e shikon veten si një urë midis këtyre kulturave, letërsive.

A.D: Lexuesit shqiptar i keni dhënë disa nga penat më të shquara rumune e njëkohësisht, atij rumun disa nga emrat më të mirë të letërsisë shqipe. Në të dyja anët, si priten letërsitë respektive, pra në Shqipëri ajo rumune dhe në Rumani ajo shqipe?

L.T: Gjithmonë do të ekzistojë një interes dhe kërshëri e lexuesit të huaj për të njohur tjetrin. Një nga mënyrat më të mira është përkthimi i shkrimtarëve më përfaqësues të një kulture kombëtare. Jam autori i një antologjie të poezisë shqipe në rumanisht, në të cilën kam përfshirë, në një rend historik, poetët më në zë shqiptarë. Antologjia fillon me disa fragmente të përkthyera nga letërsia gojore shqiptare, nga baladat, që mendoj, se plotësojnë fizionominë e kësaj poezie. Kam përkthyer nga De Rada, Naim Frashëri, Gjergj Fishta, Fan Noli, Lasgush Poradeci, Mitrush Kuteli, Migjeni, Martin Camaj, Ismail Kadare, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Visar Zhiti, Xhevahir Spahiu, Frederik Rreshpja, Agim Isaku, Bardhyl Londo, Ilirjan Zhupa, Agron Tufa e shumë të tjerë. Janë botuar dy vëllime me poezi dhe një roman nga Visar Zhiti, të cilat konsiderohen si befasi të mëdha për lëçitësin rumun dhe kanë hyrë në vëmendjen e kritikës. Po kështu, kam përkthyer prozë shqipe nga prozatorë të mirënjohur shqiptarë, Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi, Agim Isaku, Visar Zhiti, Besnik Mustafaj, etj. Kurse për lexuesin shqiptar kam ofruar autorët rumunë të rangut të parë si poetin e madh rumun, Lucian Blaga, shkrimtarin dhe filozofin rumun, Emil Cioran, poetin kombëtar Mihai Eminescu, poetë bashkëkohorë, shumë të vlerësuar si: Nichita Stănescu, Ana Blandiana, George Bacovia, Cezar Ivănescu, Gabriel Chifu, Linda Maria Baros etj.

Përkthimi i një shkrimtari të rëndësishëm në një hapësirë tjetër kulturore bëhet pjesë e kulturës së atij vendi. Kur edhe përkthimi arrin nivelin e pritshmërisë, atëhere shanset që një libër i përkthyer të zgjojë interes dhe të asimilohet nga lexuesi i huaj janë të mëdha. Besoj se librat që kam përkthyer kanë pasur rastin të mirëpriten dhe të botohen nga shtëpi botuese me emër në të dyja vendet.

A.D: Ju, sikurse e cekëm edhe pak më lart, jeni edhe kryeredaktor i një reviste albanologjike, "Albanica" e cila botohet në Rumani. Cilat janë temat apo problematikat kryesore që ajo trajton dhe në ç'lamie ndihmon plotësimin e tablosë së kulturës shqiptare?

L.T: Revista "Albanica", revistë shkencore dhe kulturore, është organ i Shoqatës Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë. Ndodhet në shtyp numri 11 i saj. Revista është semestrale me rreth 250 faqe. Ilustrohet dhe me vepra arti, vizatime dhe grafika të piktorëve shqiptarë dhe rumunë. Emri i revistës ringjallet pas 83 vjetësh. Dr. Anton B.I. Balota, në vitin 1936, botoi revistën "Albanica" në Bukuresht, një revistë që propozonte, atëbotë, të ishte një nismëtare në filologjinë shqiptare. Fatkeqësisht, kjo nismë nuk pati vazhdimësi... Pas 83 vjetësh, me një frymë të re, u rimorr ky projekt i pezulluar në histori. Qëllimi i ringjalljes së "Albanica-s" është botimi i teksteve të rëndësishme, shkruar nga autorë rumunë, shqiptarë e të huaj që lidhen me gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare, me komunitetin shqiptar të Rumanisë dhe personalitetet e tij, me historinë e Shqipërisë, me marrëdhëniet e ngushta rumuno-shqiptare, duke përfshirë histori, letërsi, gjuhësi, antropologji, spiritualitet, sociologji, filozofi, muzikologji, arte etj. "Albanica" mbledh rreth vetes të gjitha forcat shkencore universitare si dhe forcat krijuese përfaqësuese të letërsisë dhe artit shqiptar dhe të albanologëve të huaj. Ajo u drejtohet elitave të Rumanisë, universitarëve dhe studiuesve të këtij vendi, të gjithë atyre që janë të interesuar për të njohur në mënyrë të thelluar kulturën dhe spiritualitetin shqiptar, përtej Shqipërisë së sotme, me historinë, antropologjinë, artin, gjuhësinë, letërsinë etj. Kështu, autorët e botuar janë personalitete të botës shkencore të djeshme dhe të sotme: Nicolae Iorga, B.P. Haşdeu, Sextil Puşcariu, Aurel Candrea, Gr. Brâncuş, Eqrem Çabej, Robert Elsie, Faik Domenik Konitza, Nilo Borgia, Lasgush Poradeci, Gisel Vahnese, Simon Sebag Montefiore, Margaret Hasluck, Anton Balotă, Alexandru Balaci, Paul Stahl, Victor Eftimiu, Stefan Zweig, Cătălina Vătăşescu, Mircea Muthu, Matteo Mandalà, Stoica Lascu, Bardhyl Demiraj, Daniel-Cristea Enache, Ina Arapi, Liviu Lungu, Radu-Cosmin Săvulescu, Constantin Scurtu, Manuela Nevaci, Dorian Koçi, Lavinia Dumitraşcu, Don Lush Gjergji, Marius Chelaru, Renata Topciu Melonashi, Daniela-Carmen Stoica, Holta Sina, Neli Naço, Piro Gaqi, etj. Kemi botuar medalione poetike për: Nënë Terezën, poetët Mihai Eminescu, Nichita Stănescu, Lucian Blaga, Cezar Ivănescu, Ana Blandiana Linda Maria Baros dhe poetë shqiptarë bashkëkohorë: Visar Zhiti, Luljeta Lleshanaku, Fatos Arapi, Bardhyl Londo etj. Gjithashtu kemi botuar prozë shqipe: Ismail Kadare, Mitrush Kuteli, Visar Zhiti, Agim Isaku, Thanas Medi, Ylljet Aliçkaj, Jusuf Buxhovi etj. Revista përmban *Dossiere* për Aleksander Moisiun, Gjon Milin, Edward Lear-n, Victor Eftimiun, Cezar Ivănescun etj. Faqet e revistës janë ilustruar me vepra të Ibrahim Kodrës, Abdurrahim Buzës, Guri Madhit, Gentian Zekës etj. si dhe nga piktorët e shquar rumunë: Corneliu Baba, Marcel Iancu, Iosif Iser, Alexandru Ciucurencu, Ion Țuculescu, Nicolae Dărăscu, Lucian Grigorescu, Dan Ercianu etj,



A.D: Prej vitesh tanimë, ju jetoni në Rumani. Besoj se mund të na thoni nëse ka pika përputhjeje mes kulturës dhe konteksteve shqiptare me ato rumune? Po qe se po, cilat janë?

L.T: Shqiptarët dhe rumunët janë ndër popujt më të vjetër të rajonit dhe Europës, me një histori të lashtë bashkëpunimi, shkëmbimesh, madje edhe bashkëjetese në periudha të gjata historike. Ekzistenca në të njëjtat kushte historike (pushtimi romak, bizantin, otoman, komunizmi dhe më pas periudha e tranzicioit drejt një sistemi demokratik) si dhe afërsia gjeografike, kanë rezultuar edhe në tipare të përbashkëta antropologjike dhe kulturore. Fondi i përbashkët gjuhësor në shqip e rumanisht është një dëshmi reale e kësaj bashkëjetese në një kuadër historik më të gjerë. Afiniteti shfaqet në të gjitha rrafshet e jetës materiale e shpirtërore, në letërsinë gojore, por edhe në atë të lavruar. Kështu që ekzitojnë të gjitha gjasat që edhe prodhimi letrar dhe artistik në përgjithësi të ketë pika takimi, tematika sigurisht, me nuancat përkatëse origjinale, varësisht nga aspektet specifike shoqërore, politike të akëcilit vend dhe nga ndikimet e ushtruara nga kultura e tjera fqinje ose jo.

A.D: A është i ndjeshëm ndikimi i pranisë së një komuniteti shqiptar atje në diversitetin kulturor rumun?

L.T: Prania e shqiptarëve në tokën rumune ka një histori të pasur. Fisërimi historik, gjuhësor dhe shpirtëror, si dhe afërsia gjeografike, i bëri shqiptarët të vendosen në veri të Danubit që nga periudha mesjetare. Shqiptarët ishin tregtarë të mirë, por edhe ushtarë të aftë. Më vonë u krijua një shtresë intelektualësh shqiptarë që u integruan shpejt në jetën e Trevave Rumune. Pas vitit 1990, me kalimin në regjimin demokratik, shqiptarët në Rumani filluan të rizbulojnë dhe të riafirmojnë identitetin e tyre, të ndihmuar nga politika e shtetit rumun ndaj pakicave kombëtare. Dua të theksoj se të gjitha botimet, përfshi dhe revistën "Albanica", financohen nga shteti rumun. Viteve të fundit, falë punës së shoqatës së shqiptarëve (ALAR), qendrës kulturore shqiptare, kultura shqiptare është gjithmonë e më e respektuar dhe e pranishme.

Shumë faleminderit!

GJERGJ FISHTA, MOSKUPTIME DHE KEQKUPTIME

Nga Frano Kulli

Përdorimi i ledhatuar e me mjeshtrí i shqipes, në korpusin e veprës letrare e publicistike të Gjergj Fishtës, komunikimi me lexuesin e vet, ndalet përdhunshëm pa kaluar 5 vite nga ndarja e tij këso jete, në dhjetorin e 1940-ës. Gjithë ajo pasuri gjuhësore e përdorur aty, por edhe me plot prurje të reja prej tij, të panjohura e të palëvruara deri atëherë, u ngurtësua; ju vù një rrasë e rëndë varri, aq e rëndësa ç'peshon një gjysë shekulli.

Duke mos u përdorë, ajo nuk lëvizi e nuk gjalloi, por në mënyrë sfidante ndaj forcës ndaluese e dhunës për leximin e veprës, ndërkaq ajo ishte e "hipotekuar" aty nëshkrimtarínëe tij. Por edhe në mbamendjen e padëmtuar të lexuesve të saj, e mbamendësit e panumërt oral, të cilët mund të recitonin deri mijëra vargje përmendësh, nga "Lahuta…"prej kah kishte edhe burimin gjuha e tij, si pasuri e madhe e paluajtëshme.

"*Në veprën madhore të Fishtës,* do tëshkruante Eqrem Çabej*, është pra njësia shqiptare, shpeshherë e panjohur, e cila ndrit së poshtmi më çdo anë. Atëhere nuk duhet t'ia marrim poetit për të keq, por duhet t'ia dimë përkundrazi për të mirë, që mori e përvetësoi gjithë të thjeshtën, të moçmen, të paprishurën atje ku e gjeti të ruajtur më mirë dhe që e ngriti në sferën e poezisë... Fishta zë fill me njësinë e vogël të fisit për të mbaruar te njësia më e madhe e kombit, ia fillon me bariun e moçëm Marash Ucin dhe ia mbrin te Abdyl Frashëri në Lidhjen e Prizrenit."*[1]

Sado u pengua…, dikur vonë, fort vonë, i erdhi radha të hiqej ajo "rrasa e randë" e mbylljes së dhunëshme; vepra e Fishtës do të ribotohej e plotë, por tashma me ngërçin e madh të moskuptimit për **shkakuna pretekstin** e vjetërsisë së gjuhës së saj.Këtu buron nevoja që ajo kishte për spjegime të shumë e shumë fjalëve e shprehjeve, për të mënjanuar moskuptimet prej së vërteti tëatyre të dalave jashtë përdorimit tashma; në të folmen e nëtëshkruarën, po se po. Sidomos, të keqkuptimit të frazeologjisë aq të begatë të Fishtës.Vlera kulmore të tij këto, që e kishin kurorëzuar POET KOMBËTAR, qysh në gjallje, në bashkëkohësinë e vet. Gjë që vetëm njëherë dhe vetëm me Fishtën ka ndodhë në historinë e letërsisë shqipe. **Poet Kombëtar pa asnjë mëdyshje e quan Eqrem Çabej**, ky albanolog i pa qasje me të tjerë, i pakrahasueshëm, që rrezatonte kulturë evropiane. Jo vetëm për shkak të gjithë ciklit të studimeve të veta; të mesme, të larta dhe ata doktorale, që kishte kryer në Austri, porse gjithë jetën e vet studimore më pas e çoi në këtë frymë e në këtë rrugë. Ai shprehet:*"Fishta arrititë ngrejë kështu veprën* ("Lahuta e Malcis") *në sferën kombëtare... vepra e tij ka marrë karakterin e një eposi kombëtar. Te ky[Fishta] e kaluara dhe e ardhmja e këtij kombi janë pjekur fatalisht në një pikë simbolike me njëra-tjetrën.*Ai madje shton se:*"nuk mund ta përflasim poetin që ka marrë për lëndë të poemit të tij një trevë njerëzore gjeografikisht kaq të ngushtë; sepse te kjo botë e përshkruar prej tij njohin vetveten jo vetëm Malësorët e Veriut, por gjithë banorët e maleve shqiptare, ata të Verilindjes (Kosovë), të Lindjes (Dibër) e të jugperëndimit (Labëri)"*[2]

Rrekja për mbushamendjen e moskuptimit për shkak të gjuhës. Shkaqe dhe pretekste:

Nëse me të vërtetë duhet ta pranonim vështirësi në kuptimin e gjuhës së Fishtës dhe të kërkonim një shkak, a më saktë ta konsideronim të tillë një ankesë që vjen prej s'andejmi, shkaku do të qe diku ndërmjet:pasurisë leksikore të autorit dhe "varfërisë" leksikore të lexuesit të tij të sotëm. Shkëputja e gjatë shkrimtar-lexues padyshim që e ka krijuar një përthyerje, në mos në kuptimin, në shijimin e veprës së Fishtës.

Fishta është autori me fjalëformimin më të pasur ndër autorët shqiptarë. Nga më shumë se 12000 leksema e terma të spjeguara dhe të paraqitura në një fjalor që këto ditë del nga shtypi, (përgatitur: Frano Kulli) dominant është numri i fjalëve të krijuara prej tij; si fjalëformim i vetë autorit. Në veprën e një poeti mjeshtër dhe kaq të lëmuar të letërsisë shqipe të traditës si liriku i pashoq Ndre Mjeda, numrohen 5671 fjalë. Kaq është numri i saktë i fjalëve të "Fjalorit të plotë të nxjerrun nga shkrimet e Mjedës"[3], hartuar e përgatitur nga studiuesi Kolë Ashta qysh në vitin e largët 1964, i pabotuar, që ndodhet në arkivin e Akademisë Albanalogjike të Shqipërisë.

Kjo ndarja ndërmjet pasurisë leksikore kaq të madhe të poetëve tanë mjeshtra dhe varfërimit të leksikut të lexuesit, prej mospërdorimit të thesarit të tyre, ka qenë dhe është një dëm,vështirë i rikuperueshëm. Ka ndodhë fenomeni i një letargjie të gjatë, i një gjumi vdekatar në këtë rast, nëse gjuhën dhe procesin e leximit nëpërmjet saj i marrim si një organizëm të gjallë. Me shumicën e letërsisë së autorëve të veriut ka ndodhë kështu, janë anatemuar vetëm e vetëm që letërsia e tyre të mos të mund të vijonte konkordancën (pajtimin)me shpirtin e lexuesit të vet, duke e konsideruar si akt pengues për rregjimin politik të kohës, për shkak të ideve të papërputhëshme dhe veprës së tyre shkrimore. Po me Fishtën kjo ka ndodhë më hatashëm se me të gjithë...E megjithatë, pas një arsyetimi e hulumtimi të thelluar arrihet në pohimin se në moskuptimin e Fishtës për shkak të gjuhës, **pretekstet i dominojnë shkaqet:**

Fishtën ende **nuk e duan poet** ata që rëndom e barazojnë me "Lahuta e Malcis' "Nuk e duan poet ata që thonë, qoftë edhe nën zë se Fishta është vetëm "Lahuta". Edhe pse ajo është kryevepra e tij. "Lahuta ..." nuk është Fishta. Fishta poet është shumë më shumë se "Lahuta…". Na vjen në ndihmë të këtij pohimi, posë dhe tw tjerwve, prap liriku i shquar Lasgush Poradeci:*"Vajta ta shoh rishtas në 1937, në Shkodër... Në librin tim të falur i kisha shkruar pjesën e njëqindtë nga ç'desha:"Njeriut të Zotit, meditans e militans, Burrit shqiptar përfaqësonjës, më të madhit epik të shekullit."*[4] Kurse në një analizë që bën mbi lirikën e Fishtës e quan poetin koleg *" shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar"* dhe vazhdon: *"Ky është, si të thesha monopolariteti gjenetik i artit të Fishtës, kështu do t'i thesha më dy krahasime paralele gjithë poezisë që na ka falur ky vigan i Kombit..."*[5].

Është shfaqë edhe synimi shvleftësues, në ndonjë analizë stilistikore, po krejt të sipërfaqëshme, buruar prej ndjesive të xhelozisë, më shumë se prej arsyeve të tjera, besojmë. Arti i Fishtës është përçmuar si ***folklorizant***. Duke i vënë përballë vargun e lirë e modernitetin e tij tek Migjeni; duke krahasuar të pakrahasueshmet. E duke mënjanuar faktin që vetë Fishta nuk qe aspak përjashtues por veçse vlersues e inkurajues për talentet e shkrimtarisë së kohës së vet. Sidomos për më të rinjtë. E jo veç i Koliqit, bie fjala, por edhe i Migjenit. Ai e çmonte "djaloshi i talentuem", kur ndër biseda me të, bashkëvllazën françeskanë i shfaqnin mospranim për idetë a poezitëe tij e madje e cytnin duke i thënë: :"Pader, duhet me ju pergjegjë këtij Migjenit..". E poeti pati dhënë atëherë këtë përgjigje për bashkëvllaznit:*"Lenie rahat djalin e Gjushit [Gjergjit] se asht ende i ri. ",* pohojnë bashkëkohës se u thoshte Fishta për të.[6]

Fishten nuk e duan dramaturg...

Fishtën e citojnë dhe e përmendin rrallë si *dramaturg*. Ani pse ai është autor i 40 dramave e melodramave, të shkruara a të përshtatura. Me shkrimtarinë e vet në gjininë dramaturgjike(që kryesisht është e shkruar në vargje), por dhe me vënien në skenë, thuajse të shumicës së veprave të këtij zhanrri, Fishta u shenjua vetëdijshëm si themeluesi i teatri shqiptar. Dhe ndërmend të vjen e të rivjen autografi që Lasgushi i shkruan në librin dhuratë: *meditans e militans*[ëndërrimtar dhe **luftarak**].

Veprimi i tij për teatrin zë fill që më 1902. Asokohe, salloni në Kuvendin e Françeskanëve në Shkodër, ku ishte edhe "rezidenca krijuese e shkrimtarísë së Fishtës" u kthye edhe ndër sallat e para në atë qytet e më përtej, sallë shfaqjesh ku filloi të kumtohej shqip.(Pak më vonë, me 1919, në Gjuhadol, në oborrin e shkollës fretnore u ndërtua një sallë tjetër[7], një sallë me 300 ndenjëse për spektatorë) Dhe vetëm shqip. Këtë pati kurajë ta bënte Gjergj Fishta, i cili, edhe kur përdorimi i shqipes ende qe i ndaluar nga Perandoria Osmane e futi atë si gjuhë mësimi në shkollat françeskane (liceun françeskan "Illyricum" dhe në shkollën e motrave stigmatine) kur ishte drejtor i këtyre shkollave. Studiuesi Tonin Çobani[8] na kumton se: *" Aty* [në sallonin e fretënve] *mendohet se u shfaqën dy skeçet origjinale të Fishtës ("Autori, Shtypshkronjësi" dhe "Përpara derës së Parrizit"), komeditë "Mjek përdhuni"(1905) dhe "I ligu për mend" (1908), të dyja sipas Molierit, si dhe dy pjesë origjinale me karakter didaktik: "Gjuha e Mësimit" (1907) dhe "Nevoja e mësimit" (1907).* Kurse Faik Konica, në esenë e tij të gjatë "Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës juglindore shkruan:*"At Fishta është marrë me secilën gjini letrare dhe në të gjitha ka qenë i suksesshëm"*[9] edhe pse në Europë e përtej, në fakt ai qe i njohur prej "Lahutës..." kryesisht dhe prej veprimit të tij , sidomos diplomatik...

Fishtën nuk e duan satirik, kur thonë se "Gomari i Babatasit" (1923) e kishte shkruar me mllef. Atë, poemën e gjatë(3880 vargje, siç shënon autori)me satirë shpartalluese për burokracinë e kalbur të shtetit të sapolindur shqiptar. E shijueshme dhe milituese (*militans*) edhe sot, gati njëqind vjet më mbas.Që ende "tremb" e trand fort, sa atëherë kur u shkrua. Me forcën fshikulluese të verbit të zgjedhur po dhe me aftësinë kreative, të fuqishme, po edhe elegante polemizuese.

"*Siç është vërejtur, "Gomari i Babatasit dhe "Visku i Babatasit", janë shenja të larta emancipimi mendor e shoqëror të shqiptarëve, të cilët nuk na kanë lënë, për fat të mirë pa dëshmi dinjiteti për të përballuar të vërtetën. Në këtë pikpamje, kjo vepër mund të krahasohet, siç është krahasuar me "Udhëtimet e Guiliverit" tek anglezët, me "Shpirtrat e vdekur"*

1 Tonin Çobani, Ndue Ballabani:"Gjergj Fishta-vite, vende, vepra", fq.332
2 Gjergj Fishta, botim përkujtimuer nën drejtimin e revistës Shkëndia, Tiranë, 1941. fq.36.(Eqrem Çabej, "Epika e Gjergj Fishtës").
3 Kolë Ashta, "Fjalor i plotë i nxjerrun nga shkrimet e Mjedës", dorëshkrim.
4 Tomorri i vogël: vjeti i II i datës 1 kallnor 1943
5 Gjergj Fishta:Shkëndija, numër përkujtimuer, (L.Poradeci artikulli:"Gjergj Fishta lirik)1941, fq.24
6 Pohim i dëgjuar prej meje nga At Shtjefen Pistulli(1922-2008), ish nxënës në Liceun Illyricum, 1930-1938
7 Lec Shllaku, Maskat shkodrane-Kur lindej teatri, fq.60
8 Tonin Çobani, Ndue Ballabani:"Teatri i Gjergj Fishtës", fq.132
9 Faik Konica:"Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës juglindore", Tiranë 2006, fq.83

tek rusët, me "Gjermania-një përrallë dimri" te gjermanët etj.- shkruan studiuesi Stefan Çapaliku.[10]

Edhe tani, para dy vjetësh, kur u vu në skenë "Gomari i Babatasit", në Shkodër salla e teatrit qe plot për disa netë, po nga zyrat u patën shigjetuar me turivarje...

Fishtën e duan me patjetër profashist, proitalian e gati antishqiptar. Atë, hartuesin e fjalimit brilant në organizatën e kombeve:*"Shqiptarët e të drejtat e tyne",* kryetarin e komisionit të alfabetit në kongresin e Manastirit, ku u konsakrua(shenjtërua) alfabeti i gjuhës shqipe.Të vetmin ndër shqiptarët e shquar që e shërbei çeshtjen kombëtare shqiptare, me të gjitha mënyrat e mjetet e mundshme, këtu, në Shqipëri. E jo mërguar. *"Me aq zavalle[halle, telashe] krejet/sa me t'u ba me dalun fejet,* siç ai vetë thotë e shkruan.

Nasho Jorgaqi, njëri prej tyre, shkruan[11]: *Për fat të keq, kleri katolik shqiptar, që trashëgoi një traditë të shkëlqyer në historinë tonë kombëtare, në prag dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk u gjend me ato forca që u hodhën në luftë kundër pushtuesve fashistë. Përkundrazi, kleri katolik, në një mënyrë a në një tjetër, i hapi rrugën pushtimit italian, e mirëpriti ushtrinë agresore, duke i cilësuar legjionet e saj "pëllumba të Krishtit", e mbështeti "rendin e ri fashist" dhe u vu në rolin e bashkëpunëtorit të tij...* Dhe në qendër të arsyetimeve, për të përmbushur idenë e paracaktuar, vihet Fishta: *"Fishta, dashur pa dashur, flirtoi dhe u kthye ose u përdor si ithtar i pushtuesve".* Në të vërtetë, asnjë personalitet shqiptar i kulturës, rezident i përhershëm në truallin ku lindi, nuk ka marrë nderime e vlerësime të pafundme superiore sa At Gjergj Fishta, në gjallje të vet, i rrethuar me lavdi si askush deri atëherë në Shqipëri. Njëri syresh, Luigi Federzoni, shkrimtar, publicist dhe politikan i rëndësishëm i kohës,[Ministër i fashizmit] pas vdekjes së Fishtës shkruan: *Në të [Fishten] kemi pa se gjallonte e rrahte zemra e shpirti i kombit fisnik shqiptar me të gjitha bukuritë e miteve origjinale, të traditave mistike e kalorse, të dokeve besnike të vjetërsisë, të ndjenjave heroike. Secili nesh ka kuptue se Gjergj Fishta kishte me të vërtetë lartësinë e Poetit Kombëtar. Tashti e dijmë se vepra ka për të mbetë në mende e në nderim të shqiptarëve*[12].

E kush do të ishte më i interesuar se ai t'ia njihte Fishtës "meriten" e të qenit fashist ?

Kurse gazeta e parë e Italisë "Corriere della sera"[13], me 31 dhjetor 1940, lajmin e vdekjes së Fishtës, poetit kombëtar shqiptar (Il poeta nazionale albanese) e përcjell me një artikull të gjatë, ku ndër të tjera shkruan:...*Mbasi u ba nji ndër eksponentët kryesorë të Shqipnisë së ringjallun, ai mori pjesë në Konferencën e Paqës në Paris dhe ma vonë u emnue deputet dhe zevendës-kryetar i parlamentit. Në shenj mirënjohje, si mik i sinqertë i Italisë, për meritat e tij ndaj vendit të vet dhe për vlerat e botimeve të tij, u ftue në majin e shkuem me marrë pjesë në Akademinë Mbretnore të Italisë...*Dhe aspak e askund edhe këtu nuk përbashkohen Fishta me ... fashist.

Ndërsa, italiani Enrico Grassi, që e kishte njohur nga afër poetin, duke folur për popullaritetin e tij në të gjitha shtresat e popullsisë, pohon se, prej disa të rinjve shkodranë kishte dëgjuar se fjalët e fundit të shenjta të Fishtës kishin qenë: *Jo për tjetër, por sepse po lë armikun mbi truallin shqiptar, mua më vjen keq që më duhet të vdes.*[14]

Ndërkohë, Lasgush Poradeci[15] ka shkruar se mesazhi i fundit i poetit Gjergj Fishta janë fjalët e tij, thënë një françeskani që i qëndronte te koka në çastet e fundit: *"Po vdes. Ju tash keni me mendue për salikim, por, fundi i fundit, dhe kombi ka të drejtë mbi mua"*, duke e përqasur kështu me Amanetin e Dante Aligherit: *"del resto, anche la nazione ha dei diritti su di me".*

I mosmirëkuptuar edhe prej eprorëve të vet

Dashunia për Atdhenë këtu në Shqipni, po ishte nji faj, nji mëkat, nji delikt [krim]...dhe kjo kufomë e shkretë na dëshmon ne si ndëshkohet faji i atdhedashunisë"- janë dy rreshta të shkëputur nga fjalimi që vetë Fishta mban në varrimin e Avni Rrustemit. [16] Një fjalim , i cili edhe për rrethanat e momentin kur u mbajt, pati jehonë të madhe. Me pranim e pëlqim po edhe me kundërshtí të forta. Madje pati qortime serioze prej "të vetëve". Vetë Ministri i Përgjithshëm i Urdhërit Françeskan në Romë, Padre Benardino Klumper OFM, në letrën dërguar Provinçialit tëFretëve në Shkodër, At Pal Dodaj, me 2 qershor 1924[17], shkruan: "...*Rregulltarët tanë [françeskanë] merren me politikë e kanë mbërrijt deri aty sa të mburrin të riun që ka vra Esat Pashën në Paris, qoftë në revistën "Hylli i Dritës", si dhe duke e lavdërue në publik, mes popullit...Nëqoftëse nuk do ta ndreqin shpejt, Kongrecacioni i shejtë i Propagandës do të marrë masa të randa, si me ndalimin e botimit të revistës, si dhe ndëshkimin shembullor të rregulltarëve..."* Dhe fjala është për Gjergj Fishten, kuptohet. Qortimi mbështetet në qëndrimin kategorik që Kisha dhe feja ka mbi vrasjen. Arsyeshëm deri këtu.Mjafton të kujtojmë Urdhnin e 5-të (Mos vrit) të dhjetë Urdhnimeve (Dekalogut). Në përputhje me të është e ndaluar vrasja, madje edhe vetvrasja, pse jeta nuk është e jona , është e Zotit.

Mirëpo Fishta, me parimsinë që e karakterizon i përgjigjet Kongregatës së Propagandës Fide, pra eprorëve të vet me një letër-përgjigje, me dhjetë pika. Në thelb ai mbron gjithë veprën e françeskanëve shqiptarë në dobi të atdheut e të kombit dhe thekson se ajo , asnjëherë nuk ka qenë përkundër parimeve të fesë e të Kishës. Edhe, për vrasjen në fjalë ai është konseguent në argumentin e vet. Sipas studiuesit Kolec Çefa: *Ajo vrasje, sido e paligjëshme nga morali i fesë, ka vrarë faje të tjera në kokë të Esatit* [që kishte tradhëtuar interesat e kombit] *dhe ka qenë e dobishme për të mirë të popullit tonë. Shkurt, ajo vrasje, mendon poeti, do të sjellë punë të dobishme për të gjithë popullin e atdheun tonë."*

Keqkuptimet, si interpretim jashtë kontekstit:

Ka pasë një keqkuptimin shpartallues në dëm të autorit dhe të veprës, që ka vijuar gjatë me dekada, shkëputja nga konteksti logjik dhe satirik i poezisë Methamorfphosis, (1907) i strofës:

Ta dijë Shqypnija
Pra, e shekëlli mbarë,
Se mâ mbas sodit
Unë s'jam Shqyptar...

E shkëputur kështu dhe e injektuar, tek "njeriu i ri" i kohës së rregjimit, si element propagandistik, që shkonte i sinkronizuar me gjithë urdinë propagandistike në rroposjen e Fishtës, ajo shkëputje ka shërbyer si "argumenti" i "tradhëtisë së madhe" të Fishtës përgjatë gjithë kohëterrit gjysëshekullor që e shoqëroi autorin dhe veprën në diktaturë. Se, mjafton të bashkëlidhim fillin e poemthit satirik nga strofa e parë:

Qe besa, or burra
Nuk di kah t'çajë,
Mbasi do t'thirret
Sot derri dajë...

Me anmiq t'Shqipnisë
Unë, pa u frigue,
mjaft jam, i mjeri,
kacagjelue.

Pse kam pasë thanë
deri sivjet:
Lum ai qi shkrihet
Per Atme t'vet.

Edhe kam pritë,
Mbas k'tij mendimi,
Trimnisht për atme
Çfarëdo ndëshkimi....[18]

Rrëzohet kështu ajo "kështjella e ndërtuar mbi rërë", që banalisht realizohet me shkëputjen kontekstuale, logjike e satirike mbi të cilën është ndërtuar poemthi.

Në përmbyllje, një tjetër theks për t'u shënuar: keqkuptimi dhe moskuptimi ende vazhdon. Në të tjera forma e mënyra më të stërholluara. Kryesisht me harresë e shpërfillje. Prej kritikës, prej shkrimtarëve, prej shkollave, prej mediumeve...e prej zyrave po se po.

10 Stefan Çapaliku: nga "Fishta satirik", Pasthënia e "Gjergj Fishta-vepra 8, Satira" , fq.211
11 "A flirtoi Gjergj Fishta me pushtuesit fashistë", gazeta Dita, 2 tetor 2016

12 "Gjergj Fishta" numër përkujtimuer, botuar nën kujdesin e revistës "Shkëndija", Tiranë 1941, fq.6.
13 "Corriere della sera", 31 dhjetor 1940
14 Enrico Grassi, "Giorgio Fishta, spirito di fiamma e di luce-fryma e flakës dhe e dritës " në Gjergj Fishta,botim përkujtimuer, nën kujdesin e Shkëndisë, vepër e cituar, f.101.
15 Lasgush Poradeci, Vepra 2, Onufri, Tiranë, 1999, f.68

16 Gjergj Fishta, vepra 10, botime Fishta, Lezhë 2012,Fjalimi mbi varr të Avni Rrustemit, fq.250
17 Kolec Çefa, "Nëpër gjurmët e Fishtës", fq.11
18 "Methamorphosis", Gjergj Fishta vepra 10, fq.35

Corriere della Sera, 31 dicembre 1940 — Anno X

La morte di Giorgio Fishta il poeta nazionale albanese

Roma 30 dicembre.

Giunge notizia da Scutari che in seguito a un attacco cardiaco è morto colà stamane il padre Giorgio Fishta dell'Ordine dei frati minori, accademico d'Italia e insigne letterato albanese.

Il Fishta, che era nato presso Scutari nel 1871, era il grande poeta nazionale albanese. Entrato nell'Ordine francescano, compì gli studi ecclesiastici in Bosnia e rientrò in patria dopo ricevuti gli ordini sacerdotali. A Scutari fondò la scuola francescana e iniziò la pubblicazione del periodico *Hylli I Drites*. Molte sono le pubblicazioni culturali e letterarie a cui il religioso diede vita e incremento. I suoi poemi, le sue composizioni drammatiche e i suoi scritti furono fin dall'inizio volti in genere a dare impulso al risveglio della coscienza nazionale albanese. Come direttore per le Scuole pubbliche dei francescani di Scutari introdusse in esse la lingua nazionale nel 1902, quando essa era rigorosamente proibita dal Governo ottomano.

Quando, dopo l'elargizione della costituzione turca avvenuta nel luglio 1908, gli Albanesi, che avevano avuto una parte importante in quella rivoluzione, vollero raccogliere le loro forze intellettuali e raggrupparle in un'intesa comune, la prima difficoltà da superare era di ottenere l'unificazione del l'alfabeto. Al congresso albanese riunitosi a quello scopo partecipò il padre Fishta, il quale riuscì a far accettare l'alfabeto latino, reso poi unico e ufficiale per tutta l'Albania. Divenuto uno dei principali esponenti della risorta Albania, partecipava alla Conferenza per la pace a Parigi e più tardi veniva nominato deputato e quindi vice-presidente della Camera. Sincero amico dell'Italia, in riconoscimento delle benemerenze verso la sua Nazione e per il valore delle sue pubblicazioni fu, nel maggio scorso, chiamato a far parte della Regia Accademia d'Italia.

Fra le numerose pubblicazioni del padre Fishta sono importanti quelle poetiche ispirate in generale a leggende albanesi e tendenti soprattutto a celebrare il sentimento nazionale. Oltre a un poema in trenta canti dal titolo *Lahuta Malcis*, egli ha scritto inni sacri, liriche varie e satire di carattere politico.

Luigi Federzoni ha provveduto perchè l'Accademia d'Italia sia rappresentata ai funerali e ha inviato telegrammi di condoglianza alla famiglia, al Presidente del Consiglio dei ministri d'Albania, al ministro della Pubblica Istruzione, ai padri generali e provinciali dei frati minori e al presidente dell'Istituto Scanderbeg di Tirana, del quale l'illustre scomparso era membro.

NJË DRITARE E RE EUROPIANE PËR POEZINË SHQIPE

Nga Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)

ANTHOLOGY OF YOUNG ALBANIAN POETS

ANTOLOGJIA E POETËVE TË RINJ SHQIPTARË/
ΑΝΘΟΛΟΓΊΑ ΝΈΩΝ ΑΛΒΑΝΏΝ ΠΟΙΗΤΏΝ
Vakxikon Publications, Athens, 2021
Antologe dhe parathënia:
Dr. Jorina Kryeziu (Shkreta)
Përktheu në greqisht:
Asimina Xirogianni
Autorët e përfshirë:
Viola Isufaj, Alisa Velaj, Ledia Dushi, Ani Gjika, Azem Qazimi,
Belfjore Qose, Ervina Halili, Rudina Çupi, Nurie Emrullai, Kushtrim Thaqi

Antologjia në fjalë, e titulluar *Ανθολογία νεών Αλβανών Ποιητών/ Antologji e poetëve të rinj shqiptarë*, vjen e radhës, në vazhdën e projektit evropian *Anthologies of young poets* (*Antologjitë e poetëve të rinj*) – nismë e ndërmarrë nga *Βάκξικον Εκδόσεις* (*Vakxikon Publications*), me vendndodhje në Athinë. Përmes saj mundësohet njohja dhe përfshirja e poetëve shqiptarë, bashkëkohëzuar me poetët e tjerë evropianë. Botuesi paraqet përpara lexuesit një antologji dygjuhëshe, ku krahas krijimeve poetike në gjuhën burimore pranëvendosen edhe përkthimet në gjuhën greke.

Përzgjedhja e poetëve të rinj shqiptarë është menduar me kujdes të posaçëm, për të përfshirë e për të përzgjedhur edhe ata të cilët shkruajnë përtej kufijve administrativë të Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut po dhe në Diasporë. Përmes prezantimit të krijimeve të tyre poetike, synohen të sillet në sistemin pritës përvoja të vyera të poezisë së sotme shqiptare, duke vërejtur mes syresh se nuk shkruhet vetëm në shqipen standarde, por edhe në dialektin gegë – kësisoj është respektuar dhe vlerësuar zgjedhja autoriale e gjithsecilit. Karakteristikë e subjekteve lirike është se e lëvrojnë poezinë kryesisht si pasion vetjak, duke mos e pasur profesion të parë të shkruarin; kujtojmë këtu se disa syresh edhe pse janë poetë, prozatorë, estetë etj., vijnë prej botës akademike, janë studiues, përkthyes, kritikë etj. Përveç vëllimeve poetike të botuara apo përfshirjeve në antologji, kemi vënë re se më së shumti këta poetë i kanë publikuar krijimet në revista letrare kombëtare e ndërkombëtare, duke bërë që poezitë e tyre të qarkullojnë në disa gjuhë, si: anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, rumanisht, portugalisht, turqisht, suedisht, polonisht, maqedonisht, greqisht, serbisht, kinezisht etj. Një pjesë e tyre kanë mbaruar studimet për "Gjuhë-letërsi", si: prof.asoc.dr. Viola Isufaj, dr. Ledia Dushi, dr. Alisa Velaj, dr. Belfore Qose (Zifla), Rudina Çupi, Nurie Emrullai; gazetari: Azem Qazimi; letërsi angleze dhe poezi: Ani Gjika; ekonomik: Kushtrim Thaqi (shih *biot* shoqëruese në *Antologji*); e deri tek ata që kanë filluar të shkruajnë poezi qysh në fëmijëri – rasti i poetes Ervina Halili, e diplomuar për teori letrare dhe psikanalizë, e cila në moshën 11-vjeçare shkroi krijimin e parë, të titulluar *Turma 97*, ndikuar prej makinës së shkrimit – si relikt – dhe protestave masive studentore të Universitetit të Prishtinës, duke i përthyer çastet e përditshmërisë dhe imazhet hipotetike në art poetik.

Kjo pasqyrë poetike – e prezantuar përpara lexuesit evropian e më gjerë – nuk është lënë vetëm në dorë të përpiluesit, shijeve vetjake, rastësisë apo dashamirësisë për secilin zë të fuqishëm poetik, por janë përzgjedhur për krijimtarinë, stilin, risitë e sjella në poezinë e sotme shqipe. Disa prej tyre kanë qenë pjesëmarrës në festivale poetike ose/dhe nominues a fitues të çmimeve letrare kombëtare e ndërkombëtare, siç është rasti i poetes Ani Gjika (çmime nga National Endowment for the Arts, English PEN, Framingham State University's Miriam Levine Reader Award), poetja Alisa Velaj (në shortlistë për Erbacce-Press Poetry Award, 2014), Ledia Dushi ("Pena e artë" për vëllimin *Ave Maria bahet lot*) apo Viola Isufaj, Ervina Halili, Kushtrim Thaqi, Belfjore Qose (Zifla) etj.

Vëmendje e posaçme u është kushtuar emrave të përzgjedhur, e më duhet t'ju parashtroj se kjo detyrë ishte sa privilegj aq edhe përgjegjësi. Në vendin tonë asnjëherë nuk mungojnë botimet e vëllimeve poetike, veçse jo kushdo mund të përfaqësohet ndërkombëtarisht me poezinë që krijon. Prej poetëve që mëtojnë të jenë pjesë e një antologjie është parë e udhës që intuita artistike dhe risitë, që vijnë përmes artit të fjalës, të rezultojnë të suksesshme, në mënyrë që përçapjet për t'u marrë me këtë lëmi të jenë të denja e të ngjallin emocion edhe në sistemin pritës. Mund të themi se për çdo vit prurjet janë dhe mbeten të larmishme, por për të ardhur deri në një paraqitje përtej kufijve të vendit të origjinës, duhet të pranojmë se përveç vlerave mirëfilli poetike duhet të merret në konsideratë edhe veprimtaria e gjithsecilit, sa i përket mirëdrejtimit në zhanrin poetik. Pikënisjet përzgjedhëse nuk janë rastësore, por qëmtim i vlerave artistike, të cilat ngjallin emocion dhe shpeshherë shpërbëjnë 'kornizat' e poezisë, duke u paraqitur në trajta të reja jo vetëm të planit të shprehjes, por edhe si risi të formës, duke bërë që poezia të jetë "shprehje e asaj që është nën, që gjendet nën tingujt e heshtur të pëshpëritjeve" (K. Thaqi).

Urojmë që lexuesi ndërkombëtar të shijojë antologjinë e poetëve të rinj shqiptarë, si një komunikim mirëfilli artistik e kulturor i poetëve tanë, të cilët shfaqin vlera dhe aftësi krijuese, lëvrojnë stile të ndryshme, shpesh edhe të skajshëm mes tyre, duke dëshmuar heterogjenitet stilesh, të dallohen për qenësinë poetike autentike, shprehjet ambige, sugjestionet dhe asociacionet e përfytyrim-mendimeve, abstraksionet metaforike e deri te format ezoterike e ato eliptike.

Lexim të këndshëm të disa prej poezive në gjuhën shqipe!

NURIE EMRULLAI

Atij që erdhi

Ti je pjesa më e trishtuar e trupit tim:

Një gisht i thyer kur të mbaja për duarsh,

Një dhëmb i rënë prej fjalëve pavend,

Ca flokë të thinjur nga pyetjet e kota...

Po s'do e doja veten pa këto, jo.

Ti je pjesa më e trishtuar e shpirtit tim:

Kujtime të harruara deri te detajet më të zakonshme,

sy të zbehtë që i përvidhen të tanishmes,

buzëqeshje e formuar nga trishtimi,

puthje e dhënë shkarazi dhe kur je vetëm.

Një ëndërr e parë veç për ta harruar mëngjeseve.

Trëndafil i këputur vjeshtës së vonë,

I vyshkur tashmë.

Një gjeth i shkelur në tokë

Nga kalimtarë që nuk nguten për askund.

Askush as nuk i kërkon.

Ti je

Një dridhje e lehtë toke

Dhe veç ata që e presin dridhjen të ndjejnë.

Ti je një kuti shkrepëse

E lagur nga shiu në pallton e njeriut që s'pi cigare.

Ti je ballë i rënduar

Nga hallet që s'qenë kurrë të tuat.
Ti je lule dielli, që diellit kurrë si ra ndërmend të të rrisi.

Ti je vetë dritë dielli por, parë në netët me hënë.

Ti je ylber krijuar
Veç me një ngjyrë...

Ti je çast
I pajetuar
Dhe të të jetonte kush
S'do kishte guxim.

Ti mund të jesh gjithçka për dikë
Po asnjëherë ndjenjë.

Ti je pranverë e vonshme jetuar në dimrin e hershëm.

Ti je ujë i mbledhur nëpër duart e atyre
Që digjen nga etja.

Je një vijë e hollë
Varur në mur
Që imiton hijet e njeriut.

Ti je një zë
Ardhur nga pylli atëherë kur ishte lule malli.

Andaj je ngjyrë dheu.

Ti je njeriu i parë
Që erdhe,
që puthe,
që dhe
Atë
që askush s'mund ta jepte para teje.

Ti je ajo gjuhë e vdekur
Që jep jetën e një bote të pajetuar.

Je çdo shkronjë që s'mund të shkruhet,
Çdo tingull që nuk shqiptohet.

Çdo pasthirrmë që shuhet nga heshtja
Dhe unë të thërras nga toka e nëndheshme.

Eja këtu i dashur pranë meje,
Dhe ji çdo gjë në mua, veç ji. Ashtu siç je, veç dhé.

Gjithë trishtimi i trupit dhe shpirtit tim, ji!

VIOLA ISUFAJ

Lëvdatë – [Haleluja!] Për një zot të vdekshëm

I dhuroj madhërimit të natyrës një lëvdatë
Se imzot s'meriton më dhuratë
Veçse shkuma e detit si flokët e tij është
Dhe mëndafshi – çka isha unë për të
Në një pandehmë të çiltër
Tymi i hirtë i përngjet mërzisë së tij, pa dyshim
Në çastin kur duart vë mbi kokë
Dhe uragani i purpurt marrëzisë
Dafinat ku drita derdhet janë lavdia e tij
Dhe degët e ullirit shpatullat e tij
Puhia është fryma e tij kur më do
Dhe avujt e ftohtë janë fjala e tij gjithmonë
Dielli në kalimin mrekullor
Është ecja e tij mes reve
Dhe mes turmës së damave
Dëshiroj të shijoj ngazëllimin e natyrës gjer në asht
Se imzot s'meriton më lëvdatë
***
Po hajt ta falim zotin tim
Dhe cipën e hollë prej ferri Rrudhë – mbi petka të tij
Veçse udhës së tij të eci mos më thoni më kot
Dhe palmat e tij në rërë, mos më thoni t'i përqafoj
Dhe të keqen s'e rrëfej që s'e rrëfej dot
Po hajt ta falim... Ta falim timzot!

ALISA VELAJ

Arie e një të shastisure

pas dy gotash xhin

(*Scottit iu deshën dhjetë vjet që ta kuptonte se Zelda ishte e çmendur.*
Marrë nga "Një festë që e ke gjithnjë me vete", Ernest Heminguej)

Hej Scott,
I treti xhin që po rrëkëllen sonte!
Trinia s'është bekim në përgjumjen e trurit.
Unë dhe ti iu lutëm Jezuit për çdo herë
Dhe ndoqëm udhë të gabuara prej fillimit.
Lëmshi i Ariadnës fati im dhe yti...
Hija e Zeldës sërish të endet bebëzave
Ashtu si pa kokëçarje
Si pa asnjë pendesë...

Pendestarë janë shpirti im dhe yti, Scott,
Për të pamundurën që s'e kuptuam kurrë
Dhe sytë tanë të verbër për të parë errësirën
Ku ecin majtas djathtas ca qenie të çoroditura
Me sy, rrashtë e ashtë, sikundër krejt njerëzia.

Të betohem, për shpirt të të shtatë kryëngjëjve, mik,
(Zoti më faltë kur nuk kam kam fuqi
Të nxij a të zbardh asnjë fije floku)
Për shpirtin e tyre të betohem, Scott,
Zelda ishte bijë e motër imja
Po se ishte nënë unë nuk e dija, i dashur,
Nuk e dija!

Bijës së saj të parëlindur
Farës sate të frymëzimit dhe përhumbjes së saj
Qiellin s'ia mësuam dot as si nostalgji...

Mahnitur fushave, ku këngën bilbilave s'ia ndal askush
Vogëlushja e mjerë i trembej dritës
Njëjtë si zogu i lindur në kafaz lirisë.

Këtë doja të të thoja sonte, Scott, këtë doja,
Ndërsa kam mbaruar xhinin tim të dytë
E ti më sheh me sy të ndezur nga kërshëria.

Do të doja të bëja një herë dashuri me ty, Scott,
Për hir të pasionit tonë të sëmurë,
Pastaj ne të dy do të flaknim njëherë e mirë prej shpirtit
Këngën e Zeldës dhe shijen e asgjësë...

LEDIA DUSHI

n'nji fije t'thellë gjaku

ka me kenë mars
e bari ka me shndritë
ndër fije t'lidhuna shiu
deri t'kryhet vezullimi
ka me u ba natë

për me dalë kryepështjellun
n'mjegull shtjellë humbimi
ballit me i lëshue andrra
përpos shtrojes s'mbrame
me u këputë pendazhgulun
n'ndoj shtroje flijimi...
prej uji asgja s'vjen
heshtja na i heqë sytë
e nuk na len me pa
si rrëshqitet n'bar
kur don me kalue n'mars
e shtegu për atje
të ndih për kah Qielli
t'ligë t'plas përtokë
tue t'shti djegën
veç për ndoj Njeri

ANI GJIKA

Paqartësi

Nuk e mbaj mend më.
Më duket se një lumë na u vu pas
kur iu ngjitëm këmbës së malit.
Burra e gra zbritën autobusit për të pirë.

Im atë mblodhi grushtet kupë
e gllënkë pas gllënke unë gëlltita.

Copëza bore rrëfenin udhën
drejt një tymi të ftohtë pemësh. Mbi kokat tona
shqiponjat luanin topa-djegësi me diellin e artë.

E shpërbëmë luginën
si hije dimri duke iu futur përmes.

S'e shoh më në ëndërr kurrë
por mbaj mend që po më vëzhgonin
tek qëndroja në buzë të ujit
e trazoja imazhet me këmbë.

AZEM QAZIMI

«Ecce Homo»

Edhe një përpjekje të mbrame,
përpara se pluhuri të vërë gjumë mbi sendet,
përpara se e dukshmja në hon të shndërrohet:

është viti një mijë e nëntëqind e dyzet e një
dhe im gjysh shkruhet si me grafit në luftë.
Është një hije e zhyer, si njollë vaji.

Ai mund të vdesë
dhe të ketë gjithçka i duhet një burri:
një zemër të zbrazët, si një librari e dorës së dytë.

Ndërkaq, dhimbja do të jetë bërë e mundshme.
Planeti i trëndafiltë
do të kundërmojë erë buke dhe dyshimi.

Më vonë do të lindë një brez serioz,
i aftë të shpëtojë
nga hamendjet e mëdha të zemrës.

Si bimë kopshti do të kultivohet utopia,
po edhe paskëtaj
njeriu do të jetë po ai dollap me rrangulla.

Dhe drita, e gjymtë do të lindë
nga trupi i tij në vaj.

BELFJORE QOSE (ZIFLA)

Agape

Ka një orë,
Kur zërat nuk i njohin më fjalët,
Kur mes dritës dhe errësirës ngrihet heshtja,
Kur trupat zbrazen nga pesha
Dhe bëhen flatra,
Kur fytyrat tona pluskojnë ujërave
Syhapura, gojëngrira, derisa fundosen
Në një lumë që merr me vete gjithë ç'kemi mbledhur.
Dhe atëherë,
Ndërsa jemi pa fjalë,
Pa kujtesë të mirë a të keqe,
Mnemosina na mëkon me një gotë të madhe,
Dielli plas si një vezë e kuqe,
Gjithçka përflaket - zjarr krijimi,
Të tjera jetë na rimenden,
Të reja a të vjetra.
Udhëtimi ynë sapo ka nisur:
Hedhim hapa në një tokë të panjohur,
Shkojmë drejt gostisë së muzave,
Me sy e vesh të uritur.
Në këtë orë
Rikthehemi fëmijë,
Palca jonë e butë e mbushet me tinguj,
Koka me dritë,
Tashmë e dimë
Ç'është agape.

ERVINA HALILI

Fetus

lëshom
mendje
vijat e tua thepisun shpojnë
diell pembe m'pret n'ag
bebet buzëqeshin sheqershëm
më zgjidh
litarët e tu kutërbojnë
lulkanabisi
flokët e zotit
rrjedhin
rrjedhin
mendje lermë
në mitrën e nanës unë kruspullitun
fle
lërmë
kristalet bien mbi flokun e saj të zi
ajo mendon çfarë emni ka me m'vu
kur unë të vij te ti
pa
shm
ang
shëm

RUDINA ÇUPI

Fëmija im ujor

Fëmija im ujor, krejt bardhor,
lirinë tani ti përhap si syprinë tej-e-tej mes brigjeve-plazhegjera
shtrirë me shpinë, tek luan me lodrat e qiellit e anijet me vela,
i trazuar, i përhënur, i dettë.

Kur brigjet të të marrin, të të afrohen e të të afrohen si kërcënim
të të shtypin e të të hollojnë si lumë,
fëmija im i lëngët, mos u anko e as mos bubutij,
lotët do të të çkripëzojnë,
do të ndihesh ujë i ëmbël siç janë të gjithë lumenjtë
i rrjedhshëm nëpër një shteg
dhe, për ironi, mallin e anijeve të së shkuarës
do t'ia rrëfesh trungjeve që mbart mbi shpinë.

Mos mëso të mallkosh, biri im i ujshëm,
kur të mekesh si dëborë e të tretesh si avull mbi xham
apo tek kalon mes dy pllakave të tokës aq ngushtë
sa mes dy duarve të puthitura për lutje,
atëherë kujto se ke fatin t'i lësh...
ndaj lëri e lëri vazhdimisht
e udhëto për të zbuluar forma të reja të vetes nën shtypje
derisa të kuptosh forcën e qindrafishuar që ke brenda vetes
për të gdhendur shkëmbinj nëntokësorë
për ta gjetur rrugën tënde me thonj
derisa ta shpikësh një të çarë për të gjetur dritën
dhe të shpërthesh, i mahnitshëm, i epërm, ylberor,
si një ujëvarë
duke mbretëruar me kurorën e mjegullës
si një mjellmë me aureolë.

KUSHTRIM THAQI

Pushim

do ta baj pallatin tim
mbi vetëdijet e vdekura të të gjitha veteve të mija.
asgja mbrenda nuk do t'ketë:
asnji tavolinë, shtrat, karrike,
pikturë, libër, shkrime...
asnji mendim të vdekun të heronjëve të vdekun
asnji tregim të trilluar të udhëheqësve shpirtërorë,
asnji qiri, asnji pushkë, asnji shpatë, asnji gjini...
vetëm dritare në secilin mur;
në kulm
po ashtu!

unë do të ulem aty në qendër,
e do t'lahem nga drita
që nuk flet për t'vdekun...
vetëm këtë gja do ta shijoj,
vetëm këtë gja,
vetëm këtë gja,
asgja ma shumë,

do ta zhbaj veten,
do ta krijoj nji tjetër unë.

MARSHI I REAKSIONIT NË NJË DITË TË NXEHTË VERE

Tregim nga Marius Dobrescu

Vapa në atë orë të ditës kishte mbuluar qytetin me një rreth të rëndë dhe të lagësht, prej të cilit, sado të përpiqeshe,nuk kishe ku të shkoje. Poshtë, në rrugë, kalimtarët dukeshin sikur notonin në ajër, duart i lëviznin si ca krahë të ndonjë zogu që ishte në agoni, ndërsa këmbët i hidhnin në kalldrëmin e flakëruar sikur të ishin në ndonjë ëndërr të keqe.

Eshtë e vështirë të jetosh në këtë qytet, tha me vete ish-togeri, pastaj u hodh përsëri në krevat dhe filloi të lexojë. Këtu, në papafingon ku jetonte, zërat nga poshtë arrinin të mbytur, duke depërtuar dhe ato me zor në shtratin e lagësht të vapës nën të cilën qyteti dihaste.

Pak ditë më parë kishte dalë nga burgu, ku qëndroi ca më pak se dy vjet dhe po merrte veten. Me këtë shfajësohej. Në të vërtetë nuk po e merrte fare veten, një zagushi e tmershme e mundonte prej disa ditësh.

Shokët e shkollës ushtarake, shumë prej tyre oficerë në Ushtrinë e re Popullore , i shmangeshin. Dhe me të drejtë,k ush guxonte të kompromentonte karrierën me një ish koleg të shkollës ushtarake të Tërgovishtes të cilit i ishin hequr gradat dhe ishte dënuar për motive politike, që sapo kishte dalë nga Zhilava? Problemi i tyre.

Gjëja më e vështirë ishte se nuk gjente asnjë lloj pune dhe rronte me disa qindra lekë që ia kishte dhënë i ati, një fshatar i pasur, i rrënë nga vafti, nga Tënkëbeshti.Pasi i dërgoi ato lekë me një bashkëfshatar, plaku nuk donte të dëgjonte për të dhe as nuk gëzohej ta pranonte në shtëpi, në fshat. Ndoshta me të drejtë.

Tani, duke u kthyer në kohë, dhe ai vetë ndjente keqardhje për ato që kishin ndodhur. Duke e vënë veten në situatën në të cilën ishte gjendur, tani do të kishte gëlltitur gjuhën dhe jo të thoshte fjalët për të cilat u dënua. Por ja që dy, tre fraza të kostojnë. Diskutimi kishte ndodhur midis kolegëve të klasës, që porsa kishin dalë nga shkolla.Flisnin të gjithë njëherësh, pa dëgjuar dhe pa patur frikë se ndonjëri prej tyre mund të spiunonte në polici. Ai i dha rëndësi vetes, provoi të dalë mbi të tjerët. Kush është më i mire, arsenali ushtarak gjerman apo ai sovjetik? Ja një pyetje të cilës nuk është mirë ti përgjigjesh. Nëse do kishte menduar edhe atëhere si sot nuk do kishte pësuar gjë.

Por edhe të lexonte gjithë ditën nuk mundej. Kur mërzitej hidhte një këmishë në shpatulla, vishte sandalet dhe fillonte të ecte ngadalë nëpër bulevardin Viktoria. Garsoniera ku rrinte ishte e një miku që ndodhej në një lokalitet të thellë të Moldovës dhe nga lart, nga dritarja, dukej e gjithë rruga, deri

në magazinën "Viktoria", ku dikur ndodhej "Galeria Lafayette", Posta e Madhe dhe madje edhe kupola e Qëndrës së Ushtrisë. Nuk ishte keq nëse nuk do ishte kaq nxehtë si tani.

U vërtit në krevat me librin në dorë dhe e ndjeu se i erdhi gjumi. Kjo vapë

prej dreqi e ka fajin, tha me vete ish-togeri dhe vuri librin poshtë, drejt në dysheme. Flokët në qafë i ishin lagur nga djersa, por nuk përtoi ti fshinte. E pati bërë disa herë këtë veprim gjatë mëngjesit.

Ato disa minuta që dremiti ia shtuan ndjesinë e neverisë. Në djall, tha, duhet të ngrihem dhe të dal, ndryshe do çmendem këtu. Bëzëitja që dëgjoi në ëndërr nuk donte ti dilte nga koka, sikur pas ballit, një mizë e madhe dhe nervoze që nuk dihej nga kishte hyrë, përplasej mes dy xhamash.Megjithatë kjo bëzëitje nuk vinte nga koka e tij, por prej diku jashtë, nga rruga, afrohej hap pas hapi, ndërsa zërat dëgjoheshin vazhdimisht dhe më qartë. Çudi, tha me vete, kujtoja se koha e marsheve me parulla kishte kaluar. Klasa punëtore triumfoi, morri pushtetin dhe e ardhmja i përket asaj. Ato dy vjet, sa qëndroi në "universitet", në Bukuresht dhe në gjithë vendin kishin ndodhur ndryshime të cilat disa i cilësonin si epokale. Jehonat e tyre arrinin edhe tek ai,në burg, gjatë konferencave të oficerëve–edukatorë dhe nga gazetat që i lexonin në kolektiv. Po, çdo gjë ishte përmbysur me kokën poshtë dhe ndonjëherë ishte kaq i çoroditur dhe i pafuqishëm sa që nuk deshte të mendonte se çfarë e priste jashtë.

Poshtë, në bulevardin Viktoria, bëzëitja e të folurave e përzjerë u transformua në një det zërash të cilat, herë pas here, shpërndante në ajrin që zjente disa parulla të cilat ai nuk i kuptonte. Në të vërtetë mendja nuk pranonte ti kuptonte, kaq të habitshme i dukeshin.Eshtë e pamundur,

mërmëriti ai dhe u ngrit nga krev ati, morri një stol dhe u ngjit në dritare. Kjo është e pamundur, tha përsëri.Fjalët e turmës tani përplaseshin në muret e ndërtesave të larta duke u bërë, nga një çast tek tjetri, më të qarta."Poshtë komunistët! Qeveri pa komunistë!" S'ka mundësi, sa s'thirri, si i liruar nga prangat. Dhe një mendim i papritur i largoi çdo gjurmë të ndjesisë së plogështisë. Po, janë tanët, mendoi i gëzuar si një fëmijë. I shkoi nëpër mend se mund të kishin ardhur amerikanët. Ndoshta rusët kanë ikur me nxitim dhe në vend të tyre kanë ardhur amerikanët. Hëm, çdo jetë vallë? Po shiko, o budalla, shiko dhe ti pak jashtë! Nuk është ëndërr,nuk është ëndërr, jo.

Dhe ish-trogeri veshi shpejt sandalet ,rregulloi këmishën mbi kurizin e djersitur dhe vrapoi nëpër shkallë jashtë, të shohë se çfarë po ndodhte. Disa fqinjë, duke i kapërxyer shkallët nga dy njëherësh, u përplasën me të dhe vazhduan më tej, të zverdhur në fytyrë dhe të djersitur. Ky është kulmi, thërriste nga një kat më i vogël një plak, invalid lufte, duke vërtitur bastunin mbi kokë. Një demonstratë antikomuniste mu në zemër të kryeqytetit! Doli në bulevardin Viktoria në çastin që turma e tensionuar po vinte nga bulevardi i Indipendencës. Kreu i kolonës ndaloi dhe po priste fundin. Një parullë e madhe, me disa gërma shumë të trasha, tundej e fryrë si një velë anijeje. Poshtë komunistët! Shpresa jonë është Amerika! Disa flamuj me stemën mbretërore vareshin të përthyera nga vapa si ndoca lecka të panevojshme. Por kulmi ishte se në bulevardin Viktoria nuk dukej këmbë polici, sikur qyteti të ishte lënë në duart e monarkistëve. Kjo i dha kurajo. Nga burgu i kishte mbetur zakoni poshtërues t'ju shmangej uniformave blu. Mungesa e forcave të rendit i ngjalli besimin.

Turma filloi të lëvizte përsëri.Kolona ishte pak më e gjatë se njëqind metra, ndërsa ata të rreshtave të fundit ecnin sikur të këndonin me la,la,la.

Por, s'ka gjë, kështu ndodh gjithmonë. Marshimi iu duk një shenjë e mirë. Ishte fillimi. Kush e di çdo vinte më pas. Ndoshta edhe në qytete të tjera po ndodhte e njëjta gjë.

Me hapa të shpejta hyri edhe ai në mes të kolonës. Njerëzit e panë si të habitur. Mos mendojnë

se jam ndonjë provokator i ndyrë, tha me vete ish togeri. Filloi të nxitojë dhe dalëngadalë po i afrohej rreshtave të para. Kur kaluan "Galerinë", ai ndodhej prapa atyre që mbanin parullën. Poshtë komunistët! Pa komunistë!,- dëgjoi zërin e vet dhe iu duk sikur nuk foli ai, por dikush tjetër, një i panjohur që kishte fytyrën e tij, zërin dhe furinë e tij. Ishte momenti të hakmerrej për ato dy vjet të kaluara mes të dënuarve ordinerë, hajdutë, përdhunues dhe banditë,atje ku e kishte hedhur fati. Të hakmerrej për tradhëtinë e ish kolegut dhe për proçesin ku iu ndalua çdo lloj mbrojtjeje.

Vetëm tani vuri re se midis manifestuesve gjendeshin shumë pak gra. Nga trotuari kalimtarët shihnin kuriozë. Një pjesë tundnin dorën me ndrojtje, të tjerët buzëqeshnin pa besim, ndërsa shumica kishin portrete të zgjatur si shenjtorë byzantine. Kush mund të besonte se rrota do të kthehej një ditë, tha me vete ish togeri. Fytyrat e njerëzve të kolonës ishin vazhdimisht edhe më të djersitura. Nëse dikush do ti kishte kërkuar ti përshkruajë njerëzit në të djathtë dhe në të majtë të tij, apo para dhe pas tij, me siguri nuk do kishte mundur.

Çdo gjë përreth tij, fytyrat e njerëzve, duart dhe këmbët e tyre, flamujt, shapkat dhe këpucët të deformuara nga arnat, gjithçka, pra, e kishte humbur çdo trajtë individuale, ishte përzjerë në një formë të shëmtuar, në një brumë që zjente nga e cila nuk arrinin të riformoheshin. Ose ndoshta kështu i ngjanin atij, ngaqë dielli i pamëshirshëm i godiste tëmthat dhe e kishte trullosur.

Njerëzit e kreut të kolonës dhe ai bashkë me ta ndërkohë, kapërxyen kryqëzimin me bulevardin Elisabeta. Këtu ndaluan edhe një herë, për të pritur ata që kishin mbetur prapa. Ndoshta do flasë ndonjë nga shefat, mendoi ai kur pa një grup që nxitonte pa kuptim nga trotuari Qendrës së Ushtërisë. Pasi u grupuan përsëri, manifestuesit u frymëzuan menjëherë. Pankartat filluan të tundeshin me forcë, zërat u bashkuan në parullat e njohura dhe... Këtu befasia e tabllosë që zbuloi para tij ia ndërpreu mendimet. Nuk ka mundësi, tha i habitur si kurrë ndonjëherë. Përsëriti disa herë fjalët e fundit, sikur të donte të kuptonte më mirë ato. Por nuk kishte asgjë për të kuptuar. Pak nga pak gjërat filluan të marrin formë në kokën e tij dhe një hije frike u struk në shpirt. Frika morri përmasa tmerri dhe arriti ti mbizotërojë çdo mendim, ndërsa lëvizjet filloi ti ketë kaotike sikur të kishin humbur çdo koordinim mendor.

Në trotuar, e hipur në një piedestal që lartësohej mbi rrugë, një ekip nga stacionet e lajmeve filmonte. Skenari ishte i thjeshtë dhe nuk e pati të vështirë ta kuptojë: qeveria komuniste e sapo zgjedhur donte ti përcillte opinionit publik një sinjal të qartë dhe pikërisht se përpjekjet e fundit të opozitës reaksionare, e cila nuk pajtohej aspak me idenë se e kishte humbur lojën, ishin të kota. Ish togeri kuptoi më në fund se njerëzit rreth tij ishin disa figurantë të paguar fare pak, të cilët deklamonin disa parulla të mësuara përmendësh, ndërsa ai ishte i vetmi që i shkuli mushkëritë duke thirrur me dëshirë të vërtetë. I trembur nga kjo ide, rralloi hapat dhe dalëngadalë mbeti më prapa, derisa u gjend në fund dhe po ashtu fshehtas doli nga kolona.

Me frikë në shpirt u kthye në dhomëzën e tij në papafingo dhe për shumë javë nga ai moment jetoi me frikë të madhe, duke pritur nga një çast në tjetrin ta "ngrinin" përsëri dhe ta dënonin për veprimtari kundër regjimit. Dhe unë mendoj se, ndoshta realizuesit e dokumentarit, duke parë filmin nga fillimi në fund, do kenë bredhur ngado për ta gjetur figurantin që interpretoi në mënyrë aq bindëse atë rol pa asnjë vlerë. Por ndoshta nuk ka qënë kështu dhe filmi me marshin e reaksionit e viteve të para të pushtetit popullor do jetë harruar në ndonjë sirtar plot me pluhur dhe me bishta cigaresh.

Përktheu nga rumanishtja Pandi Bello

KRONIKA IME SI DYTËS PËRSHKRUES

Nga Vasil Vasili

Jam dytësi i fjalës, të kqyr jetën e saj në çdo çast është qëllimi im. T'i vë në pikëpyetje diturinë, ta brohoras diku në një përballje, t'i largohem paksa dyshues, por asnjëherë të mos e braktis. T'i vë kundruall mure, ta vëzhgoj se si do t'i kapërcejë dhe, ta ndihmoj përsëri të rimarrë veten. Ta vë prore në udhë, të vjel kuptimet që ajo i lëshon nga përplasjet me simotrat e fshehura, t'ia jap ato kuptime si pajime për të vijuar më tej. Të ndiej keqardhje për plagët që merr, por gjithsesi ta lë fillikate me plagët, t'i mjekojë vetë me lëngjet e gjuhës. Të mos ketë më tepër kohë se sa për t'u kujdesur për këto plagë. Si spartane ta ndjekë fatin dhe të shikojë me kthjelltësi rreth brerores. Ky përshkrim mund të jetë i anasjelltë, domethënë është fjala, që më kqyr mua, por gjithsesi po e lë gjendjen e parë të flasë. Unë po e përshkruaj fjalën e paralindur. Pra, ajo ka filluar ta hapë tragën, të cilën s'do ta quaj kurrë të vetën. Mbi atë, mbas saj, ecin të tjerë, ndonëse ajo s'qorton askënd, vetëm rend, me hap të lehtë çel rrugën. Unë ligështohem se ajo, ndonjëherë, ndonjë grimë mund ta rimarrë veten, por gjithsesi në këtë qëndrim ajo ecën me taktikë, pra jeton në një formë tjetër për të lëvizur më me vrull në tragën që po hap. Ajo i ka caktuar vetes një qëllim, askush tjetër s'ka pjesë në këtë qëllim, ndërsa ajo në rast se do të mbërrijë diku, gjënë e mbërritjes do ta ndajë me të gjithë, ndonëse s'është me të gjithë, është e dëlirë, pa veskun e armiqësisë dhe, të gjithë s'janë me atë, por janë pa pezëm, madje në heshtje e quajnë të lajthitur. Ajo të tillë ka vetëm hovin e lindur për të ecur më tej, për të mbërritur diku që ende s'e di ku ndodhet, por me të mbërritur atje bëhet e mosqënë. S'merr parasysh këshilla. Edhe unë, dytësi i saj, jam i panevojshëm për të tilla dhënie. Përsëri është e vetme, takon fjalë me mendësi të përafërt, tek ato merr pak përndritje, u vë në provë farefisninë dhe prapë u largohet, ndonëse ato i kanë shërbyer si gjonpagëzorë, s'janë qëllimi i saj, më shumë janë pengesa të vëna nga verbëria e panjohur. Edhe për këtë duhet të luftojë, po këtë s'e quan luftë. Mbase ajo s'e kupton luftën. Unë, dytësi i saj, ia emërtoj hovin si luftë ngadhënjyese. Si përherë, ajo shmang me mjete të pa vëna re verbërinë, që i ka dalë përpara. Unë e shikoj që po mbërrin diku. Atje rrugët janë të hapura, por hapja është aq e madhe, sa mund ta quash edhe mbyllje. Ajo, për vetveten, e ka shkokëluar nyjen dhe, ka ndihmuar edhe simotrat e përafërta dhe tani është e lirë të kthehet përsëri nga erdhi. Përpara saj gjithçka është e hapur, aq sa të krijon mbresën e zënies me perden e hapësirës së lëbyrët. Një cast, thashë mbërriti atje ku kishte synuar dhe sa s'thirra i ngazëllyer për fitoren e fjalës, por ajo e kishte pikasur rrugën e lirë, zënë nga hapësira pa fund. Ajo është mësuar të eci mbi tragë, dhe, për më tepër ta çajë vetë, u kthye përsëri. Mendova se do të vijë tek unë, me hop të menjëhershëm dhe, unë paskëtaj do dal në rezervë nga detyra e dytësit përshkrues. Diku do të çlodhem, derisa fjala të ketë nisur një tragë tjetër. Porsa u kthye mbrapsh, shtegu që kishte qënë i hapur, u mbyll. Kjo ishte e papritur për mua. Një keqardhje e re për shpirtin ngazëllyes të fjalës që po përballej me mbylljen më kaploi. Por fjala përsëri filloi të ecë. Traga që kishte mbetur e hapur për të tjerët, pikërisht për atë që e kishte çarë, u mbyll në kthim dhe, ajo filloi ta çelë me hapin e saj të pa vënë re. Unë them me hapin e saj, por ai hap është një ushtrim gramatikor i një vështirësie të panjohur që ajo e zgjidh me lehtësi, në fshehtësi të plotë. Madje "me lehtësi", s'është përcaktimi i duhur, se cilësimi është imi dhe unë s'e kam tagrin e së vërtetës. Ajo s'i njeh vështirësitë dhe, natyrshëm, s'i njeh edhe lehtësitë. Përdor një mënyrë që e kanë ditur paraardhësit, por tani ka humbur për ne. Unë, jam vetëm një dytës përshkrues që s'e kam durimin dhe madhështinë e saj si të një kreshte të qetë, por edhe ky mendim për madhështinë është imi. Ajo kurrë s'përdor epitete. E mbarështron mendimin krejtësisht ndryshe, ndërsa unë ia kam ndotur me epitete dëlirësinë. Ajo s'përdor as krahasime dhe kam kuptuar se krahasimet janë shkak lufte në botën tonë. Ajo përdor vetveten në çdo rrethanë, ajo i mjafton. Punon me një mënyrë të panjohur nga njerëzit. Përsëri nisi lëvizjen në tragë tjetër. Ata që kishin ecur lirshëm në tragën e hapur prej saj i ishin mirënjohës, por ajo s'takoi asnjë mirënjohës në kthim. Ndoshta ajo tragë kishte qënë vetëm e saj dhe, pikërisht prej saj pritej të hapej, të tjerët vinin mbrapa. Kishte filluar të ndeshej me pengesa të tjera. Edhe një herë, i kërkoj ndjesë për të menduarit tim të palatuar, por më tepër ndiej se gjuha e saj e vërtetë, gjuha që e vë në lëvizje pa qëllim praktik, është e huaj për mua. Do t'i ndodhem pranë gjithnjë, pa ia kuptuar dot kthjellësinë. Pas një mbërritje vjen një pushim. Ajo s'është e ndikuar në thelbin e vet nga shprehitë që luhen me gjakim mbi tokë. Ka ardhur në jetë të lëvizë për hapje shtigjesh të njohur, kinse të mbyllur, ndërsa unë mendoj se e kam të siguruar lavdinë me shërbimet që i bëra fjalës sime. Ajme për mua! Përpara kam një gotë ujë me lëng limoni, ktheva ca gllënjka. Fjala, me siguri, po ecën në kthim, ndonëse s'jam i sigurt se ka kthim për të dhe unë kam të drejtë ta përfytyroj, por s'mund ta ndjek në të gjitha shtigjet. Në thelb, jam automat, se ia shfrytëzoj përvojën, pa ia njohur diturinë që mban në trurin e saj. Në këtë grupfjalësh që sapo shpreha: "në thelb jam automat", s'mund ta di me përpikmëri në cilën fjalë bie theksi logjik. Edhe në ma thënçin gramatikanët, përsëri do jem dyshues. Tani, dua pak pushim të lavdishëm, ndërsa për fjalën time, që po rend mbi tragë të fortë, kam keqardhje dhe, po filloj ta përfytyroj gjithnjë e më pak.

Libri i autorëve Antonio Bellusci dhe Ornela Radovicka ***që sjell për herë të parë një vështrim tërësor mbi ngulimet arbëreshe në Itali***

NJË RRUGËTIM NË NGULIMET ARBËRESHE

Nga dr. Jolanda Lila

Fatet e popujve, ashtu si fatet e njerëzve, janë të ndryshme dhe të kushtëzuara nga rrethanat. Një shembull unik në gjithë historinë e trashëgimisë botërore përbën rasti i arbëreshëve, të cilët me të drejtë, regjisori dhe shkrimtari italian Pier Paolo Pazolini (1922-1975) i ka konsideruar "një mrekulli antropologjike", për shkak të mbijetesës së tyre etnike, kulturore e gjuhësore edhe pas gjashtë shekujsh shkëputjeje nga trungu amë.

Historia e tyre zë fill kur populluan fshatra të ndryshme në Itali, së paku nga mesi i shek. XV e në vijim, me disa valë eksodesh masive. Të nxitur prej kushteve ekonomike, politike dhe shoqërore që ofronte Gadishulli Apenin dhe të diktuar ngarendasi për t'i ikur mjerimit dhe luftërave të përgjakshme që mbizotëronin në atdheun e tyre dhe në të gjithë Gadishullin e Ballkanit, ata krijuan një "atdhe të dytë" në vendin pritës, duke qëndruar të bashkuar si mënyra e vetme për të mos u shprishur gjaku i Arbërit. Vendosja në bashkësi të vogla rurale të izoluara, kryesisht në Italinë e Jugut, i bëri arbëreshët që ta ruajnë dhe ta zhvillojnë vetëdijen etnike arbërore, duke rrezatuar ngjyrat e tyre të përveçme në një mjedis të huaj. Bashkë me përpjekjet për sigurimin e kafshatës së bukës, ata gatuan e përçuan në magjen e madhe të jetës së tyre larg atdheut të gjithë visarin e përbashkët kulturor, gjuhësor dhe fetar, me një frymë të thellë uniteti e solidariteti.

Me gjithë kushtet e vështira dhe presionet e shumëfishta, e të herëpashershme, edhe sot pas rreth gjashtë shekujsh, arbëreshët vijojnë të mbeten një bashkësi e konsoliduar etno-kulturore, ku përveçse kanë ruajtur traditat parake, kanë konsoliduar një identitet të mëvetësishëm brenda një kombi dhe kulture tjetër. Këto ngjyra identitare në tradita, rite, gjuhë, këngë, kostume e mënyrë jetese përbëjnë një mozaik të larmishëm të ngulimeve arbëreshe, i cili shtrihet në të gjithë Italinë e Jugut.



Dikur ishin me qindra vendbanime arbëreshe në Itali, ndërsa sot ky numër është tkurrur, ashtu si numri i popullsisë në to, megjithatë, stuhitë e puhizat e kohës nuk kanë mundur ta ndalojnë ritmin e pulsimit të gjakut e të kulturës atdhetare, saqë sot janë plot pesëdhjetë ngulime arbëreshe (me një popullsi prej 100 mijë banorësh), të vendosura në shtatë rajone të Italisë së Jugut, ku në pjesën më të madhe të tyre është ruajtur gjuha shqipe dhe riti bizantin, ndërsa në disa të tjera janë ruajtur thjesht kostumet, ca tradita atdhetare apo vetëdija se janë arbëreshë. Gjendjen e sotme të këtyre ngulimeve, por edhe historinë e themelimit dhe zhvillimit përgjatë shekujve e sjell në mënyrë të plotë libri "Rrugëtim në ngulimet arbëreshe" i autorëve Antonio Bellusci dhe Ornela Radovicka. Për herë të parë, informacioni mbi ngulimet arbëreshe vjen i strukturuar në këtë libër, të botuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), e cila ka si objektiv kryesor studimin dhe promovimin e kulturës arbëreshe.

Libri sjell një "skanim" të plotë të të gjitha ngulimeve të sotme arbëreshe, duke prezantuar veçoritë e secilës krahinë, arkitekturën, vendet, monumentet kulturore e fetare, traditat dhe personalitetet kryesore që u përkasin këtyre ngulimeve. Teksti nuk ka thjesht trajtën e informacionit të aktualizuar mbi këtë komunitet të diasporës historike shqiptare, por ka edhe trajtë enciklopedike, sepse secilin prej ngulimeve e trajton në rrafshin sinkronik dhe në atë diakronik.

Në libër përshkruhet historia e vendosjes së arbëreshëve dhe gjeografia e secilit ngulim, gjë që krijon një ekspoze të qartë të karakteristikave të mjedisit, tipareve të klimës, të drurëve që janë rritur bashkë me brezat e ndryshëm të arbëreshëve dhe me lumenjtë e krojet, të cilët janë "arbëreshizuar", duke u poetizuar në shumë tekste letrare të arbëreshëve. Po ashtu, flitet edhe për tokat dhe specifikat e tyre, ku kudo bie në sy kontributi i arbëreshëve për ta kthyer bokërimën në tokë pjellore. Ata janë shembulli i punës së ndershme dhe të ngulët, që u ngritën nga hiçi e zbrazësia dhe krijuan qytezat ku jetojnë sot. Nga shtëpitë prej balte e prej kashte, ata ndërtuan shtëpitë prej guri sipas modelit arkitekturor e shoqëror të gjitonisë, ku në sajë të këtyre hapësirave të vogla mes pragjeve u trashëguan identiteti kombëtar, gjuha dhe marrëdhëniet vëllazërore. Jo më kot, sipas autorëve, "*gjitonia ka brenda rrënjën "gji", nga i cili jemi ushqyer, apo kemi qenë të mbrojtur (në gjoksin e nënës*)".

At Antonio Bellusci është një nga personalitetet e komunitetit arbëresh, që ka një kontribut të spikatur për hulumtimin dhe promovimin e kësaj kulture, prandaj në këtë tekst të shkruar në bashkautorësi me studiuesen e re Ornela Radovicka, shpalosen njohuri të thelluara historike dhe informacione të vyera mbi të gjithë rrugëtimin e arbëreshëve, nga emigrimet deri tek zhvendosjet e tyre brenda vendit pritës. Autorët kanë përdorur dy burime kryesore për hartimin e librit, së pari shfrytëzimin e një materiali të gjerë bibliografik dhe së dyti, mbështetjen në rezultatet e ekspeditave të tyre në terren, gjë që e pasuron shumë tekstin dhe e motivon synimin e autorëve për ta paraqitur sa më saktë historinë dhe gjendjen e sotme të këtyre ngulimeve. Pasioni shkencor i autorëve për të shkelur në terren, për të parë nga afër dhe për të dokumentuar gjithçka arbëreshe në Itali ka sjellë një guidë të çmuar orientuese për gjendjen e kësaj vatre arbërore në Itali.

Ndonëse bota arbëreshe është mjaft e dashur për shqiptarët, pakkush ka njohuri të sakta e të plota se cilat janë e ku shtrihen ngulimet arbëreshe, prandaj ky libër ofron një celuloid të jetës disashekullore nëpër pesëdhjetë vendbanimet arbëreshe, të vendosura në Kalabri, Bazilikatë, Kampanjë, Molise, Pulja dhe në Sicili. Vepra është shkruar duke u bazuar në hulumtimet e gjera në biblioteka, arkiva dhe terren, por mbi të gjitha, është shkruar me një dashuri të madhe për të shpërfaqur të gjallë përpara lexuesve çdo gjurmë dhe element arbëresh të mbijetuar e të shuar, por që dëshmitë arkivore e vërtetojnë praninë e tyre të dikurshme.

Libri davarit mjegullnajën e mistikes dhe të legjendave për një varg dukurish dhe personazhesh arbëreshe dhe rindërton nën dritën e fakteve specifikat e botës arbëreshe. Të tre kapitujt e parë rreken të sqarojnë në trajtë të sintetizuar të gjithë dinamikën dhe historinë e rrugëtimit të arbëreshëve qysh para periudhës së Skënderbeut, deri në dy-tre shekujt pas vdekjes së tij, ku grupe të ndryshme arbëreshësh nga territore të ndryshme dhe për motive të ndryshme populluan fshatrat italiane, duke u vendosur sidomos në krahinën e Kalabrisë.

Kapitujt e tjerë të librit ofrojnë një pasqyrë të ngulimeve arbëreshe, duke u ndalur specifikisht në secilën krahinë. Në përmbyllje të librit, nuk lihen jashtë vëmendjes edhe gjurmët arbëreshe në Venecia, si dëshmi jo thjesht e emigrimit masiv të dikurshëm drejt këtij vendi, por edhe si dëshmi e lavdisë së dikurshme të figurave me prejardhje shqiptare, të cilët përndritën edhe vendin pritës, të tillë si: Leonik Tomeo, Marin Barleti, Marin Beçikemi, etj.

I shkruar me një gjuhë të qashtër dhe me një stil të zhdërvjellët e plot ngjyresa, ky libër është si udhërrëfyes, që na shpie në vende e në kohë të ndryshme, në të cilat shtresohet bota arbëreshe në tërësi, duke na zbuluar atë që ata ruajnë përgjatë shekujve dhe atë që gjallon ende sot brenda këtij komuniteti, sepse, siç thotë edhe vetë autori Antonio Bellusci në hyrje të librit: "*Arbëreshi nënkupton një vazhdimësi dhe po jeton në një kontekst të tillë, që po i reziston atij pitonit asimilues, që dalëngadalë po e tkurr; ndaj dhe duhet kodifikuar çdo kontekst sa nuk është vonë. Deri tani, historinë tonë e kanë shkruar të tjerët, por ka ardhur koha ta kodifikojmë ne*".

Libri është fryt i një pune shumëvjeçare nga ana e autorëve dhe tashmë është pronë e një rrethi shumë të zgjeruar lexuesish, jo thjesht e studiuesve, pasi vetë qëllimi i autorëve ka pasur si busull orientimi paraqitjen e sistematizuar dhe me gjuhë të thjeshtë të një informacioni të gjerë e gjithëpërfshirës mbi sfera të larmishme të organizimit të jetës materiale, sociale e shpirtërore të komunitetit arbëresh në Itali.

VDEKJA DHE LIRIA TEK "KAPEDAN MIHALI" I NIKOS KAZANXAQIS

Nga Damian Alia

Cikli i përmbushjes së kësaj historie arrinë madhështinë e atyre momenteve që rrallë herë i jepen njeriut mbi tokë, e që ndonjëherë kodifikohen në filozofi, religjione apo këngë. *Kapedan Mihali* i Kazanxaqis fillon me kokën e europianizuar të Kozmait, i cili shkollohet jashtë atdheut, Kretës, duke shkaktuar pakënaqësi tek ungji i tij, 'Derri i egër', vetë kapedani i titullit. Përfundon me krahun e ngritur të kapedan Mihalit teksa mban lart si flamur kokën e prerë të nipit, në sulmin e fundit të ushtarëve turq, në thirrjen e përjetshme 'Ja vdekje, ja liri'.

Shkolla u la pas, Europa ishte larg dhe qëndroi larg, Kozmai vendos të ringjallë të atin në aktin e fundit të jetës dhe të parit të burrërisë sipas normës kretase. Një kthim tek rrënjët e tek vuajtjet e tyre të përjetshme për të nxjerrë veten në dritë, por në një formë tjetër, të përmbushur, jepet nga Kazanxaqis në këto skena të njëpasnjëshme:

"-Mbathja, - i thirri atij, - ke ende kohë! Ik!

-Jo! Nuk dua të iki!

Dhe Kozmai u ngrit me një të hovur, rrëmbeu pushkën e Kajambisit, vezmet e tij dhe mori thikën te brezi i të vdekurit. Kapedan Mihali e vështronte me habi.

-Nuk do të shkosh?

-Jo, nuk dua.

Papritmas kapedan Mihalit i shkëlqeu fytyra. Ai kapi kokën e Kozmait me të dy duart.

-Përshendetje, nip! – i thirri. –Si, po bëhesh fli edhe ti? O Kretë e pavdekshme!"[1]

Kozmai i arsimuar në perëndimin e teknikës dhe shkencës tashmë transformohet në këtë çast të papërsëritshëm të aksionit sipëror, të luftës për liri për atdheun. Mbrapa mbeten përpjekjet e tij diplomatike nëpër Europë për ta ndihmuar Kretën nga zgjedha e saj otomane; mbrapa edhe kjo qasje si vetëmashtrim, si zhgënjim dhe frikë. E me këtë kthim të Komzait që duhet të bindte kapedan Mihalin të ulte armët në të mirë të Kretës, sepse kështu e kërkon logjika politike, kemi edhe përballjen me të vërtetën e errët të njerëzimit dhe civilizimeve: *vetëm vullneti dhe veprimi hapin botë*. Qoshin këto të menjëhershme apo të konceptualizuara. Kush pret e kush lut nuk ka për të kontempluar qiellin e tij, kush llogarit, ska për të gëzuar rezultatet që nxjerr, kush dorëzohet është spektator i jetës së vetë.

Por ç'është ky pohim absolut në flamujt e kretasve të Kazanxaqisit, 'Ja vdekje, ja liri'? Liria në këtë roman raportohet vetëm me veten; nuk mund të jetë veçse absolute, liri e çliruar. E ndoshta vdekja është forma negative e saj, liri në këtë botë ose në tjetrën, apo ndoshta, liri në këtë botë ose fare asnjë botë. Kazanxaqis ndërton një epos të përpjekjes për aktualizim të këtij afirmimi të pakompromistë e që gllabëron jetë, gjak, kohë dhe mund. Një roman i mbushur me aromën e oborreve dhe njerëzve, të sofrave dhe gjellërave që ndihen në faqet e tekstit, të shëndetit që ha dhe pi, që do të shtohet e të zgjerohet, e që në fund, e di thellë thellë se çdo e mirë është për një dobi më të madhe se kënaqësia e çastit. Secila gjellë dhe dashuri, brokë me verë apo gjumë nën hijen e pemëve, në heshtje e di që shkon drejt luftës për liri, drejt vdekjes prej saj, drejt mbarsjes së dheut të Kretës me gjak e mish të shëndosh.

Ky sens i rikthimit dhe ringjalljes, krejt në terma vitalist, ndihet fortë teksa Kazanxaqis, këtu, ashtu si edhe tek *Asketika* apo tek koncepti i heroit i artikuluar tek *Udhëtime në Itali*..., thekson bindjen tek vazhdimësia dhe ringjallja, teksa krijohet ideja e një Krete mikrokozmike e cila riciklon mishin e bijëve e të armiqve të saj për t'u kthyer në vreshta, ullinj, bagëti e bulmet; në shtat, guxim, forcë e në fund, në një thirrje të pakundërshtueshme: 'Ja vdekje, ja liri'. Një besim i errët e primordial ravijëzohet në këtë pasazh:

"Kapedan Mihali i dëgjonte britmat që nga dritarja e tij e vogël. Atë të diel ai njohu zërin e të birit: 'Do t'ju thyej turinjtë' dhe buzëqeshi. 'Të lumtë Trasaq, kështu të dua unë, -murmuriti ai, -dua që ti të godasësh armiqtë e tu, turq, grekë, frëngj dhe, më në fund, veten tënde, në qoftë se do të të ndodhë të bëhesh burracak. Një djalë të tillë, po! Unë do të ringjallem tek ti!

Iu kujtua murgu plak, në manastirin e Virgjëreshës të Shkallës së Artë, buzë detit të Libisë, duke i treguar në varreza varrin që kishte hapur e rregulluar ai vetë. Mbi gurin e varrit qenë gdhendur këto fjalë: 'Eh! Eh! Vdekje, unë s'kam frikë nga ti!' Murgu s'kishte frikë të vdiste sepse besonte në zotin. Kapedan Mihali nuk i trembej vdekjes, sepse besonte në të birin."[2]

Jeta dhe vdekja identifikohen me lirinë dhe vdekjen. Gjithçka rrotullohet pafundësisht dhe pashmagshëmrisht drejt vdekjes por dallimi është nëse jeta përputhet me lirinë. E vetmja mënyrë që liria dhe jeta të bëhen një është që kjo e fundit të ringjallet në breza si e vetmja mundësi e mundjes së nënshtrimit. Vdekja mundet në këtë rikthim të mishit të brezave në mishin e tashëm, të idealit të stërgjyshërve në frymën e ngrohtë. Kjo mposhtje krejt specifike e vdekjes është kushti i mundësisë së lirisë.

E teksa Kozmai ribëhet pjesë e këtij cikli të përjetshëm në 'konvertimin' e tij të fundëm, së bashku me kapedan Mihalin, aty bëhen tre përballë ushtrisë turke:

"Kohë më kohë i hidhte një sy të nipit që luftonte pranë tij.

-Të lumtë, nip! –thirri ai, -ti e ngjalle tët atë. Mirë se vjen, vëlla Kostaros!

-Tungjatjeta, ungj! –iu përgjigj Kozmai, i kapur nga një dehje e çuditshme. Nuk njihej fare. E kishte pushtuar një gëzim i pashpjegueshëm. E ndiente veten të lehtë, të shpëtuar, pikërisht në atë çast, vetëm në atë çast ishte kthyer në atdheun e vet. Nuk mendonte për asgjë. Të gjitha telashet që mund t'i sillte mendja e tij e europianizuar u zhdukën. E ëma, e shoqja, i biri, u mjegulluan dhe nuk mbeti më përpara tij, veçse ajo detyrë e vetme dhe shumë e lashtë.

-Ja vdekje, ja liri! –ulërinte ai duke vështruar turqit.

-Ja vdekje, ja liri! – S'kishte më as gëzim, as shqetësim, as dëshirë tjetër për të."[3]

Një ringjallje që pritet e një që vjen është jeta e kretasve të Kazanxaqis. Një afirmim i pafundëm i jetës për lirinë, i vdekjes për jetën. Reflektimet e shumta për Kretën dhe natyrën e saj i japin shpesh trajtat e një entiteti metafizikë e në të njëjtën kohë të mishtë, leshtor, të egër e të ëmbël. Fundja, a nuk është atdheu i tillë, a nuk është vuajtje?, a nuk është një përbindësh metafizikë që nis nga errësira në të cilën ruan ndër shekuj rrënjët tona, e që një ditë, të paparashikuar, nëndheu bëhet gati të pjelli në ringjallje idealet e lashta, ngritjen e pandalshme drejt një qielli të bërë me duart tona?

Aty ku nënshtrimi i Kretës shfaq trajta të dukshme fizikisht si mjekra e kapedan Mihalit, e cila nuk rruhet deri në çlirim, apo bastuni i përdredhur e me nyja i kapedan Stefanit, që tregon se punët nuk po i shkojnë mirë atdheut të tij; aty ku liria shihet e arritshme me diplomaci, pra, me penë, në ndonjë rast, dhe me pushkë në shumicën absolute të rasteve, e që mes këtyre të fundit ka nga ata që e kërkojnë me rënkim, si kapedan Mihali, apo me të kënduar, si kapedan Poliksingisi, aty mund të gjendet një gji i mirë për të reflektuar vërtetë mbi punët e mëdha të historisë dhe të popujve që e shkruajnë, të letërsisë që e këndon atdheun e që me rënkime hidhet nga ky mbi gjoksin e vetë nën diell.



1 Nikos Kazanxaqis, *Kapedan Mihali*, Naim Frashëri, Tiranë, 1993, ff. 497-498.

2 Nikos Kazanxaqis, *Kapedan Mihali*, vep. e cit., ff. 275-276.

3 Po aty, f. 498.

Lëvozhga e fjalës pas një banketi shik

Cikël poetik nga

Flurans Ilia

Anija prej letre

Zëri yt pret përgjatë dimërimit
Mbledh brigjet e brinjëve
Pranverën e anijes prej letre
Bulbëzon ylli i mëngjesit lundrimit
Një albatros a tejqyrë prej kthetre?
Kërkon të rimarrë anijen e ritmit
Sythin e parë, hartën, stolisur
Me degë bajamesh e lule përbri
Rrugëtim i venave në oqean
Shtrirë mbi një pentagram
Savanë e fjalëve ku qiellza reket
Flokënajë foljesh bora e parë
Zëri yt ëndërron brigjet
Anijen prej Letre
Në qiellzë të ritmit batica rreshket
Albatros ëndrra a tejqyrë prej kthetre?
Në qindra fjalë qysh nga bora e parë
Në buzët e tua sythet çelen
Ëndërrtarë, ëndërrtarë, ëndërrtarë !
Mëshojini rremave se tirania e gjuhës
Urdhëron tendosje
Spiranca e ligjërimit po ngrihet
Lëvizja është zgjedhim në zhvendosje

Pëlhurë

Buka e thekur si zgjimi i blirit
Bulkthat në jug zbusin kthetrën
Lugat i ngujuar në muzg
Gjer në zverk zvarrit zefirin
Imazh zafir prej kafeje të fortë
Në xhezve të bronxtë
Gjurmët mbi rërën e shkrifët
Lëçisin filxhanin ...
Bunaca e Gushtit ç'vesh
Gjuhën e vdekur të kostelacionit
Gjumi i gjallë i galaktikave
Gllabëruar si një ballamar
Kruajtur me dhëmbë nga Ballabani

Kështu mëtohet nisja, *këmbëzbathur*
Ball këtij muri t*ë vjetër përpirë detit*
P*ërgjumet Kepi i Rodonit*
Prania e zefirit mbi trup të hyjnisë
(Kënga e sirenave të policisë)
Aty ku busulla kapton kuptimin
Te kjo liburnë e mbytur në det
Humbet me fushqet
Duke kërkuar 8-këmbëshin e fjalës
Që duhet plandosur 40 herë mbi gurë
Duke i lëshuar tendinat, varur jargët
Si një kërmill ndënë hënëz
Nën dritën e gushtit
Ku nata nis e bëhet pëlhurë

Në Pashaliman

Kur Ylli i Mëngjesit feks i paanë
Një palë shkallë mbështetur në mur
Mblodha «më the të thashë e vijnë e vanë»
Kornizë bëra konturet trupin pikturë

Në at' botë ngjyrë ndryshku
Përplaset pëlcet «syri i keq»
Dikush atje lart sheh pasyrën
Deti na shtynë deti tërheq

I kapur ç'ka mbet te ky breg
Brenda gjirit fanepset qyteti
Këngë me iso gadishull me këngë
Shpinën nga mali zemra te deti

Antikitet i zërave përunjë-përunjë
Polifoninë e latuar të gjirit këndon
Ja nis odiseja e hithrave n'gjunjë
Isoja e valëve fjalët m'i mbulon

Lëvozhga e fjalës pas një banketi shik

Pasi shishet e shtrenjta të verërave u pinë
U pinë të shtrenjtat shishe të verërave pasi
U grisën fjalitë e stërzgjatura
Kapota e vjetër zhele u bë ndërkaq
U mblodhën gotat e boshatisura
Gotat këmbëholla si balerina
Balerinat si gota këmbëholla
U vendosën p*ër t›u shpëlarë në lavapjatë*

Fjalët si Hëna mbi të ftohtin Posedon
Çarçaf mbi krater shikimesh opake
Fatëzuar në faqet e Perandorisë Romake
Mangall vetullbronxët ku Vezuvë të tredhur
Ndjekin Kadmosin sypërndjekur
Që i shkuli dhëmbët shkronjat i mbolli
I bëri nëndetëse për peshq të ngordhur

Sërish Guernika me sytë e përndjekur
Të një nate më parë
Shtreson hirin e portreteve tona
Materializuar mbi çdo fjalë
Copëza yjesh si fishek *në* armë
Mbi buzën e mbetur pa gjak

Vazhdojnë të jehojnë si krisma fjalët
Artileri bisedat nga fronti i pendimit
Si gurë kështjellash të rënuara
Mëngjesi i ditës tjetër përmes zgjimit

Fjalitë tona grisen bën sërish ftohtë
Rozafa servir kafe të kredhur në dhimbje
Ndër sytë e saj *të ngrohtë*
Vështron gishtat e mi qerosë
Si murgj budistë paqësorë e barkfryrë
Sinorin e porcelanit prekin butësisht
Cicën e bardhë të gojëdhânës
Mollëza si rrathë në trung të legjendës

Kur shtypet me gurë lëvozhga e fjalës
Kullon drejt kujtesës një lëng i zi

Derdhur e mbathur në porcelan të bardhë
Mëma e dh*é*ut *çdo mëngjes si murim*
(shfaqet vetëm me njërin gjoks përjashta)
Si qumështi që zbardh e zbut kafenë
Tridhjetë vitet e ikura prej vendit tim

Figurina prej fati

Te muri i krisur i këtij pesëkatëshi
u shkruajt rrashta ku ra shejza
zemra zbulesë e kartave
suva që djersin bie peta peta
për vitet e ikura shkallare me djejza
kullonin ditët si membranë e lotit
dritares përvidheshin orët
e statujës së mendimtarit
nga ditët e ditarit
përditë rriteshin cicat e sirenave
në pjekurinë seksuale tendosur
te hyrja e pallatit
"Çuna po vjen Izaura!"
makina e policisë Ofelia e fatit

Kriste vështrimi mbi letrat e bixhozit
pa figura heroike me figurina erotike
mustaqe padirsur si fanti spathi
kur iknin dritat dritës së qiririt
nuk kishim çmim por kishim llastiqe
çmimin e zarave të mbushur me hile
ishim mu si gurë që rrokullisen
çmendur pas çupës kupë
shkallare në zbritje
zemra e një harabeli në përpëlitje
aorta e zemrave tona
ikonë e atyre viteve
Diego Maradona
shpirt blasfem i projektuar
me dorë shënuar
si gol i ndaluar
si puthja e parë
te shkallët, pas MURI
me bukë me vaj me sheqer
Shekspiri shtegëtonte përher'
Udhës, mbi një qerre prej druri

Xhamlliku

vetratë xhami shqipërim i *smog*ut
rreth unazës avitet xhamlliku
në teatrin e shpirtërave automat
putërshpërfillur e qiellgërvishtur
shpërfolur si një kësulëkuqe në bankomat
puthja me xhamin e godinës tjetër
sërish takon në rrugë dy imazhe
marionetën tënde
nën uniformën e *gabit*
si ushtar i luftës së parë, të dytë
një dokumentari të tretë
mbi kryeqytetin si konfigurim gjeografik
dhe të tjera bluxhinse dashurie
në faqe të pashkruara periferie
ndriçojnë pullazet e çative
antenat e dukshme të Dajtit
kabllorët e padukshëm të qytetit
si xixëllonja fshehur rrëzë malit
dritaret e ekraneve dhe celulari
çdo ditë përgjon foshnjën që lind
me *Wi-Fi* kontakti ...
... pleqtë e kryeqytetit
ca qenie të moçme *flatscreen*
si bibliotekat e shtëpive
si frigoriferët *obotin*
as një letër në kutinë postare!
TV-ja e mbushur ding
me lajme të ngrira që nuk shkrijnë
te gjysmëhënëzat e bukura të Tiranës
netëve pihet hashash me vështrim të çlirë
poezia është e dalë boje me sy të lirë
grafiti i fjalëve përditë betonohet
krahina e të ardhurve dhe të ikurve
ngujohet
te karuseli i kryeqytetit
te kryeqyteti i dialektit
me vështrim ndaj porte
atavik, shtriqet xhamlliku
ky muskul i tendosur
kjo gjymtyrë e shqisave përmidis

PUSI

Tregim nga QAZIM SHEHU

Pasi zbritën malin e Qarrishtës,u ndodhën në katundin e parë të Maqedonisë, që duhej të ishte Belica. Një "stoj" e kishin dëgjuar në thellësi të pyllit,por Arifi tha se kjo nuk kishte qenë veçse frika e Gonit. Ai njihte shtigjet e pyllit aq mirë, sa jo ushtari maqedonas, por edhe një ushtar me katër sy nuk e diktonte. Problemi nuk ishte këtu, por ku do shkonin? Në Belicë zor se gjenin punë: atëherë vendosën të iknin në drejtim të Gostivarit: ishte ca larg, por sidoqoftë, siç.kishte dëgjuar Arifi, andej ia vlente.Morën një makinë dhe u nisën.Vonë arritën në Gostivar, u endën ca nëpër qytet dhe Arifi tha se duhej të shkonin në një fshat aty afër. Madje do të bujtnin te Sadik Latifi, emër i sugjeruar nga një mik i tij në Librazhd; sipas tij, Sadik Latifi kërkonte punëtorë për të hapur një pus.Me të pyetur, e gjetën Shtëpinë e Sadik Latifit. Ishte një vilë trekatëshe, e bardhë,e cila ndriste në muzg me një ftohtësi të largët.Trokitën, por nga brenda vilës nuk u dha asnjë shenjë.S'duhej të ishte aty apo të zotin e shtëpisë mbase e bezdisnin gjithmonë punëtorët e varfër nga Shqipëria. U larguan nga vila dhe në cep të një are panë një mullar të vjetër, i cili dalëngadalë po njëtrajtësohej me muzgun. Sapo Arifi i rregulloi mirë ca dengje bari, duke i hapur me përtesën që sillte lodhja ,u shtrinë të tre pranë e pranë dhe i këputi gjumi.

Në mëngjes herët, shkuan te vila e Sadik Latifit ,por nuk trokitën. Duhej pritur.

- Këtej njerëzit zgjohen vonë se janë ca agallarë,- tha Arifi.

Pritën duke u ulur në dy trungje pemësh, vënë enkas anës rrugës. S'patën nevojë të trokisnin se, pas pak kohe Sadik Latifi doli, duke hapur me tërheqje portën e rëndë të oborrit, e cila vinte forma-. forma.

Sadik Latifi në fillim u tremb, por ai e mori me mend se kush ishin.I veshur evropiançe, me plis në kokë, Sadik Latifi duhej të ishte i shëtitur nëpër botë. Goni dhe Miti pritën gjersa Arifi bisedoi me të. Sadik Latifi rrinte drejt, pohonte me kokë, pastaj u afrua bashkë me Arifin.

- Ju kërkoni punë, - tha, - po! Unë do të hap një pus, pak metra larg shtëpisë. Nëse biem në ujdi, mund të filloni që sot, - tha Sadiku. Duke iu drejtuar vetëm Arifit, sikur ata të dy të mos ishin aty, shtoi: - Sa për sa, dyqind marka metri, asnjë çentes më sipër dhe ushqimi, ushqim ka boll.

Sadik Latifi bëri para dhe caktoi vendin,

- Këtu më duhet, - tha ai, duke treguar një breg të vogël që vinte si një gungë mbi tokën e rrafshët. Pastaj u largua dhe, pas pak, solli kazmat, lopatat, qysqi, plumbçe, kepa, pyka hekuri. Ai i solli veglat aq shpejt, sa dukej se kishte pritur vetëm ata të tre. Miti pa lëkurën e kuqe të Sadik Latifit, si lafshë gjeli, mustaqet që kishin filluar t'i zbardheshin, dërdëngun e trupit, dhe s'dihet pse prej andej i rrëshqitën sytë te vila. Gostivarasi nuk i pyeti për mëngjesin, po do ta shtynin, aq pak kohë, gjersa të vinte dreka. Filluan punë, Sadik Latifi iku, mbylli portën e vilës, hipi në kerr dhe gërvitja e gomave të makinës, bashkë me gazin, ishte e vetmja zhurmë atë mëngjes. Edhe ata u çuditën sesi ecën aq shpejt ditën e parë. Kishin hapur dy metra pus.Veçse, në darkë, u ndjenë pothuajse të kapitur. Kur u strehuan në një shtëpi që ishte pakëz larg vilës, u ndjenë të kënaqur. Dhoma kishte tri krevate, të gjatë më tepër se ç›duhej, mbulesa të pastra, një dollap buke, stufë, qilima të vjetër, televizor.Uji rridhte në një lavaman, ngjitur me murin ku s'kishte pllaka majolike. Kuptohet, kjo kishte qenë shtëpia e gostivarasit para se të ndërtonte vilën. Po ç›njerëz kishte ai në vilë, si duhej të ishte ajo nga brenda, në mos jetonte vetëm, ku i kishte djemtë: filli i mendimeve u pritej në mes ,se ishin të lodhur, aq të lodhur sa u këputej dora nga pesha e lugës. Goni, më i riu, ndizte radion, dëgjonte lajmet. Zëri i spikerit i intononte pak me atmosferën e vendit nga kishin ardhur. Goni ishte nga Qarrishta, Arifi nga Dorëzi dhe Miti nga Kuturmani. Goni fejohej në shtator me një vajzë nga Letmi dhe ,nëse deri atëherë nuk bënte paratë për të dërguar shkelkat - të fejuarës, e merrte djalli punën. Sa të mbaronte këtu ,ai do të ndahej nga shokët dhe do të kërkonte ndonjë punë tjetër, murator ose punë bujqësie. Mbase Sadik Latifi do ta ndihmonte, në mos do të ikte në Tetovë apo Shkup.Të nesërmen, u ngritën herët. Fillonte vapa, ndonëse vapë në pus nuk kishte.Punuan me vrull,toka e shkrifët ndihmonte dhe ditën e dytë, pothuajse arritën tre metrat, Të katërtën ditë, toka u dha më e ngjeshur, por ata nuk u ndalën.Për të pestën ditë, toka u shkriftua.Ajo sikur lozte me ta dhe donte të provonte durimin e mjeshtrave të pusit.Përparuan goxha dhe u gëzuan kur e matën thellësinë. Plot pesë metra, pra, një mijë marka.Dhe në pesë ditë.Nuk i kishin marrë kurrë aq para në një kohë të tillë. Afër mbrëmjes, u shfaq Sadiku, duke buzëqeshur.

- U lumtë krahi, bre trima! - tha ai, ndërsa hodhi ' në pus dritën e elektrikut. Mbeti i befasuar kur Arifi i kërkoi disa para si paradhënie. Sadik Latifi e tërhoqi buzëqeshjen, e strehoi s'dihet se ku dhe u tha se paratë do t'i merrnin vetëm kur të mbarohej pusi, madje kur të dilte ujë. Se në fund të fundit pusi përse hapej? Atëherë do të shtronte një drekë, do flladiteshin me ujin e tij e do të ndaheshin si miq.

Ata u pajtuan me fjalët e tij. Sadik Latifi nuk e kishte keq. Pse të nxitoheshin, paratë do t'i merrnin ,se s'kish çarje. Më mirë një dorë dhe kryej hall, se kur i merr pjesë-pjesë ato shkojnë si para lodre.

Ditët iknin dhe ata arritën në metrin e dhjetë kur shpresuan se do të delte ujë. Madje, Goni tha se kishte parë tokën e lagur. Po të nesërmen, kur Arifi zbriti në vend të tij, tha se aty kishte urinuar djalli.Vërtet toka ishte e lagur, gjë që tregonte për mundësinë e ujit, por kova nuk mbushej. Megjithatë ,fakti që s'po dilte ujë nuk duhej marrë për dëshpërim.Sa më shumë metra, aq më shumë para. Deri tani i kishin kapur dy mijë marka, ndonëse ato ndodheshin në xhepin e Sadik Latifit. Sadik Latifi nuk u duk për tri ditë.Vila rrinte ë heshtur, sikur mundohej të përtypte ose zbërthente diçka. Por s'kishin punë me të. Të rrëmbyer nga puna, kishin pakësuar edhe fjalët.

Ende nuk po jepte shenjë për ujë.Toka është e fortë, si e betonuar, për inat të tyre mbase. Nuk po përparonin as gjysmë metri në ditë. Në mbrëmje, ndiheshin të lodhur, më tepër nga mendimi se nuk po hapej shpresa për ujë. Po çfarë e donte këtë pus Sadik Latifi, kur ai ujin e kishte me bollëk? Ujë vërtet kishte, por pus jo.

- I pasuri do t'i ketë të gjitha, - tha Miti ndërsa dëgjonte lajmet në radio.

- Sadik Latifi s'ka ku i shpie paratë, - tha Arifi, i cili mbuloi kokën me batanie, sikur t'i vinte turp për ato fjalë.

- S'e ka keq Sadik Latifi, - tha Goni, - pusi ka ujë të ftohtë e të freskët, veçanërisht në verë, kur burimet pakësohen nga vapa.

Duhej të ishte dita e trembëdhjetë, por Goni ngulte këmbë se ishte e katërmbëdhjeta. Po ç›rëndësi kishin ditët? Rëndësi kishin metrat. Por edhe ditët nuk duheshin humbur kot, se Goni shpresonte, veçanërisht ai, të kapte punë tjetër.Ai do të fejohej në shtator, malli për të fejuarën në Letëm e kishte zatetë keq.

Që në mëngjes, dielli u ngrit me shfaqje përvëluese ,duke lajmëruar për një ditë të nxehtë përpara. Arifi kishte zbritur në thellësi dhe, sipas tendosjes së litarit, jepte shenjat e komunikimit për nevoja të ndryshme, Kur ai u ngjit lart në drekë duhej aq i mërzitur, sikur në thellësi të tokës të kishte takuar ndonjë të vdekur.

Shokët e pyetën nëse kishte ndodhur ndonjë gjë, mos nuk ishte mirë apo çfarë, por Arifi vetëm heshtte. Ky pus i mallkuar po u merrte edhe fjalët. Ai ishte një vërtitje bosh e mundimit pa krye. Më në fund, Goni e detyroi të flasë dhe Arifi zbuloi të papriturën: toka kishte dalë shkëmb i gjallë, vetëm dinamiti mund ta copëtonte, por, nëse përdorej dinamit e gjithë puna shkonte dëm.

- Djalli ka ngulur dhëmbët e tij duke kafshuar atë pjesë toke dhe dhëmbët i kanë mbetur aty, - përfundoi Arifi ,për të mos folur më për një pjesë kohe.

Në ato çaste që u quajtën të rënda,Goni tha se nuk duhej të tërhiqeshin.

- Sadik Latifi do ujë dhe nëse nuk del ujë, s'ka as para, ky ishte kushti.

- Paratë që ç›ke me të, - u nxeh Miti, - kot i kam shkallmuar shpatullat kaq ditë, kokën kemi vënë në rrezik duke na rënë bretku...

Goni që ishte më i riu, qe njëkohësisht më i përmbajtur, atij i pillte mendja.

- Ujë ka me dalë nga pusi se s'bën. Nëse takojmë sot Sadik Latifin, mos i thoni se hasëm në shkëmb, por i thoni se uji po jep shenja dhe ka me dalë ujë deri në mes të pusit ose më lart. - Goni zbriti vetë deri në mes të pusit, ose më'lart. Goni zbriti vetë dhe pa shkëmbin. Në hapësirën e ngushtë ,kepi i tij thërrmonte ndonjë cifël dhe kaq. Megjithatë, Goni nuk mërzitej. U dha në një moment kur shkëmbi filloi të dërmohej më me lehtësi, Goni u gëzua, po ky gëzim i tij u pre atëherë kur shkëmbi filloi të ngurtësohej, sikur t'i kishin hedhur një lëng magjik.

Duke e nxjerrë lart me kovë shkëmbin e copëtuar edhe shokët u gëzuan, puna po ecte, por edhe gëzimi j tyre zgjati ,sa zgjati gëzimi i Gonit.

Në drekë Sadik Latifi erdhi. Ai zbriti nga kerri një arkë me koka-kola. Ishin ulur afër pusit. Ishte herë e parë që ai i qeraste, duke nxjerrë edhe paketën e vet Marlboro. Ai i pyeti për pusin dhe Goni i tha se ishin në mbarim.

- Ani, - tha Sadik Latifi, - mos u ngutni, ujë ka me dalë boll. - Kjo fjalë as i gëzoi, as nuk u solli ndonjë humbje shprese.

- Duken shenjat, - tha Goni, ndërsa kalli cigaren.

Sadik Latifi iku në vilën e vet. Ata pinë koka-kolën dhe u flladitën nga hija e një lisi aty pranë. Prapë u ngritën. Këtë radhë në pus u fut Miti, duke zbritur me litar. Miti dha shenjë që ta tërhiqnin litarin. Ishte kohë e shpejtë dhe shokët u trembën. Kur u ngjit lart, ishte i zverdhur. Nga dora i rridhte gjak. Miti kishte plagosur keq dorën.

Goni ia shpëlau me të shpejtë me ujë dhe ia lidhi me një leckë. Plaga nuk ishte e rëndë. E lanë punën dhe veglat, të pushonin.

Ishte pasdite.

- Nëse Sadik Latifi nuk na jep paratë do ta vras dhe do ta hedh në pus, le të shkojë në djall me gjithë të... - shpërtheu Arifi. Arifi ishte gjaknxehtë dhe priste shkurt. Pas fjalëve të tij, pasoi një heshtje.

- Pusho, o budallë! - iu hakërrye natyrshëm Goni.

" Ne nuk vrasim njeri për një pus.

- I thonë tre mijë marka, or babam, - foli Miti, - . Jo pak.

- Ju jeni në komandën time, paratë do t'ua jap unë, - tha Goni, i cili edhe vetë u çudit për fjalët qe tha. Ai e kuptoi se ndodheshin në një nituatë të vështirë, përderisa tha ashtu, Kishte frikë sidomos gjaknxehtësinë e Arifit, ashtu siç dinte edhe faktin se Arifi s`kishte zemër të vriste. Ajo mbrëmje u mbyll me këto fjalë,

Të nesërmen,vajtën në punë. Shkëmbi s`jepte shpresë, Ishte një shkëmb i bardhë, që qeshte në errësirë, sikur donte t'u thoshte atyre se s'kishin ç›t›i bënin. Sikur ai shkëmb të ishte një metër më poshtë ata do ta hanin me dhëmbë, por ai ishte pesë a më shumë metra dhe ata do t'ia krihnin bishtin. Dukej se shkëmbi po ia merrte frymën ujit, Ata gërmuan shumë pak, dhe, në mbrëmje, Goni lëshoi një propozim të çuditshëm. Ata do ta mbushnin pusin me ujë. Shkëmbi po u vinte në ndihmë,muret anash ishin çimentuar mirë.

- Si s'më vajti mendja për këtë - u gëzua Arifi.

- Sepse ti e pret kashtën e misrit përmbi kalli, - i tha Goni. Arifi qeshi, Miti po ashtu.

Gjithë natën e gjer në mëngjes ata mbajtën ujë me kova dhe e lëshuan në pus.Ishte një natë e errët, po ata orientoheshin mirë.Në mëngjes,Goni zbriti me litar dhe e pa ujin. Duhej të ishte nja një metër e gjysmë, në mos më shumë,që pusi mbushej me ujë. Goni ndenji një gjysmë orë dhe uji nuk lëvizte.Ai u sigurua mirë se, të paktën, dy-tri ditë, pusi do kishte ujë.

Sadik Latifi ende s'po dilte nga vila. Dielli ishte ngritur lart dy hostenë.

- Do shkoj ta thërras, - tha Arifi.

" Jo, - tha Goni, - s'ka përse. Nuk duhet trokitur ta shtëpia e tij, përderisa ai s'na ka ftuar për një kafe, ne jemi punëtorë, jo miq të tij. Puna ka dallim. –Ai i porositi shokët të ishin të qetë.

Sadik Latifi doli nga vila dhe, kur i pa ata të ulur rreth pusit, e kuptoi se duhej ta kërkonin atë. Ai erdhi me hap të ngadaltë, punëtorët u ngritën në këmbë, përshëndeti.

- Doli ujë, - tha Goni.

- Vërtet?! - pyeti Sadik Latifi.

- Për besë, po! - Goni mori kovën dhe e hodhi në pus, një, dy, tre.

- Mjaft, - tha Sadik Latifi,- u lumtë krahu.

- Sa metra"

Goni mori një gur të rëndë e lidhi në litar dhe e hodhi në pus. Pastaj e tërhoqi litarin dhe e mati.

- Plot pesëmbëdhjetë metra, - tha ai. - Na detyrohesh tre mijë marka.

Sadik Latifi nuk bëri fjalë. Ai nxori një tufë me para, ndau ca prej tyre dhe ia dha Gonit, i cili i numëroi me nge e kur mbaroi, i tha Sadik Latifit:

- Tani ta gëzosh pusini : - Kam thënë për një drekë, pranë pusit, - tha Sadik Latifi. .

- Do të rrinim me qejf, po jemi në shtet të huaj, pastaj Arifi ka kohë që ka lënë babën pak zaif, e mua më pret e fejuara...

-Ani,ani, si të doni, - tha Sadik Latifi. Atë paradite i përcolli deri në një vend të caktuar, duke u thënë se, pasi të shkonin në shtëpitë e tyre, mund të vinin prapë në Gostivar. Sadik Latifi do t'i priste...

Komentet e Folknerit për romanin "Absalom, Absalom!" ishin përgjigje ndaj pyetjeve të studentëve në Universitetin e Virxhinias në prill 1957, në Washington University dhe në Lee University në maj 1958. Ato përbëjnë gati një intervistë të plotë të Folknerit për romanin Absalom, Absalom! Përgjigjet janë përfshirë në botimin "Folkneri në universitet: konferencat në auditoret e Universitetit të Virxhinias 1957–1958, botuar nga University of Virginia Press, 1959.

PËRGJIGJET E WILLIAM FAULKNER-IT PËR ROMANIN "ABSALOM, ABSALOM!"

Përktheu nga origjinali Granit Zela

Përkthyesi i talentuar Granit Zela ka dorëzuar për botim tek Onufri, romanin "Absalom, Absalom!" . Kjo është vepra e tretë që Graniti përkthen nga William Faulkner, pas dy romanet e tjerë si "Dritë gushti" dhe "Duke dhënë shpirt", të botuar po nga e njejta shtëpi botuese.

Kush është personazhi kryesor i "Absalom, Absalom!"? Duket shumë qartë që është Satpeni, megjithatë është thënë se është edhe historia e Kuentinit dhe doja të pyesja se kush është personazhi kryesor?

Personazhi qendror është Satpeni, po. Historia e një njeriu që donte një bir dhe pati shumë, aq shumë sa e shkatërruan. Herë pas here është historia e urrejtjes së Kuentin Kompsonit ndaj cilësive të këqija në vendin që ai do. Por personazhi kryesor është Satpeni, historia e një njeriu që donte të kishte bij.

Zotëri, po kështu doja të pyesja se cili mendohej të ishte qëndrimi i lexuesit ndaj zotit Koldfild, babait të Elenës?

Epo, sipas meje ai ishte shumë i varfër. S'e di se cili mund të jetë qëndrimi i lexuesit, por prapë ndieja dhembshuri dhe keqardhje për të, por për mendimin tim ishte një i varfër.

Zotëri, çfarë lloj marrëveshjeje u bë midis Gud'hju Koldfildit dhe Satpenit në lidhje me faturën e transportit? Ata bënë një lloj marrëveshjeje.

S'më kujtohet. Librin e kam shkruar para shumë kohësh, por Koldfildi ishte njeri i vogël, makut. Satpeni ishte i guximshëm, i pamëshirshëm dhe përdori vogëlsinë e Koldfildit për qëllimet e veta, por s'e mbaj mend saktësisht se çfarë ishte…

Në një auditor tjetër keni deklaruar se rrallë e keni paraprakisht të shtjelluar subjektin e romaneve tuaja para se të filloni t'i shkruani, por se ato thjesht zhvillohen duke u nisur nga një personazh ose një ndodhi. Nuk e di nëse e mbani mend se çfarë personazhi apo çfarë ndodhie ju bëri të shkruani "Absalom, Absalom!"?

Satpeni.

A menduat për atë personazh dhe më pas…

Po, ideja e një njeriu që donte bij, i pati dhe pastaj e shkatërruan. Personazhet e tjerë më duhej t'i nxirrja nga papafingoja për të treguar historinë e Satpenit.

Kam hulumtuar për Satpenin – për arsyen e rënies së Satpenit, zoti Folkner, dhe më duket se Lufta Civile luajti rol. A është e vërtetë?

Po.

Por kjo nuk është arsyeja kryesore?

Jo, përdora Luftën Civile për qëllimet e mia. Vendi i Satpenit u shkatërrua nga Lufta Civile, por kjo s'e ndaloi Satpenin, ai ende po përpiqej ta kishte të birin, ende po përpiqej të krijonte një dinasti. Po përpiqej të barazohej me atë njeri i cili në rininë e tij i kishte thënë, "Ik nga dera e pasme".

Zoti Folkner, cila ishte domethënia e veçantë që Uosh Xhounsi, njeri shumë i përulur, të ishte mjeti përmes të cilit Satpeni vdiq? A lidhet kjo me shtresën shoqërore nga e cila vinte vetë Satpeni dhe a ka një lloj efekti ironik? Cila ishte ideja?

Në një kuptim po. Në një kuptim tjetër Uosh Xhounsi përfaqësoi njeriun që i mbijetoi Luftës Civile. Aristokrati në shtëpinë me kolona u shkatërrua, por Uosh Xhounsi mbijetoi i pandryshuar. Kishte qenë Uosh Xhounsi para vitit 1861, dhe pas 1865 ishte ende Uosh Xhounsi dhe Satpeni u përplas përfundimisht me të…

Sa nga historia e "Absalom, Absalom!" është rindërtuar nga Shrivi dhe Kuentini? Si e di lexuesi se cilin rrëfim të pranojë si të vërtetë objektive dhe cilën ta shoh vetëm si një reflektim të personaliteteve të tyre?

Epo, historia u tregua nga Kuentini për Shrivin. Shrivi ishte komentatori [i cili] e lidhte historinë me diçka nga realiteti. Nëse do të lihej ta tregonte vetëm Kuentini, do të ishte një histori krejtësisht joreale. Duhej të kishte një katalizator për ta mbajtur reale, për ta mbajtur të besueshme, bindëse, përndryshe do të ishte tretur si kripa në ujë.

Zotëri, po në këtë linjë diskutimi, ju keni thënë se ju është dashur ta lini mënjanë "Absalomin" në një moment, për ta rifilluar më vonë. Vras mendjen nëse mund të mos ketë qenë fundi i rrëfimit të zonjës Roza – pika ku mund të keni ndjerë që ajo po shkonte shumë larg, sepse menjëherë pas kësaj, ndërhyn Shrivi. A e mbani mend kështu, zotëri?

S'mund të them se kur vendosa ta ndërpresë të shkruarit, vendosa që s'dija aq shumë sa duhej në atë kohë, mbase, ose kisha ndjesinë se s'kisha pasionin e duhur apo s'isha aq i qartë sa duhet, por s'e mbaj mend se në cilën pikë e ndërpreva. Megjithatë kur e rinisa shkrimin e romanit, gati sa nuk e rishkrova të gjithin. Mendoj se ato pjesë që hoqa ishin fragmente të përafërta që s'pajtoheshin me të tërën dhe pastaj kur e rinisa, siç mbaj mend, e rishkrova…

A është marrë titulli i "Absalom, Absalom!" nga pjesa në Bibël tek Samueli i Dytë?

Po.

A e keni shkruar romanin me këtë episod në mendje apo e keni shkruar fillimisht romanin dhe më pas duke kuptuar ngjashmërinë -?

Ndodhi në të njëjtën kohë. Sapo mendova për idenë e njeriut që dëshironte bij dhe bijtë e shkatërruan, mendova për titullin…

Zotëri, sa gjykatës i mirë i veprës së tij mendoni se mund të jetë shkrimtari?

Është, mund të gjykojë vetëm nëse është e shkruar aq mirë sa t'i përshtatet atij apo jo, ose në të kundërt, ndoshta është gjykatës i keq, sepse përfshihet personalisht dhe ndonjëherë nuk pranon të njohë të dobtën dhe këmbëngul që mediokrja është e nivelit të parë - sepse është i përfshirë personalisht.

Dhe po kështu, mund edhe të mos e vlerësojë sa duhet?

Ashtu është.

Zoti Folkner, a ka ndonjë qëllim në përsëritjen e të njëjtave grupe personazhesh gjatë shkrimeve tuaja letrare?

Jo, vetëm se unë kam jetuar gjithë jetës në një qytezë të Misisipit, dhe atje s' ka shumë larmi. Një shkrimtar shkruan mbështetur te përvoja, mjedisi i tij, në mbretërinë e tij të imagjinatës dhe bën vëzhgimet e veta. Ky do të ishte shpjegimi, mendoj unë…

Është thënë që shkruani për sekretin e zemrës njerëzore. A ka një të vërtetë madhore për zemrës njerëzore?

Epo, kjo është një pyetje gati metafizike. Do të thoja se nëse ekziston një e vërtetë e zemrës njerëzore, do të ishte të besuarit në vetvete, të besuarit në aftësinë për të gjakuar, për të qenë më i mirë se sa është, për shembull. Se kjo ekziston te të gjithë njerëzit…

Po mendoja nëse Çarls Boni te "Absalom, Absalom!" kishte dyshuar ndonjëherë se kush ishte i ati.

Mendoj se e dinte. Mbase i tregoi e ëma. Mendoj se e dinte.

A ishte njohuri e vetëdijshme, sipas jush, apo njohuri e pavetëdijshme?

Ndoshta ishte njohuri e vetëdijshme në kuptimin që nëna i kishte thënë kush ishte i ati. Ndoshta s'e besoi, ndoshta s'e dinte ose s'donte t'ia dinte. Mendoj, s'besoj se ai ndjente ndonjë afërsi me Satpenin si babë dhe bir, por ndoshta e ëma i kishte treguar se ajo ishte braktisur dhe nëse kishte ndodhur ndonjë gjë, nëse e kishte besuar, ai e urrente Satpenin, natyrisht.

Zotëri, sipas Nathaniel Haethorne-it, mëkati më i madh ishte dhunimi i zemrës njerëzore. A mendoni edhe ju kështu për sa i përket mëkatit, krimit më të madh ose natyrës së mëkatit? A jeni dakord me këtë pohim?

Po, po, jam dakord.

Zoti Faulkner, gjithë veprën tuaj duket se e përshkon tema e mallkimit për Jugun. Do të doja të dija nëse mund të shpjegonit se çfarë është ky mallkim dhe nëse ka ndonjë mundësi që Jugu të shpëtojë.

Mallkimi është skllavëria, e cila është një gjendje e patolerueshme - askush s'duhet të skllavërohet - dhe Jugu duhet të çlirohet nga ky mallkim dhe kështu do të ndodhë, nëse lihet ta bëjë vetë. S'mund të detyrohet ta bëjë. Duhet ta bëjë me vullnetin dhe dëshirën e vet, gjë që besoj se do ta bëjë nëse lihet të vendos vetë.

A ishte reagimi i njerëzve ndaj martesës së dytë të Satpenit - kur askush nuk u paraqit [në ceremoninë martesës], a u shkaktua ai reagim nga mospëlqimi i



njerëzve për jetën e tij, gabimet shoqërore ose ngaqë s'u ishte treguar pse – ku i kishte marrë paratë?

Oh, ai kishte prishur zakonet vendase. Ata i druheshin dhe e urrenin për shkak se ishte i pamëshirshëm. S'shtirej të ishte ndryshe nga ai që ishte, kështu ai prishi zakonet vendase dhe ata e izoluan. Jo për hakmarrje, aspak, por thjesht sepse s'donin asnjë pjesë të Satpenit…

A është menduar që Satpeni të jetë një personazh krejtësisht i shthurur, diçka si Klegërdi te "Billi Bad" i Herman Melvilit ose Jago te "Otello", apo është menduar që lexuesi të ndiej keqardhje për të?

Për mua, duhet ndjerë keqardhje për të. Ishte i shthurur - ishte i pamoralshëm, ishte i pamëshirshëm, krejtësisht egoist. Për mua, duhet ndjerë keqardhje, ashtu siç duhet të ndjerë keqardhje për këdo që shpërfill njeriun, për këdo që s'beson se është anëtar i një familjeje njerëzore, i familjes njerëzore. Satpeni s'e besonte. Ishte Satpen. Do të merrte atë që donte sepse ishte mjaft i madh dhe i fortë dhe mendoj se njerëz të tillë herët a vonë shkatërrohen, sepse dikush duhet t'i përkasë familjes njerëzore dhe të marrë pjesën e vet të përgjegjësisë në familjen njerëzore...

Në "Absalom, Absalom!", keni thënë se s'e mbani mend shumë mirëse kur Çarls Boni kupton që Satpeni është i ati? A ndodh para ose pasi ai largohet nga Nju Orliëns për të shkuar në universitet?

Them se nëna ia ka ngulitur në mendje duke ia përmendur vazhdimisht me të mbushur moshën kur mban mend dhe se ai erdhi qëllimisht për të kërkuar dhe gjetur të atin, jo për të vënë drejtësi për veten, por për t'u hakmarrë për nënën e braktisur. Duhet ta ketë ditur, ky fakt duhet të ketë qenë pjesë e fëmijërisë së tij, dhe kjo grua e braktisur s'e la kurrë ta harronte këtë.

A ka avokati i Nju Orliënsit përfitimin vetjak në mendje ndërsa ndihmon Bonin dhe të ëmën?

Ka të ngjarë që po. Po, kur e gjeti vendndodhjen e Satpenit, e dinte që Satpeni ishte një njeri i pasur në atë kohë, po, mendonte se do të kishte përfitim, por Boni s'donte përfitim financiar, ai donte të hakmerrej për nënën e tij.

Deri ku mendoni se marrëdhënia midis Çarls Bonit dhe Satpenit është paralele me atë që sipas jush është situate e përgjithshme racore në Jug?

Ishte paraqitje e sistemit të përgjithshëm racor në Jug, i cili ishte i fortë dhe i përqendruar pasi shkrimtari duhet të merret me çdo ndodhi ose formën që merr kjo marrëdhënie, për arsye se s'i ka mbushur gjashtëdhjetë vjet. Shkrimtarit i duhet të bëjë punën e vet në fletët e librit, domethënë, të mishërojë një gjendje të përgjithshme të vazhdueshme në Jug.

Zotëri, a jeni i vetëdijshëm për ngjashmëri midis Tomas Satpenit dhe Flem Snoupsit? S'mendoj se ka ndonjë komedi te "Absalom, Absalom!", por ka shumë komedi sigurisht te romanet "Katundthi" dhe "Qyteza", por që të dy kanë një projekt madhështor dhe i përdorin njerëzit në mënyrë të paskrupullt.

Epo, vetëm Satpeni kishte një projekt madhështor. Projekti i Snoupsit ishte pak a shumë i thjeshtë - thjesht donte të pasurohej, s'donte t'ia dinte se si. Satpeni donte të pasurohej vetëm për shkak të një ndodhie të rastësishme në jetën e tij. Donte të hakmerrej për të gjithë të bardhët e shtresave të ulëta kundër aristokratit që i tha të kalonte nga dera e pasme. Donte të tregonte se edhe ai mund të krijonte një dinasti - mund ta bënte veten mbret dhe të krijonte një trashëgimi princash.

Ky qëndrim i pashpirt i Satpenit dhe Flem Snoupsit, kjo aftësi për t' përdorur njerëzit pa e kuptuar se janë njerëz, një lloj çnjerëzimi i tyre, duket se dalëngadalë përkeqësohet ndërsa kalojnë nga fshati në qyteza dhe qytete. A është kjo e përcaktuar, diçka e vetëdijshme?

S'u përkeqësua sepse shkuan në qytete. Duhej të shkonin në qytete për të gjetur më shumë njerëz për t'i përdorur. U përkeqësua për shkak të ndjenjës së neverisë që ngjall te të gjithë aftësia për të përdorur njerëzit. Ka shumë pak njerëz që kanë madhështinë e mjaftueshme të shpirtit për të qenë në gjendje t'i përdorin njerëzit dhe të mos ndiejnë neveri për ta. Dhe kjo – neveria për njerëzit – s'u ngjall sepse u zhvendosën në qytet, por për shkak të suksesit...

A e njohu Satpeni Klitemenestrën si bijë?

Jo. Epo, kjo s'do të kishte pasur rëndësi sepse Klitemnestra ishte femër. E rëndësishme për të ishte që të krijonte një trashëgimi dukësh, e kupton. Ai do të krijonte një territor që drejtohej nga një dukë. I duhej pasardhës mashkull. Do të krijonte një dukat si hakmarrje ndaj Virxhinasit të bardhë i cili i tha që të shkonte te dera e pasme. Dhe kështu një zezak, një gjysmë-zezak si bir do t'ia prishte të gjithë ëndrrën. Nëse do të kishte menduar se do të zbulohej ndonjëherë që Boni ishte i biri, ai mund ta kishte vrarë vetë Bonin. Nëse do të kishte ardhur ndonjëherë në atë pikë, do ta kishte shkatërruar Bonin ashtu siç do të kishte shkatërruar çdo individ tjetër që do t'i bëhej pengesë.

Do të doja të kthehesha te Çarls Boni. Kam përshtypjen se deri në fund të fundit të librit ai s'e kupton se është pjesërisht zezak... Në cilën pikë e zbulon këtë dhe si e zbulon?

Mendoj se Boni e dinte gjatë gjithë kohës që nëna e tij ishte pjesërisht zezake, por gjatë fëmijërisë së Bonit kjo s'kishte rëndësi. Ai u rrit në Indies ose në Nju Orliëns, vendi s'ka shumë rëndësi. Nëna ishte grua e pasur. Mund ta quante veten kreole nëse kishte gjak zezaku së bashku me francezët ose jo. Kjo u bë e rëndësishme vetëm kur Boni e kuptoi se kishte rëndësi për të atin. Mendoj se Boni u përfshi në këtë punë, sigurisht, ngaqë krijoi një miqësi me Henrin dhe ndjeu që Henri, djali i paditur fshatar, kishte për të një lloj adhurimi, admirim dhe adhurim që i pëlqente. Pastaj, kur u përball me një kockë të fortë si babai i Henrit ndërkohë që e dinte se ishte edhe babai i tij, në një farë mënyre i kishte dhënë të atit një shans për të thënë, "do të të pranoj, por nëse e bëj botërisht dhe ti qëndron këtu, ti do të rrënosh atë që i kam kushtuar jetën time, prandaj merre dashurinë time dhe largohu", mendoj se Boni do ta kishte bërë. Por ky plak kishte frikë ta bënte. Dhe Boni e nxiste të sillej në mënyrë të vrazhdë me të, pjesërisht si hakmarrje ndaj mënyrës si e kishte trajtuar nënën e tij, të Bonit, derisa Boni u përfshi jashtëzakonisht shumë në atë histori. Pra, Boni e dinte që ishte zezak, por derisa e kuptoi se kjo ishte e rëndësishme për Satpenin, s'kishte qenë e rëndësishme për të. Ishte një zotëri, ishte rritur me të gjitha të mirat, ishte kulturuar, arsimuar shumë më mirë sesa Henri.

A e donte Boni Xhuditën, apo…?

Mendoj se po, mendoj se e donte. E dinte që nëse ajo do ta merrte vesh që ai ishte pjesërisht zezak, me arsimin dhe formimin që kishte do ta kishte shkatërruar edhe atë,

Zoti Faulkner, a ka te "Absalom, Absalom!" ndonjë që rrëfen për Satpenin këndvështrimin e duhur, apo është pak a shumë si rasti i trembëdhjetë mënyrave për të parë një mëllenjë të zezë1 ku asnjëra prej tyre s'është plotësisht e saktë?

1 "Trembëdhjetë mënyra për të parë një mëllenjë të zezë" është një poezi nga libri i parë me poezi i Wallace Stevens, "Harmonium". Poezia përbëhet nga trembëdhjetë pjesë të shkurtra, të ndara, secila prej të cilave në një farë mënyre flet për mëllenjën e zezë.



Është pikërisht kjo. Mendoj se asnjë individ s'mund ta shoh të vërtetën. Ajo të verbon. Ti këqyr nga nga ajo dhe sheh një fazë të saj. Dikush tjetër e këqyr dhe sheh një fazë paksa të shtrembëruar të saj. Por nëse merren së bashku, e vërteta është në atë që ata panë, megjithëse askush s'e pa të vërtetën e kulluar. Pra, këto janë të vërteta për sa i përket mënyrës si e panë zonjushë Roza dhe Kuentini. Babai i Kuentinit pa atë që ai besonte se ishte e vërtetë, kjo ishte gjithçka që pa. Por plaku ishte vetë pak më i madh për njerëz me shtatin e Kuentinit, zonjushë Rozës dhe zotit Kompson – për të parë gjithçka njëherësh. Do të ishte dashur ndoshta një person më i mençur, më tolerant ose më i ndjeshëm ose më mendimtar për ta parë atë ashtu siç ishte. Ishin, siç thoni ju, trembëdhjetë mënyra për të parë një mëllenjë të zezë. Por e vërteta, dua të mendoj se del kur lexuesi i ka lexuar të gjitha këto trembëdhjetë mënyra të ndryshme të shikimit të një mëllenje të zezë, kështu, lexuesi krijon imazhin e katërmbëdhjetë të asaj mëllenje të zezë, imazh i cili do të doja të mendoja se është e vërteta.

Zoti Folkner, zoti Koldfild në "Absalom, Absalom!" mbyllet në papafingo kur fillon lufta midis shteteve. Tani, pse e bëri? Mos vallë sepse ishte një lloj kundërshtari i vetëdijshëm, apo sepse ishte pak ose shumë frikacak?

Jo, ndoshta për shkak të skrupujve fetarë ishte kundërshtar i vetëdijshëm. Gjithashtu, ka shumë mundësi që ishte Unionist. Që e urrente kërcënimin për shpërbërjen e Unionit. Që s'kishte guximin e mjaftueshëm për të bërë diçka përveçse ta fshihte kokën si struci në rërë. Por mendoj se me shumë gjasë ishte Unionist. Ndoshta ngaqë kishte ardhur nga Tenesi lindor, ku njerëzit asokohe ishin unionistë. Ai kishte një traditë besnikërie ndaj Shteteve të Bashkuara ashtu siç ishin. Ata s'kishin asnjë traditë agrare në të cilën skllavëria ishte një pjesë e rëndësishme e saj.

Zotëri, ndërsa lexojmë "Absalom, Absalom!" sa mund të ndiejë një lexues që është Kuentini, i njëjti Kuentin i romanit "Buja dhe tërbimi" - domethënë, një burrë që mendon për familjen e tij Kompson, për motrën e vet?

Për mua, ai është i qëndrueshëm. Iu qas familjes Satpen me të njëjtën turbullirë shikimi që iu qas telasheve të veta, ai ndoshta s'pa kurrë asgjë shumë qartë, ajo që pa ishte vetëm një nga trembëdhjetë mënyrat për ta parë Satpenin dhe mënyra si e pa ai, mund të ketë qenë një nga më të gabuarat. Ndoshta shoku i tij Mekkenën rroku një pamje shumë më të vërtetë të Satpenit nga ajo që Kuentini i tregoi sesa vetë Kuentini.

Por sidoqoftë është historia e Satpenit. S'është historia e Kuentinit.

Jo, është historia e Satpenit. Por pastaj, sa herë që ndonjë personazh futet në një libër, sado i vogël qoftë, në të vërtetë tregon biografinë e tij – këtë e bëjnë të gjithë, flasin për veten me një mijë mënyra, por për veten. Kuentini ende po përpiqej që Perëndia t'i tregonte pse, te "Absalom, Absalom!" ashtu si edhe te "Buja dhe tërbimi."

A mund t'ju pyes se çfarë mendoni për Xhejms Xhojsin?

Xhemjs Xhojsi ishte një nga njerëzit e mëdhenj të kohës sime. Ai ishte goditur me elektroshok nga zjarri hyjnor. Ai dhe Tomas Mani, ishin shkrimtarët e mëdhenj të kohës sime. Ai ndoshta ishte - mund të ketë qenë më i madhi, por ishte i goditur me elektroshok. Kishte më shumë talent sesa mund të kontrollonte…

Në lidhje me këtë, do të doja të pyesja përse Misisipi duket shumë aktiv në aspektin letrar dhe megjithatë s'e gjejmë të njëjtin fenomen në Nju Xhersi.

Epo, kjo ndodh për shkak se Misisipi është në Jug dhe Nju Xhersi është në Veri. Mendoj se gjëja më e mençur që çdo vend mund të bëjë kur ndodhet në çdo lloj vështirësie ekonomike është të zgjedh një vend të pasur dhe t'i shpallësh luftë, të tejkalosh problemin dhe pastaj të fitosh mbështetjen e tij. Njerëzit në Jug shkruajnë sepse Veriu na ka mbështetur që nga viti 1865. Kishim shumë kohë për të shkruar…

Ai ishte "Absalom, Absalom!" roman shumë i vështirë për t'u shkruar?

Po zonjushë, ishte i vështirë. Këtë roman e kam shkruar pas romanit më të vështirë "Buja dhe tërbimi", me sa mbaj mend. Po, kam shkruar për një vit rresht dhe pastaj e ndërpreva dhe shkrova një libër tjetër, pastaj historia ende s'po më linte rehat dhe iu ktheva. Po, ishte shumë i vështirë. Shumë pjesë në këtë roman i kam rishkruar.

Nga drama *Duke pritur Godonë* (Beckett). Festivali i Avinjonit, 1978.

LARTËSITË SUBLIME TË DIJES DHE KULTURES

Nga Feride Papleka

Duke edukuar Ritën

Vepër dramatike nga Willy Russell, përkthyer nga Artur Lena, vënë në skenë me teatrin shëtitës Çajupi nga regjisori Kiço Londo.
Ne rolet kryesore: Laura Nezha dhe Mehmet Xhelili

"Një skenë teatri është një nga vendet ku ndihem i lumtur", i përgjigjet Albert Camus një gazetari që e pyet përse shkruan për teatër. Dhe vazhdon: " Këtu ne jemi të gjithë të lidhur, pa pushuar asnjë çast së qeni të lirë, ose përafërsisht të tillë: a nuk është kjo një formulë e zgjidhur për shoqërinë e ardhshme?"

Përmbajtja

Rita (Suzana), një floktare e re nga Liverpuli, vendos ta ndryshojë jetën e saj monotone duke u regjistruar në një Universitet të Lirë, në kursin Hyrje në letërsi. Kështu ajo nga dita në ditë nis të zbulojë identitetin e saj të fshehtë dhe e ta zhvillojë atë. Këtë betejë të bukur ajo e përmbush me mësimet që i jep profesori i letërsisë, Frank (vetëm kur pjesa u përshtat për film ai doli me mbiemrin Bryant dhe me titullin Dr.), në gjysmë moshe që i dorëzohet herë pas here alkoolit. Ai e pranon rolin e tij si kujdestar (tutor) që të mund të fitojë disa para më shumë për të paguar pijen. Por profesori mahnitet me vendosmërinë dhe natyrshmërinë e Ritës. Ai dhe studentja e tij kalojnë një vit nëpër udhët e shkelura, por edhe në ato të pashkelura për afirmimin e personalitetit në një shoqëri që po mësohet të thyejë tabutë e dikurshme. Ata bëhen bashkudhëtarë me shpresa dhe zhgënjime, por që më në fund triumfojnë në sajë të një pune plot dashuri e pasion për shkollën dhe librin. Pjesa përfundon me vendimin e Frankut për të shkuar një vit në Australi me qëllim që të rishikojë disa pikëpamje për jetën.

Konteksti historik

Jemi në vitet '80 kur konceptet për lirinë ndryshojnë. Por ndryshojnë edhe natyra e institucioneve, e marrëdhënieve mes njerëzve dhe e vetëzhvillimit. Vajza dhe gruaja janë afirmuar në shoqëri me vështirësi dhe duan që ta meritojnë atë vlerësim. Shumë komente e lidhin veprën me një ideal të përparuar të autorit, që i jep asaj frymë aktuale në çdo kohë. Autori është tridhjetë e pesë vjeç kur shkruan Duke edukuar Ritën. Ai ka shkruar edhe më parë, por pjesa e re teatrore përmbledh edhe disa karakteristika kryesore të epokës, të cilat ia shtojnë frymën bashkëkohore dhe jetëgjatësinë. Natyralizmi dhe realizmi ishin shfaqur që me dramat e Strindbergut, Çehovit, Shout dhe Ibsenit, kësisoj ato u kthyen në një udhëzues të heshtur për autorin e ri.

Koment

Tema e përpjekjes së njeriut për të qenë vetvetja duke ecur në shtigjet e dijes dhe kulturës është universale dhe e përjetshme. Dija dhe kultura, dy emblema që lejojnë të hysh në universin e pafund të formimit të individualitetit, fitohen nëpërmjet shkollës dhe librit. Me këtë ide të fuqishme pjesa u fut menjëherë në repertorin e trupave më të shquara të kohës dhe mbeti një manifest kulturor për njeriun në përgjithësi. Personazhi kryesor, Rita i vazhdon studimet dhe njëkohësisht punon për të siguruar jetën dhe përballuar shpenzimet e arsimimit. Ajo është vendosur dhe e pasionuar. Frank, profesor universiteti, pranon t'i zhvillojë asaj kurse private edhe pse në fillim ngurron, por zelli i saj për të studiuar e shtyn që ta shohë me sy tjetër realitetin. Rita është plot besim për horizontet e reja që po i hap dija, ndërsa profesori i saj, megjithëse mjaft i përgatitur profesionalisht, nuk ka edhe aq besim te jeta. Sidoqoftë ai ndodhet në një periudhë kthese të jetës së tij dhe mendon se dijet nuk i kanë shërbyer për gjë, madje e kanë çuar në përfundimin e hidhur se nuk është poeti që do të kishte dashur të ishte. Madje, ai nganjëherë nuk do që të vazhdojë kurse me Ritën, sepse druan se edhe ajo mund të zhgënjehet si ai.

Në një strukturë të studiuar mirë vepra shpalos disa ide, por kryesorja është se ne mund të bëhemi vetvetja nëpërmjet dritës së diturisë. Kjo kryeide, metaforë e gjithhershme mund të marrë edhe ngjyrime të tjera si: dritë në mendim, kurajë në jetë, përparim, zhvillim i individualitetit, tejkalim i vetvetes... Rita dalëngadalë transformohet në mishëruese e një bote me kulturë dhe dije. Sepse ajo e ka shprehur që në fillim motivin e madh që e nxit të ecë përpara:"Dua të di gjithçka". Brenda këtij universi ka rrugë të shumta e labirinte, që janë burimi origjinal për të shijuar bukurinë e transformimit deri në sublimitet.

Diagramin ngjitës të Ritës e realizon në mënyrë të shkëlqyer aktorja Laura Nezha. Loja e saj është e jashtëzakonshme, tërë kuptime të drejtpërdrejta e të fshehta. Këtu është vendi t'i thurim lëvdatë edhe mësimeve që ka marrë ajo në Universitetin e Arteve. Laura arrin të japë në mënyrë të paepur, mrekullisht të pasur me ndryshime, transformimin e Ritës nga një e paditur e sinqertë dhe e etur për dije, në një njeri që studion me vetëdijen e njeriut të përqendruar te e rëndësishmja. Ajo nis ta quajë dijen elementin kryesor të njeriut në një shoqëri të qytetëruar.

Rita është e vetëdijshme se nuk di, por falë këmbënguljes për të studiuar ka besim se do të bëhet dikush tjetër, me mendje të ndritur dhe shpirt të pasuruar. Ajo shkon nga domethënia te kuptimi i thellë i gjërave. Perceptimet e saj ndryshojnë. Interesat zgjerohen. Shqetësimi i saj i madh është të fitojë dije, prandaj vullneti i saj kthehet në i gjithëpushtetshëm. Qëndrimet e saj bëhen më të matura dhe intelekti i saj zhvillohet në mënyrë të pazakontë. Vizionet e shikuesit për realitetin e saj shpirtëror shenjtërohen. Qasjet e saj për veprat letrare bëhen estetike. Personaliteti i saj shfaqet i kulluar. Shpjegimet e saj fitojnë ngjyrime poetike.

Ngjitja e Ritës në lartësitë sublime të dijes dhe kulturës realizohet nën udhëheqjen e profesor Frankut, që megjithëse i çmeritur nga jeta, e drejton studenten e tij në udhën e gjerë të dijes. Vetje të tilla janë simbole, shprehëse të vërteta të njeriut të sotëm, por edhe të faktit madhor se dija kërkon mënyrën e vet për t'u bërë pjesë e kërkimeve dhe shqetësimeve jetësore. Me dije bashkëkohore të individualizuara dhe me zgjuarsi, profesori e përpunon Ritën si të ishte një vepër arti. Mësimet që jep ai janë një përvojë e re, e cila ndikon edhe në përpunimin e personalitetit të tij, sidomos në pikëpamjet për jetën dhe artin. Këtë e realizon në mënyrën më të përsosur aktori Mehmet Xhelili.

Ne jemi të sigurt se tipa si Rita dhe Franku mund t'i kemi takuar apo mund t'i takojmë në jetë. Rita ka etje për dije, ajo kërkon të dalë nga mosdija e të ecë në rrugën e një bukurie të lartësuar. Vendosmëria e saj për t'u realizuar duke e kapërcyer përditësinë e saj të vogël me studimet e mëtejshme në Universitet, është tejet frymëzuese. Ajo i qëndron besnike pasionit të saj dhe shfaqet para shikuesit nga skena në skenë me një dritë të re të brendshme që i jep dituria. Ajo është një natyrë origjinale, e vërtetë, tërheqëse duke vërtetuar kështu natyrën e njëmendtë të vajzës dhe gruas si origjina dhe ripërtëritja e botës. Autori mesa duket ka një kuptimësi të thellë për këtë pasuri të çmueshme, prandaj i shpalos fuqishëm idetë e tij për një shoqëri me figurën e gruas si simbol të përparimit. Vepra e tij i drejton një kritikë të tërthortë, do të thoshim me mprehtësi, por hijshëm, sistemit arsimor që nuk zhvillon sa duhet mendimin e gjallë kritik nëpërmjet tekstesh të zgjedhura konceptuale si një kusht i domosdoshëm për formimin e gjithanshëm të personalitetit të njeriut. Vetëm pasurimi mendor dhe shpirtëror do ta shtyjnë njeriun të kryejë vepra që i shërbejnë gjithë shoqërisë.

Përpara syve të shikuesit Rita dhe Franku realizojnë një ëndërr që shumëkush e ka menduar një ditë. Borhesi, shkrimtari i madh argjentinas, thotë: "Ëndërro, ëndërro se dikur ëndrra mund të bëhet realitet". Pra, vepra lë të nënkuptohet edhe se gjithçka e mirë dhe e bukur është e mundur në çdo kohë dhe në çdo vend.

Kjo komedi e luajtur gati në të gjithë botën, e bërë film dhe e vlerësuar me çmime ka marrë jetë në skenën shqiptare nga puna e regjisorit të talentuar Kiço Londo me teatrin shëtitës Çajupi. Shfaqja e korrikut në teatrin veror të Universitetit të Arteve me skena në të cilat çdo veprim dhe dialog ishte funksional, është tregues i stilit të ri të regjisë së tij me frymë bashkëkohëse.

Edhe skenografia është një gjetje artistike e studiuar mirë.

Dy fjalë për autorin e veprës dhe përkthimin e saj në gjuhën shqipe

Willy Russell (1947) është autor, skenarist, muziktar dhe aktor britanik. Ai ka lindur në Whiston, afër Liverpulit. Megjithëse rridhte nga një familje e thjeshtë (i ati ishte punëtor), ai kaloi një fëmijëri normale. I pëlqente shumë letërsia dhe që në kolegj u zhyt në lexime. Pastaj, në adoleshencë e pasuroi përvojën e tij edhe me artin e muzikës, duke dëgjuar ndër të tjerë edhe bitëllsat. Ai i filloi studimet e larta në një Universitet nate duke punuar, por e kuptoi shpejt se kështu nuk mund të realizohej plotësisht ëndrra e tij për një kulturë të plotë. Ai u regjistrua në një universitet dite, por u detyrua të punonte natën për të financuar studimet.

Russell në të vërtetë e filloi mjeshtërinë prej shkrimtari si autor këngësh, duke u interesuar për muzikën tradicionale. Kur ishte 20 vjeç ai ndoqi një pjesë në teatrin e Liverpulit dhe vendosi papritur të shkruante për teatrin. Pjesa e parë e tij për teatër u shfaq më 1971, pa ndonjë sukses të veçantë. Por premiera e komedisë Duke edukuar Ritën, më 1980 pati shumë sukses dhe vepra fitoi çmimin e parë si komedia më e mirë e atij viti. Ajo u përshtat shumë shpejt për kinema dhe Russell u emërtua për çmim Oskar si skenarist.

Willy Russell ka lindur në një vend me tradita të fuqishme teatrale, prandaj në veprën e tij dialogu është plot ide që shndërrohen në filozofi të jetës. Skenat e teatrit të tij u ngjajnë një partiture muzikore që gjen dalëngadalë ritmet e gjalla të jetës së vërtetë. Përpjekja e njeriut për t'u bërë vetvetja në mes të një shoqërie që karakterizohet nga çekuilibre shoqërore, kulturore dhe politike, mbetet temë e ditës në letërsi, prandaj vepra e tij luhet kudo në botë dhe përherë me sukses.

Duke edukuar Ritën, është përkthyer nga Artur Lena. Përkthimi është akt intelektual. Ajo që vlerësohet në një përkthim është bartja e kuptimit të saktë nga teksti origjinal në atë të përkthyer. Të gjykosh një përkthim, para së gjithash do të thotë të shohësh të mishëruar barasvlerën e dy teksteve nga një gjuhë në tjetrën, në rastin konkret nga anglishtja në gjuhën shqipe. Strategjia e përkthimit të mirë qëndron te koncepti se mund të thuash të njëjtën gjë me fjalë të tjera duke ruajtur pandashmërinë kuptim/formë. Përkthimi i Lenës sidoqoftë arrin ta transmetojë mjaft mirë mesazhin e autorit. Sigurisht mund të shmangej ndonjë vulgaritet i tepruar, por kjo vërejtje bëhet në përgjithësi, pa u bazuar në tekstin origjinal. Gjithashtu educating në anglishte ka kuptimin : duke arsimuar, duke shkolluar dhe education: arsim, arsimoj, apo shkollë dhe shkolloj; në frëngjishte: Education nacionale, përkthehet Arsimi kombëtar.

Edukoj, në shqipe ka marrë tjetër kuptim. Edukoj nuk është baras me arsimoj, shkolloj.

Pakëz histori

Teatri ka lindur në Greqinë antike. Fillimisht teatër quheshin disa rituale që u kushtoheshin adhurimit të zotave. Fjala e vjetër greke « teatron » simbolizonte skenën, pjesën e ndarë nga publiku me një perde. Po të kthejmë sytë në fillimet e njerëzimit « teatri » nënkuptonte aktorin që tregonte duke e rijetuar një skenë gjahu apo konflikti.

Në shekullin IV para erës sonë Athina pati një zhvillim të madh kulturor, në të cilin u shquan dramaturgë të mëdhenj si dhe filozofë. Dy shekuj më vonë teatri u duk edhe në Romë, ku shfaqjet ishin kryesisht festa zyrtare të qytetit. Në periudhën e shkëlqimit të perandorisë romake çdo qytet kishte teatrin e tij.

Rrëfimi teatror lidhet me ndjeshmërinë e publikut, sepse komunikon me të në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai u ka mbijetuar kohërave dhe hera-herës është karakterizuar nga një rigjallërim i vetvetishëm me përgjithësime filozofike, me stil të ri, me ide të fuqishme dhe me simbolikë domethënëse. Duke qenë ligjërim me një gjuhë të veçantë, ai kërkon vërtetësi në dialog. Duke folur për tragjedinë në veprën Poetika, Aristoteli e quan dialogun pikën më të rëndësishme të saj.

Në Greqinë antike janë zhvilluar konkurse teatri dhe veprash teatrore qysh prej shekullit V para erës sonë. Në teatrin grek dhe në atë romak aktorët mbanin maskë. Kishte edhe maska tragjike për të treguar një fytyrë të trishtuar, por edhe maska komike, për një fytyrë të qeshur; ka pasur edhe maska të dyfishta me njërën anë tragjike dhe tjetrën komike. Aktorët ishin përgjithësisht burra, me veshje të mëdha prej fijesh të gjata leshi dhe fibrash bimore, me flokë të ngritur lart për të krijuar idenë e diejve dhe heronjve gjigantë që mishëronin.

Duke filluar nga shekulli XI teatri u përhap në të gjithë Europën, fillimisht në kisha dhe sheshe publike e pastaj në Universitete. Teatri në atë kohë ishte një trupë shëtitëse ku luheshin pjesë të llojit « Mrekullitë » apo « Misteret » si dhe drama liturgjike.

Në Francë, në shekullin XX pati një lëvizje teatrore të madhe që u kurorëzua me teatrin filozofik të Sartrit dhe Kamysë. Teatri absurd i Ioneskos që bazohet te një dialog ilogjik, pati një dështim publik me pjesën Këngëtarja tullace, por më vonë u bë tepër i frekuentuar. Madje një teatër në lagjen Latine mban emrin e dramës së tij të parë për teatrin absurd La Cantatrice chauve (Këngëtarja tullace).

Format ligjërimore të veprave teatrore janë dialogu me dy a më shumë personazhe, monologu, kur një personazh shpreh mendimet e tij në vetmi dhe soliloku që është shprehje e mendimeve dhe ideve me zë përballë një bashkëbiseduesi të papërcaktuar. Në krijimet bashkëkohore përzihen disiplinat e ndryshme të artit, prandaj në këtë kohë artesh shumëdisiplinore përkufizimi i artit teatror është përherë e më i ndërlikuar. Ka edhe shfaqje pa tekst, teatër muzikor si në lagjet e Brodway në New York, në West End në Londër dhe në Grands Boulevards në Paris.

Ka autorë që kanë pasur ndikim të fuqishëm dhe shikues të shumtë qëkur ishin gjallë si Aristofani, Eskili, Euripidi, Seneka, Sofokliu, në teatrin antik; Kalderoni, Marlou, Shekspiri, Lope de Vega në teatrin barok; Kornej, Molieri, Rasini në teatrin klasik; Gëte, Viktor Hygo, Muset, Rostand, Shiler në teatrin romantik...

Teatri e fitoi konceptin që ka sot në fillim të shekullit XX falë pionierëve dhe pedagogëve të teatrit të ri, Konstantin Stanislavski dhe Bertold Breht. Stanislavski themeloi i pari teatrin e Moskës. Në vitin 1900 aty u luajt Tre motrat e Çehovit. Duke ngritur shkollën e tyre regjisorë si Stanislavski e ndonjë tjetër donin t'i jepnin fund mitit të frymëzimit dhe talentit me të cilat teprohej. Sipas tyre teatri ndërtohet mbi baza shkencore. Aktor apo aktore të bën mbi të gjitha një pedagogji dhe praktikë e disiplinuar.

Ka një pushtet të veçantë shfaqja teatrore mimesis sipas Aristotelit që lejon t'u bësh ballë mistereve të jetës. Njerëzit e teatrit : autor dhe aktorë, kërkojnë të krijojnë një pasqyrë, ndonjëherë edhe karikaturale të shoqërisë për ta kuptuar atë edhe më mirë, për t'ia zbuluar dhe për t'ia kritikuar të metat. Ajo që thotë Shekspiri te tragjedia Hamlet, se "teatri është një pasqyrë e varur në natyrë : shikuesi ashtu si edhe aktori vijnë aty për të marrë një përgjigje", është shumë domethënës për të gjitha kohët.

Teatri mund të ketë edhe ndikim katarsik, të shërojë nga pasionet që e dëmtojnë shoqërinë.

Një formë që i ka dhënë zhvillim teatrit janë edhe festivalet teatrore që mbahen edhe si tipi i parë i festivalit. Festivalet e teatrit filluan të shfaqen në botë nga vitet '30 të shekullit XX. I pari festival teatrosh është ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 1935, pastaj në Francë, më 1947, në Kanada dhe në Angli po më 1947, në Belgjikë dhe në Irlandë, më 1950, në Australi, më 1960 etj.

Në Shqipëri është Festivali Ndërkombëtar i Teatrit në Butrint, Butrinti Summer Festival.

Teatri i Taorminës, vizioni që ka piktori Gustav Klimt për teatrin grek të Antikitetit.

HAMLETI DHE LEXIMET E MUNDSHME TË KËSAJ FIGURE NË KOHË

Prof. Dr. Klara Kodra

Hamleti i Shekspirit është një personazh i pazakontë në një shekull veprimi, si njeri i dilemave dhe i dyshimit.

Ka kritikë si Bielinski që e shohin si njeri të mendimit, të paaftë për të vepruar.

Të tjerë si Noli ynë e shohin përkundrazi si njeri të matur që i zotëron pasionet dhe synon të përpunojë një strategji sa më të efektshme për të vepruar, për të vendosur drejtësi.

Në të vërtetë figura e tij është kontradiktore, ai është njeri i lindur për të mishëruar virtytet e Rinashimentos, ka mençurinë, përgatitjen, guximin, humanizmin, do të mund të ishte një mbret që do të mbronte kulturën dhe artet dhe do të kontribuonte në lulëzimin ekonomik të vendit të vet, po rrethanat e shndërrojnë në një hakmarrës që vërtet vë në vend drejtësinë e cenuar, po shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë vdekjen e njerëzve të pafajshëm si Polloni, Ofelia, njerëzve të dobët dhe jo aq fajtorë si Laerti dhe dy të rinjtë në shërbim të Klaudit.

Pra, ky njeri tepër human kur i drejtohet dhunës kalon caqet.

Figura e tij jep rast për lexime të ndryshme. Shekulli i shtatëmbëdhjetë dhe shekulli i tetëmbëdhjetë s'do ta kuptojnë sa duhet këtë figurë. Iluministi Volter e quan barbar Shekspirin për guximin e tij në pikturimin e jetës, të pasioneve njerëzore të skajshme.

Shekulli XIX ishte më i aftë për ta kuptuar Hamletin si figurën e një intelektuali të munduar nga problemet ekzistenciale të jetës dhe të vdekjes, domosdoshmërisë dhe lirisë.

Hamleti i shekullit XX mund të ishte një intelektual që do të donte të reformonte botën në mënyrë revolucionare, po do të ngurronte para dhunës.

Si do të ishte Hamleti i shekullit XXI kur idealet e majta të revolucioneve nga një anë dhe ideali i progresit teknologjik që do të sillte lumturinë dhe begatinë e njerëzimit nga ana tjetër kanë rënë?

Ky hero do të mundohej nga dyshimet dhe dilemat shumë më tepër se Hamleti i Shekspirit; do ta mundonte paaftësia e vet për ta rindërtuar botën, po do të ishte nga ana tjetër i çorientuar nga mungesa e ndonjë ideali të qartë dhe nga kaosi i vlerave ku është vështirë të dallohet e mira nga e keqja. Ndonjë ideal i mundshëm do të ishte ideali i solidaritetit njerëzor para rreziqeve të shumta që e kërcënojnë planetin, ideali i zhdukjes së luftërave shkatërrimtare dhe i përdorimit të shkencës dhe teknologjisë në dobi të njerëzimit.

Ekzistenca e armëve të tmerrshme bërthamore dëshmon për faktin se një luftë e re botërore do të ishte vetëvrasje e sigurtë për njerëzimin.

Pra, një Hamlet modern nuk do të kënaqej me vetëgjyqësi për padrejtësitë që mund t'i ishin bërë atij individualisht, po do të synonte të bashkohej si ushtar i thjeshtë apo si udhëheqës në një përpjekje të bashkuar të njerëzimit për të zhdukur luftërat dhe për të shpëtuar planetin.

Kjo do të ishte e vetmja zgjidhje për të kapërcyer dilemat dhe dyshimet.



MENDIMI KRIJUES

Auguste Rodin dhe "Mendimtari"

Nga Joe McGasco

Në çdo epokë të artit, gjenden punime të cilat i tejkalojnë sferat e koleksionuesve të artit dhe të frekuentuesve të muzeve, duke kapur imagjinatën e publikut. Vepra si Mona Lisa e Da Vinci-t, Britma e Edvard Munch, ose Nata me yje e Van Gogh, kapërcejnë kohën dhe vendndodhjen duke u kthyer në standarde kulturore, kaq të afërta me konceptet tona të artit, saqë me kalimin e kohës, bëhen objekt i parodive dhe komercializimit (a dëshiron ndokush një qese me Van Gogh-un?). Numri i veprave të artit që kanë këtë lloj ndikimi është i pakët, por, një nga më të mirënjohurat dhe më të vlerësuarat, është një skulpturë e një francezi me emrin Auguste Rodin, i cili, në fund të shekullit të 19-të, krijoi një ikonë, të cilën e quajti Le Penseur. Këtë e njohim me emrin Mendimtari dhe shumë prej nesh, mund të krijojnë një imazh në mendje, pa parë asnjë foto të tij.

Ndryshe nga shumica e skulpturave që njihen menjëherë nga publiku, Mendimtari nuk është një statujë e madhe patriotike si Statuja e Lirisë në New York, ose statuja e Krishtit Shpëtimtar që qëndron mbi Rio de Janeiro. Krijuar me një madhësi modeste dhe bazuar mbi një temë reflektimi, në vend të një ngjarje të shënuar apo përkujtimi, Mendimtari përçon një ide të cilën mund ta rrokin të gjithë – nevojën për analizë të heshtur – por e paraqet në një mënyrë aq të qartë, saqë e bën këtë proces të brendshëm të duket fizikisht i prekshëm. Portretizimi i fortë i aktit të thjeshtë të të menduarit, e ka bërë po aq të njohur sa veprat e tjera të mëdha publike dhe qëndron (më saktë, ulet) si një vepër e denjë në radhët e kryeveprave nga Da Vinci, Munch dhe Van Gogh që u përmendën më sipër.

Po si u krijua kjo skulpturë me famë botërore? Biografitë e sotme trajtojnë historinë pas krijimit të Mendimtarit, një vepër e cila, me thjeshtësinë e paraqitjes, forcën e krijimit dhe hijen e misterit, vazhdon të ketë ndikim te njerëzit, edhe 100 vjet pas krijimit.

Krijimi i emrit të tij

Duke marrë parasysh famën që arriti në fund, ditët e hershme të François Auguste René Rodin si artist, kanë qenë të paqëndrueshme dhe të vështira. Ndërsa iu refuzua tri herë pranimi në shkollën më të mirënjohur të artit, École des Beaux-Arts, Rodin ushtroi talentet e tij artistike duke bërë punë dekorative për shtëpi dhe ndërtesa publike. I pakënaqur nga ana artistike prej kësaj pune me pagesë, për të pasuruar biografinë e tij, ai punoi si asistent i skulptorit Albert-Ernest Carrier-Belleuse, duke ndjekur njëkohësisht, leksione mbi skulpturën.

Një udhëtim në Itali, në mesin e viteve 1870 (kur ishte në të tridhjetat) forcoi vendosmërinë e Rodin për t'u bërë skulptor, ndërsa shihte për herë të parë nga afër, veprat e Michelangelo-s. Puna e tij e parë serioze, Epoka e bronzit (I mposhturi), u përfundua shpejt, pas këtij udhëtimi. Një bronz kaq real, saqë kritikët e akuzuan Rodin se thjesht i kishte dhënë formën një bronzi të vërtetë. Kjo vepër tregoi provën e parë të një stili të përparuar. Një vepër realiste, themelore dhe paksa e paqartë në qëllimin e saj.

Në fund të viteve 1870, ndërsa punonte për Carrier-Belleuse në fabrikën e porcelanit Sèvres në Belgjikë, Rodin u prezantua me disa zyrtarë të lartë të qeverisë franceze, të cilët, e njihnin reputacionin e tij për punë të shkëlqyera dekorative. Edhe pse më përpara nuk pati sukses për të siguruar punë nga qeveria, Rodin nisi të merrte dhe të pranonte punë për monumente dhe skulptura publike. Më e rëndësishmja prej tyre, iu dha në vitin 1880: një portë e madhe për një muze të propozuar të arteve dekorative në Paris. Musée des Arts Décoratifs nuk do të ndërtohej kurrë (aty tani qëndron Musée d'Orsay), por kjo vepër do të nxiste krijimin e shumë veprave të mëpasshme nga Rodin, të cilat, jo vetëm do të çonin në krijimin e Mendimtarit, por do të përcaktonin rrugën e gjithë karrierës së tij.

Portat e Ferrit

Idenë për portën e tij të re, Rodin e bazoi në Komedinë Hyjnore të Dantes, e cila, në fund të shekullit të 19-të, kishte rifituar popullaritetin. Rodin interesohej të përshtaste personazhe nga libri i parë i Komedisë Hyjnore, Ferri, në mënyrë që të kishte një kontrast karshi dyerve të famshme prej bronzi të Pagëzimores së Firences, të krijuara nga Lorenzo Ghiberti, të cilave, Michelangelo, u referohej si Portat e Parajsës. Krijimin e tij, Rodin e quajti Portat e Ferrit. Plani i Rodin përmbante vendosjen e një figure qendrore e cila të përfaqësonte Danten, mbi portën 6 metra të lartë.

Kjo figurë do të dominonte ndodhitë nga libri, të ilustruara përreth kornizës së portës. Për këtë arsye, skulptura e cila në fund do të bëhej Mendimtari, u quajt fillimisht Le Poète (Poeti), për t'iu referuar Dantes.

Rodin e mori projektin me entuziazëm të madh dhe versionet e hershme të shumë skulpturave, të cilat u krijuan për të qenë pjesë e Portave të Ferrit, lanë mbresa si te kritikët, ashtu dhe te koleksionistët. Nuk kaloi shumë kohë para se pjesë individuale të projektit, të hiqeshin me kërkesën e blerësve të interesuar. Le Poète ishte nga të parat. Në vitin 1884, Rodin gdhendi për një koleksionues nga Anglia, një version më të hershëm të statujës, duke i vendosur një kapele të stilit të Firences, një ndryshim ky, nga konceptimi origjinal i personazhit si Dante. Megjithatë, Rodin tashmë kishte vendosur se kthimi i këtij poeti në një person tjetër, nuk ishte drejtimi që dëshironte të ndiqte. Prandaj, ai vendosi t'ia hiqte rrobat, përfshi kapelën, ndërsa vazhdonte ta gdhendte dhe të krijonte personazhe të tjerë. "Thatanik, asketik e me mantelin e tij, Dantja im, i ndarë nga ansambli, nuk do të kishte asnjë kuptim," deklaroi ai. Si rrjedhojë, Le Poète u bë Le Penseur. "Konceptova një tjetër mendimtar, një burrë lakuriq të kërrusur mbi një shkëmb, me gishtat e këmbëve të mbledhura e të vendosura pas tij. Me grushtin të ngjeshur pas dhëmbëve, ai mendon. Mendimi kreativ zhvillohet dalëngadalë në trurin e tij. Ai nuk është më një ëndërrimtar, por një krijues."

I përfunduar plotësisht

Versionet e hershme të statujës nuk u shfaqën asnjëherë. Më në fund, në vitin 1888 në Kopenhagen, Rodin vendosi ta shfaqte punën e tij përpara publikut, në formën që përfaqësonte më së miri, idenë universale që tashmë ai përfytyronte. Statuja prej allçie, më pak se një metër e lartë, tregonte një burrë të panjohur, të zhytur në mendime, një njeri të zakonshëm, fiziku i fuqishëm i të cilit, shërbente për të shprehur një ndjenjë gjithë përfshirëse. "Ajo çfarë e bën mendimtarin tim të mendojë, është se ai nuk mendon vetëm me trurin, vetullat e rrudhura, flegrat e zgjeruara dhe buzët e mbledhura," thekson Rodin, "por me çdo muskul në krahët e tij, kurrizin dhe këmbët, me grushtin dhe gishtat e mbledhura të këmbëve." Statuja nuk tregonte më qëndrimin e një poeti mbi një grumbull trillimesh letrare; ajo shprehte një moment analize të vetvetes të çdo qenie njerëzore – një poeti, udhëheqësi, akademiku, punëtori të zakonshëm, ose edhe të vetë artistit.

Me shfaqjen në Paris në Galerie Georges Petit, Mendimtari u prit kaq mirë në këtë formë të zvogëluar, saqë Rodin vendosi të krijonte një version më monumental. Duke përdorur një proces të zhvilluar në vitet 1830, i cili gjurmonte punën e një artisti në shkallë më të vogël për të krijuar një kopje më të madhe, ai dhe asistenti i tij, Henri LeBossé, me ndërrimin e shekullit, krijuan gradualisht, statujën 1.8 metra të lartë, prej allçie dhe të lyer në ngjyrë bronzi, e cila është bërë e njohur si versioni më i arrirë. Ky version qëllimthi më i ashpër e më madhështor, u shfaq në vitin 1904 në Sallonin e Pranverës

Një pamje nga afër e 'Mendimtarit' në 'Portat e Ferrit'
(Foto: Jean-Pierre Dalbéra nga Parisi, Francë.)

në Paris. Në këtë madhësi, skulptura rrezatonte padyshim më shumë pushtet dhe forcë sesa në versionin më të vogël, sikur problemet që rëndonin mbi këtë burrë të ishin më të thella, ose, sikur sapo të përfundonte së menduari, do të ngrihej e të përballej me to.

Një reagim shpërthyes

Reagimi ndaj Mendimtarit ishte kaq i fortë, saqë ideja e shitjes te një blerës privat, trazoi kritikun francez të artit, Gabriel Mourey. Ai nisi një fushatë të suksesshme për blerjen e statujës për popullin francez, kështu që i gjithë kombi ta zotëronte. Në vitin 1904, kur u shfaq edhe versioni i bronztë në Panairin Botëror Shën Luis, Mendimtari u vendos përpara Panteonit në Paris, mauzoleu ku qëndrojnë eshtrat e qytetarëve të mëdhenj francezë dhe një nga ndërtesat me rëndësinë më të madhe simbolike në qytet. Megjithatë, për herë të parë nga disa raste gjatë viteve, statuja do të provokonte një reagim të papritur. Kishte vetëm një muaj e gjysmë që ishte ekspozuar, kur një burrë me të meta mendore, i quajtur Poitron, në 16 janar 1905, e shkatërroi statujën, duke shpjeguar pas arrestimit, se i dukej sikur kjo statujë po e tallte.

I paprekur nga ky incident i një kritike ekstreme ndaj artit, Rodin dhe stafi i tij, krijuan një model tjetër të statujës, këtë herë prej bronzi, e cila u vendos përpara Panteonit në vitin 1906. Këtë herë, perceptimi i Rodin për këtë vepër kishte evoluar. Ai e shihte tani si një nderim për popullin francez, një monument publik me një funksion publik: "Lartëson mendimin e atyre njerëzve modestë të kombit që janë sidoqoftë, krijues energjish të fuqishme. Është në vetvete një simbol shoqëror." Mendimtari do të qëndronte përpara Panteonit deri në vitin 1922, kur perceptimi i tij si një simbol socialist, nisi të rëndonte mbi elementët më konservativë të Francës dhe solli si rrjedhojë, zhvendosjen e tij. (Ky version i statujës u zhvendos te Musée Rodin, një muze, i krijuar nga punishtja e Rodin, pak kohë pas vdekjes së tij.)

Një numër i madh mendimtarësh

Mendimtari, së bashku me pjesë të tjera të marra nga Portat e Ferrit, si statuja e famshme që quhet Puthja, e kthyen Rodin në një yll të artit. Një statujë e mëparshme dhe e papërsosur e poetit Balzac, u zëvendësua me aprovimin e gjerë që mori Mendimtari. Dëshira për këtë statujë gjatë jetës së tij ishte kaq e madhe, saqë Rodin aprovoi 10 modele të skulpturës prej bronzi, për institucione të ndryshme. Përveç versioneve që u shfaqën në Panairin Botëror të Shën Luisit, të tjera statuja prej bronzi u shfaqën në Londër, Laipzig, Berlin, Dresden, Kopenhagen, Stokholm, Venecia dhe Poznan, Poloni. Një statujë monumentale e Mendimtarit mbërriti në Amerikë për t'u mbajtur aty, kur Legjioni i Nderit në San Francisco, bleu njërën nga kopjet europiane në vitin 1915.

Një nga skulpturat e fundit monumentale të Mendimtarit, të aprovuara nga Rodin, u ble nga Muzeu i Artit në Cleveland, në vitin 1916. Si një jehonë e fatit të statujës origjinale në vitin 1905 në Paris, ky version i skulpturës u shpërthye me dinamit në vitin 1970, siç supozohet, prej anëtarëve të grupit revolucionar radikal The Weather Underground (asnjë nuk u arrestua në lidhje me këtë krim). Pjesa e poshtme e këmbëve dhe bazamenti i statujës u dëmtuan tej mase, por në një përpjekje për të ruajtuar sa më mirë gjendjen e mëparshme (dhe, në fakt, për të reflektuar ndjenjat e Rodin se si aksidentet mund të cilësojnë artin), statuja u rivendos në gjendjen e dëmtuar dhe qëndron edhe sot, aty. Është një version mbresëlënës i statujës, shkëmbi poshtë këtij burri, i përhapur si petale të përthyera, ndërsa mendimet e tij qëndrojnë të patrazuara. Statuja duket njëkohësisht më moderne dhe në mënyrë klasike, më e copëtuar.

Një ikonë e pavdekshme

Auguste Rodin vdiq në vitin 1917. Popullariteti i Mendimtarit, gjatë jetës së tij, ishte një burim kënaqësie për të dhe rëndësia që kishte për të personalisht, u konfirmua nga fakti që kërkoi një kopje të kësaj statuje, të vendosej mbi varrin e tij dhe varrin e gruas, Rose Beuret, në shtëpinë e tyre në Meudon. Gruaja e tij vdiq në shkurt të vitit 1917 dhe pas saj në nëntor, në moshën 77 vjeçare, edhe Rodin. Le Penseur qëndron i menduar mbi varret e tyre, ndoshta tani, për çështje që lidhen më shumë me parajsën, sesa me botën. Në fakt, ndryshe nga çdo kopje tjetër e statujës, në piedestalen e vendosur në Meudon, është gdhendur emri "RODIN", duke e bërë të qartë lidhjen ndërmjet burrit në skulpturë dhe krijuesit të tij. Statuja shërben si përmendore dhe si komentar.

Kohët ndryshojnë dhe për një periudhë gjatë shekullit të 20-të, pas vdekjes së tij, veprat e Rodin e humbën popullaritetin; megjithatë, Mendimtari, nuk e humbi asnjëherë. Në 100 vitet që kanë kaluar nga vdekja e Rodin, kjo statujë është krijuar gati njëzetë herë dhe tani mund të shihet në shumë vende të botës. Vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, versione të kësaj statuje gjenden në Baltimore (në dy vende), New York (edhe këtu në dy vende), Cleveland, Denver, Detroit, Louisville, Pasadena, Kansas City, Houston dhe Philadelphia (si pjesë e një muzeu që i kushtohet posaçërisht veprave të Rodin). Këto vepra monumentale, siç Rodin synonte, qëndrojnë zakonisht në ambjente të hapura, në mënyrë që skulptura të bëhet pjesë e ambjentit, e ekspozuar ndaj elementëve të jashtëm, por njëkohësisht e mbyllur në vetvete.

Sigurisht, popullariteti i Mendimtarit shkon përtej shfaqjeve fizike; me kalimin e kohës, është bërë një emblemë në kulturën pop. Është satirizuar në filmat vizatimorë (seria e karikaturave komike Kikirikët e paraqiste në mënyrë të paharrueshme), është parodizuar në skenë, në filma dhe në emisione televizive, madje, edhe është përdorur nga një kompani sigurimesh për t'i shtuar një hije serioziteti, broçkullave të policave të sigurimit. Ndërsa të gjithë këto tallen me natyrën serioze të veprës, asnjë prej tyre nuk sfidon frymën thelbësore të saj, e cila, duket e paprekshme nga satira. Kjo vepër është një ikonë sepse është e fuqishme dhe kjo fuqi, që nga momenti i krijimit, nuk i është dobësuar asnjëherë. Ruan një hije misteri të cilën asnjë satirë nga kultura pop nuk mund ta penetrojë. Edhe tani, ne ende e shohim këtë kryevepër të Rodin dhe pyesim veten se ç'po mendon ky Mendimtar.

Përktheu David Hudhri

EPIKTETI

ARTI I TË JETUARIT

Prolog

Një nga arsyet që Epikteti vazhdon të tërheqë dhe të ketë ende një ndikim të gjerë është se ai nuk ishte pedant në bërjen e dallimit midis filozofëve profesionistë dhe njerëzve të zakonshëm. Ai e shprehu mesazhin e tij fort e qartë për gjithë njerëzit e interesuar në të jetuarit e jetës me një vetëdije të zgjuar morale.

Epikteti, gjithsesi, besonte me forcë në domosdoshmërinë e përpjekjeve për përmirësimin gradual të sjelljes dhe karakterit të personit. Progresi moral nuk është domen i njerëzve të fisëm dhe nuk arrihet përmes rastit apo fatit, por duke punuar me veten — përditë.

Vetë Epikteti nuk do e toleronte dhe aq mbajtjen e një qëndrimi agresiv dhe akrobacitë verbale që për fat të keq konsiderohen ndonjëherë si "ushtrim" i filozofisë në universitet e sotme. Si mjeshtër i shpjegimit të thukët, ai do të ishte po aq dyshues ndaj verbalizmit të mugët që haset në tekstet akademike, filozofike dhe të tjerë shkrime të thata. Siç denoncoi me forcë shfaqjet e zgjuarsisë si qëllim në vetvete, ai ishte po aq i përkushtuar ndaj shpjegimit sa më thjesht të ideve të dobishme për të jetuar sa më mirë. Ai e konsideronte veten të suksesshëm kur idetë e tij kuptoheshin lehtësisht dhe zbatoheshin në jetën reale, ku mund të përmirësonin karakterin e njerëzve.

Në harmoni me shpirtin demokratik dhe jo të ngurtë të doktrinës së Epiktetit, ky volum është një përmbledhje e ideve kryesore të stoicizmit dhe në të përdoret një gjuhë e thjeshtë dhe e përshtatshme për veshët tanë sot. Për të paraqitur mësimet e Epiktetit në një mënyrë sa më të thjeshtë dhe më efektive që të jetë e mundur, kam përzgjedhur, kam interpretuar dhe improvizuar me idetë që përmban *Enchridion* dhe *Ligjëratat*, të vetmet dokumente që i kanë rezistuar kohës, në të cilët përmblidhet filozofia e Epiktetit. Qëllimi im ishte që të përçoja frymën autentike, por jo medoemos Epiktetin fjalë për fjalë. Pra, kam marrë në konsideratë përkthime të ndryshme të mësimeve të tij dhe i kam dhënë një interpretim të ri asaj që, sipas meje, do të kishte thënë ai sot.

Epikteti e kuptonte mirë forcën e veprimit. Ai i nxiste nxënësit e tij që të shmangnin thjesht teorizimet e mençme dhe të zbatonin aktivisht mësimet e tij në rrethanat konkrete të jetës së përditshme. Rrjedhimisht, jam përpjekur që të shpreh thelbin e mendimit të Epiktetit në një mënyrë provokuese, të aktualizuar, që do i frymëzojë lexuesit jo vetëm që të përsiaten, por edhe që të bëjnë ndryshime të vogla, të njëpasnjëshme, që kulmojnë me dinjitetin personal dhe një jetë fisnike plot kuptim.

Fryma e Epiktetit

Si të jetoj një jetë të lumtur dhe të përmbushur?

Si mund të jem një njeri i mirë?

Përgjigja ndaj këtyre dy pyetje ishte pasioni mbizotërues i Epiktetit, filozofit të madh stoik. Ndonëse veprat e tij njihen më pak sot, për shkak të zbehjes së edukimit klasik, ato kanë pasur një ndikim të jashtëzakonshëm për pothuaj dy mijëvjeçarë.

Epikteti lindi skllav rreth vitit 55 e.s në Hierapolis, Phrygia, në zgjatimet lindore të Perandorisë Romake. Mësuesi i tij ishte Epaphroditus, sekretari administrativ i Neronit. Që i vogël, Epikteti tregoi një talent të lartë intelektual dhe Epaphroditus-it i bëri aq shumë përshtypje sa e dërgoi djaloshin në Romë për të studiuar me mësuesin e famshëm stoik, Gaius Musonius Rufus. Veprat e Musonious Rufus, që i kanë rezistuar kohës në greqisht, përmbajnë argumente në favor të edukimit të njëjtë pa dallim gjinie dhe kundër standardit dyfaqësh gjinor në martesë; mësime që mund të kenë ushqyer frymën e tij të famshme për barazinë e plotë. Epikteti u bë nxënësi më i dalluar i Musonius Rufus dhe një ditë u lirua nga skllavëria.

Epikteti dha mësime në Romë deri në 94 e.s, viti kur perandori Domitian, i kërcënuar nga influenca në rritje e filozofëve, e dëboi atë nga Roma. Vitet e mbetur i kaloi në mërgim, në Nikopolis, bregu veriperëndimor i Greqisë. Atje themeloi një shkollë filozofike dhe i kalonte ditët duke dhënë mësime mbi mënyrën e të jetuarit me një dinjitet dhe një qetësi sa më të lartë. Ndër nxënësit e tij më të shquar ishte edhe i riu Markus Aurelius Antoninus, që më pas u bë perandor i Romës; pikërisht autori i librit të famshëm *Meditime*, rrënjët stoike të të cilit gjendeshin tek doktrina morale e Epiktetit.

Ndonëse Epikteti ishte një mësues brilant i logjikës dhe polemikës, ai nuk mburrej me aftësitë e tij të jashtëzakonshme retorike. Sjellja e tij ishte ajo e një mësuesi modest e gazmor, që i nxiste nxënësit e tij për ta marrë shumë seriozisht çështjen e të jetuari me urtësi. Epikteti nuk ishte nga ata që ndryshe flisnin e ndryshe bënin; ai jetonte thjesht në një kasolle të vogël pa treguar asnjë interes për famë, pasuri dhe pushtet. Vdiq rreth vitit 135 e.s, në Nikopolis.

Epikteti besonte se detyra kryesore e filozofisë është që të ndihmojë njerëzit e zakonshëm për t'u përballur sa më mirë me sfidat e jetës së përditshme, dhe për të kapërcyer zhgënjimet, hidhërimet dhe humbjet e mëdha dhe të pashmangshme të jetës. Mësimet e tij ishin të një karakteri moral, të zhveshur nga sentimentalizmi, fanatizmi apo dokrrat metafizike. Çka mbetet është manuali më i mirë perëndimor për të jetuar jetën më të mirë të mundshme.

Ndërkohë që shumë lexues i janë drejtuar burimeve lindore për një udhëheqje shpirtërore pa frymë sektare, perëndimi ka pasur prej kohësh një thesar klasik, ndonëse të nënvlerësuar, me mësime të tilla praktike shumë të dobishme. Mësimet e Epiktetit, një ndër mësuesit më të mprehtë që ka jetuar ndonjëherë, renditen krahas atyre që gjenden në majat e literaturës së qytetërimi njerëzor mbi urtësinë. *Ligjëratat* mund të shihen si përgjigja perëndimore ndaj Dhammapada të Budizmit ose Tao Te Ching të Lao Tzu. Ata që kritikojnë filozofinë perëndimore si shumë cerebrale dhe për një trajtim të mangët të dimensioneve joracionale të jetës mund të habiten kur të mësojnë se *Arti i të Jetuarit* është, në fakt, një filozofi e lirisë dhe qetësisë së brendshme, një mënyrë jetese që synon lehtësimin e zemrave tona.

Artin e të Jetuarit e bën më tërheqës një frymë çuditërisht lindore-perëndimore. Nga një anë, stili i veprës është absolutisht perëndimor: Në të lartësohet arsyeja dhe i lihet shumë hapësirë udhëzimeve morale, praktike dhe të rrepta. Nga ana tjetër, kur Epikteti flet mbi natyrën e universit, duket sikur fryn një fllad lindor. Fuqia Supreme, për shembull, që ai e barazon me vetë Natyrën, përshkruhet prej tij si jashtëzakonisht e rrjedhshme dhe e pakapshme; gjë që çuditërisht të kujton Tao-n.

EPICTETUS

Arti i të jetuarit

Manuali klasik mbi virtytin, lumturinë dhe dobishmërinë

Minerva

Për Epiktetin, jeta e lumtur është sinonim i jetës së virtytshme. Lumturia dhe realizimi personal vijnë natyrshëm kur njeriu bën atë që duhet. Ndryshe nga shumë filozofë të kohës së tij, që mëtonin të kuptonin botën, Epiktetit i interesonte më shumë përcaktimi i hapave specifikë për të arritur pastërtinë morale. Një aspekt i gjenisë së tij është theksimi që i bëri *progresit* moral kundrejt kërkimit të *përsosmërinë* morale. Duke kuptuar mirë sa lehtësisht i shmangen njerëzit të jetuarit sipas parimeve më të lartë, ai na nxit që ta shohim jetën filozofike si një avancim hap pas hapi që gradualisht i afrohet idealeve të çmuar personalë.

Për Epiktetin, një jetë e virtytshme nuk nënkupton ndjekjen e një liste me rregulla, por harmonizimin e veprimeve dhe dëshirave tona me natyrën. Qëllimi nuk është kryerja e veprave të mira për të fituar përkrahjen e zotave apo admirimin e njerëzve, por arritja e qetësisë së brendshme dhe, rrjedhimisht, liria e qëndrueshme personale. Mirësia është një sipërmarrje e shanseve të barabarta, e vlefshme për këdo dhe kurdo: të pasur apo të varfër, të arsimuar apo jo. Ajo nuk është domeni ekskluziv i "profesionistëve të shpirtit," si murgjit, shenjtorët, apo asketët.

Epikteti paraqiti një koncept të virtytit që ishte i thjeshtë, i zakonshëm dhe i qartë në formulim. Ai ishte për një jetë të jetuar vendosmërisht në përputhje me vullnetin hyjnor dhe jo për shfaqjet e bujshme dhe pompoze të mirësisë. Receta e tij për një jetë të virtytshme përqendrohej në tre pika kryesore: kontrolli mbi dëshirat, kryerja e detyrave, dhe të mësuarit për të menduar me kthjelltësi mbi veten dhe marrëdhëniet me të tjerët brenda komunitetit të madh të njerëzimit.

Epikteti pranonte se jeta e përditshme ishte e mbushur me vështirësi të shkallëve të ndryshme. Ai ia dedikoi jetën përcaktimit të rrugës drejt lumturisë, përmbushjes dhe qetësisë, pavarësisht rrethanave. Mësimet e tij, kur i zhvesh nga trajtat e atëhershme kulturore, kanë një lidhje të habitshme me kohën e sotshme. Me raste, filozofia e tij duket si maja e psikologjisë bashkëkohore. *Lutja e Qetësisë*, që mishëron momentin e shërimit - "Më jep qetësinë për të pranuar gjërat që nuk mund të ndryshoj, kurajën për të ndryshuar ato që mundem, dhe urtësinë për të bërë dallimin mes tyre" - fare mirë mund të ishte një fjali e këtij libri. Në fakt, mendimi i Epiktetit është një nga rrënjët kryesore të psikologjisë moderne të vetë-menaxhimit.

Por, për gjëra të tjera të rëndësishme, Epikteti është shumë tradicional dhe aspak bashkëkohor. Ndërsa shoqëria jonë (pothuaj gjithnjë shprehimisht) e konsideron arritjen profesionale, pasurinë, pushtetin dhe famën si të dëshirueshme dhe të admirueshme, Epikteti i shikon këtë si gjëra të rastit dhe pa asnjë rëndësi për lumturinë e vërtetë. Çfarë ka rëndësi më shumë është se çfarë personi po bëhesh, dhe çfarë jete po jeton.

PYETËSORI: "LIBRAT E JETËS SIME"

VIRION GRAÇI:

Librat që do të doja të kisha shkruar? "Kronikë në gur", "Don Kishoti" dhe "Hamleti"

Libri që po lexoj ndërkohë: "The Tyranny of Guilt- An Essay on Western Masochism" i Pascal Brucner. Libër me reflektime e interpretime historiko-krahasuese. Merret me dasitë aktuale botëkuptimore mes Europës, rendit të saj të vjetër dhe bijës së saj matanë Atlantikut, SHBA. Më tërheq shumë dija historike e autorit dhe aftësia e tij për qasje sociologjike e filozofike ndaj traumave dhe dështimeve të mëdha që kanë kaluar shtetet e regjimet e ndryshme në Europë, trauma e dështime që kanë shkaktuar dikur luftëra të përgjakshme, ndërsa sot, peng i vetëdijes për krimet dhe gabimet e të shkruarës – ka mjaft tema tabu; tema tabu për hir të oportunizmit social e pragmatizmit ditor – grupe të caktuara etniko-fetare, në gjirin e shoqërive perëndimore mund të inkurajohen ose të keqkuptohen. Kam dhe disa libra artistikë në lexim e sipër dhe të tjerë në plan për t'i lexuar sa më parë.

Libri që më ndryshoi jetën: "E kuqja dhe e zeza", i Stendhal. Kur isha adoleshent e gjeta në mes të librave të tim eti dhe e lexova, në moshë të parakohshme, pa u penduar kurrë. Nuk mund të them se më ndryshoi jetën në mënyrë fizike, por shpirtërisht më dehu, më bëri të besoj se letërsia, romani, janë gjëra që e madhërojnë lexuesin, e madhërojnë dhe e përfaqësojë, e përfshijnë me gjithë rrethanat e tij, të brendshme e të jashtme; më bindi se duhen shume jetë e shumë njerëz që të popullojnë një roman e ta krijojnë një personazh romani, dhe kjo pafundësi metafizike dhe humane e romanit si zhanër, më bëri të ëndërroj të kem dhe unë një jetë, një zë e një talent të përshtatshëm për të qenë dhe vetë pjesë e kësaj loje serioze.

Libri që do të doja të kisha shkruar: nga letërsia shqipe do të doja të kisha shkruar "Kronikë në gur", "Breznitë e Hankonatëve," disa prej poezive të Lasgushit, disa prej tregimeve të Ernest Koliqit. Nga letërsia e huaj lista e lakmisë bëhet më e madhe. "Don Kishoti", "Hamleti" në krye të çdo ëndrre të pa realizueshme. Dy librat e sipërpërmendur të I. Kadaresë nuk i dua për shkak të lëndës, pra, jo për shkak se bëjnë fjalë për vende e pamje të afërta edhe për mua, por për shkak të perfeksionit artistik. Forma dhe përmbajtja njësohen, si rrallë herë, krijojnë njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjelltë.

Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia: Nuk jam i vetëdijshëm për cilin libër dhe për masën e ndikimit. Për fat, nuk janë marrë me romanet e mi as kritikët e historianët letrarë që ta shikoja veten, pjesën e ndikimeve përmes investigimeve të tyre. "Katër kuartetet" e Eliotit i kam lexuar të përkthyer nga një shok, në dorëshkrim, kur isha student; po ashtu kam lexuar Quazimondon, poetin Italian, etj. Në këtë periudhë moshore tepër të ndjeshme, kam lexuar dhe Kortazarin dhe romanet e shkurtër të Markezit. E përsëris, pas leximeve të mësipërme, krahas të mëhershmëve, jam përmbytur nga arti i madh dhe i kam thënë vetes: rri qetë, janë shkruar librat e bukur, në prozë e në poezi, roli yt në këtë botë mjeshtërish letrarë është ai i spektatorit, domethënë roli i lexuesit.

Libri që ma ka ndryshuar mendjen… janë disa stade në jetën e njeriut, vështirë të veçosh një libër të vetëm. Leximi i Balzakut, pjesës më të madhe të romaneve të tij, besoj se më ka dhënë një perspektivë të qartë e të zymtë të qytetërimit e shoqërive perëndimore; leximi i Solzhenicinit më ka ndërgjegjësuar edhe më tepër për përmasat dhe mekanizmat e totalitarizmit komunist; veprën e plotë të A. Kamus e kam lexuar me ëndje dhe kisha përshtypjen gjatë leximit se po ritakoja dikë që e mund të kem njohur në një ekzistencë të mëparshme. Leximi i Saramagos, Hrabalit, F.Rothit, Coetzit-it e pak të tjerëve si këta, ma ka përtërirë dashurinë për romanin dhe guximin krijues në këtë fushë. Por më e larta nga këto piramida pavdekësie është ajo e Servantesit, romani I tij nuk mbron kurrë së lexuari e së ndikuari.

Libri i fundit që më ka bërë të qaj: kur jam përlotur? Fundi i pjesës së tretë, besoj, i romanit "Doni i Qetë" i Shollohovit. Kafka e një njeriu të vrarë jo shumë kohë më parë është në sipërfaqe të tokës, mbushur me ujë, dhe më tutje, në një varrezë të improvizuar, në një kryq druri të shtrembëruar, dikush ka shkruar epitafin: "Në këtë botë të zisë e të vajit,/ Vëllezër, faljani vëllait/". Jap përlotur dhe me fundin e një romani të shkurtër të Dostoevskit: "E drojtura." Pasi ka përcjellë për në banesën e fundit gruan e tij tepër të re, e vetëvrarë, protagonisti kthehet në dhomën e tyre të gjumit dhe pyet: A ka njerëz të gjallë mbi dhe, pyet kreshniku rus. Pyes edhe unë që nuk jam kreshnik… Si të duroj kur të shikoj pantoflat e saj në dysheme, pranë shtratit tonë.

Libri i fundit që më ka bërë të qesh: Rileximi i komedisë "Tartufi" i Molier.

Libri që më vjen turp që nuk e kam lexuar ende. Janë shumë, së pari jetëshkrimet e autorëve të rëndësishëm të letërsisë botërore. Do të doja të kisha lexuar çdo libër historik për shqiptarët, për të kaluarën tonë dhe etapat e hershme historike. Me siguri, do të ishin qindra çaste me përjetime tragjike.

Librat që kam dhuruar: një listë shumë e gjatë. Pothuajse çdo libër që kam blerë në fëmijëri, pasi e lexonte dhe vëllai im, e jepja dhe nuk e kërkoja më. Dhe ishin shumë. Jepja dhe nga 10 libra për një herë, te një njeri. Më dukej se në mendjen e tyre librat e mi do të ishin në kushte më të mira se në shtëpinë tonë. Në shkollën e mesme dhashë dhe një libër biblioteke, "Shkëndija e jetës", të cilin e pagova më vonë të biblioteka e Korçës shumë shtrenjtë. Kam dhënë vetëm librat që më kanë pëlqyer më shumë. Dhe jam detyruar tani vonë të riblej libra që dikur i kam pasur. Dhe një ditë dëgjova shprehjen: është budalla ai që jep libra, por më budalla bëhet nëse i kërkon t'ia kthejnë. U skuqa nga zori, nga turpi. Përse të qortohet kështu një "budalla" si unë, fjala vjen?

Libri me të cilin dua të mbahem mend: romani "Dead End". Është libër që më përfaqëson personalisht me protagonistin; sikurse përfaqëson autentikisht familjen time dhe skena të vërteta të asaj jete, asaj kohe. Në pikëpamje stilistikore-konceptuale besoj se kam pajtua mes tyre në një ind të vetëm rrëfimin lirirk, epizmin dhe satirën, elementin grotesk. Besoj se do të ketë interes të qëndrueshëm për gjërat që janë treguar në atë roman dhe për mënyrën artistike të shprehjes.

Leximet më të rehatshme: pak i mbështetur në bërryl, gjysmë shtrirë në divan ose në shtrat, kur është fjala për leximet në shtëpi, që janë pjesa kryesore. Mbase nga koha e shkollimeve të mia, që i kam kryer larg shtëpisë dhe tavolinat nëpër dhomat me 5-6 nxënës nuk ishin vend i përshtatshëm për të qëndruar më orë të tëra i përqendruar, na mësuan të lexojmë nëpër shtretërit tanë.

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar: Drejtshkrimi i gjuhës së sotme shqipe.

Të premten e kaluar, në një nga ditët e Panairit XX të librit "Ulqini, 2021", u organizua ceremonia e ndarjes së çmimeve: për romanin më të mirë, librin më të mirë për fëmijë si dhe çmimi për herë të parë për përkthimin.

Kryetarja e Jurisë, zonja Arta Marku, në emër të organizatorëve të Panairit të librit që ishin Komuna Ulqin, Instituti i Librit dhe Promocionit, Organizata Turistike Ulqin shpalli fituesit.

U vlerësua me çmimin "Liburnia",
Besnik Mustafaj për romanin"Historia si një mushkë".

U vlerësua me çmimi "Dega e Ullirit"
Diana Çuli, për librin për fëmijë "Aventurat e Zhuzhusë".

U vlerësua me çmimin "Servantes"
Bujar Hudhri për përkthimin e romanit
"Lumturia martesore" të Lev Tolstoit.